

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 389 PRILL 2023



RAMAZANI, THESAR
QË NUK SHTERON

NATA E KADRIT, VLERA
DHE SHFRYTËZIMI I SAJ

ROLI I ZEKATIT DHE SADAKATUL
FITRIT NË MBARËVAJTJEN E JETËS
FETARE TË MYSLIMANËVE NË TROJET SHQIPTARE

URIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA ME RASTIN E FILLIMIT TË MUAJIT TË BEKUAR RAMAZAN

*Të nderuar besimtarë,
Vëllezër dhe motra,
Të nderuar qytetarë të Kosovës!*

Sonte, fillimisht me faljen e namazit të taravive e nesër në agim me ngrënien e syfyrit, besimtarët myslimanë nisin muajin e agjërimit – Ramazanin. Andaj, kam kënaqësinë që sot në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal t'ju drejtohem me përgëzimet dhe urimet më të mira, me bindje e shpresë që muajin e bekuar Ramazan ta presim e ta përjetojmë në formën më të mirë.

Të dashur besimtarë,

Agjërimi është ibadet i veçantë, që realizohet në muajin e caktuar, me vakte, mision e synim të caktuar. Agjërimin, besimtarët e kryejnë me përkushtim e devocion për hir të Krijuesit dhe për të merituar mëshirën dhe begatitë e Tij. Përveç kësaj, agjërimi si asnjë ibadet tjetër shpërfaqë bindjen, dashurinë dhe sinqeritetin ndaj Krijuesit tonë - Zotit xh.sh..

Muaji Ramazan është një ibadet që bëhet për dhe në emër të Zotit, dhe për besimtarët shënon edhe muajin e shtimit të ibadeteve, faljes së namazeve shtesë, bërjes më shumë lutje e dua, ndjesisë ndaj fëmijëve, skamnorëve, jetimëve dhe njerzëve në nevojë. Gjatë ditëve dhe netëve të Ramazanit, shtëpitë tona, rrugët e xhamitë tona gjallërohen e mbushen plot gëzim, rahmet e begati, sepse vetë agjërimi e bënë besimtarin më të qetë, e fisnikëron dhe e bënë më dorëlrirë e më solidarë.

Muaji Ramazan, si asnjë muaj tjetër na afron me familjen e farefisn rreth sofrës së iftarit – moment ky që është i veçantë e në të cilin ka shumë bereqete dhe shumë dashuri. Po ashtu, gjatë këtij muaji jemi më pranë dhe në mbështetje të njëri-tjetrit.

Besimtarë të nderuar,

Muaji Ramazan është i veçantë edhe për një arsye tjetër. Në këtë muaj, Pejgamberit tonë të dashur, Muhamedit a.s., ka filluar t'i zbrisë Kurani fisnik, e përmes tij edhe besimtarëve dhe botës mbarë, prandaj muaji Ramazan njihet më të drejtë edhe si muaj i Kuranit fisnik dhe, duke medituuar në mesazhet dhe porosinë e tij, ne përfitojmë mirësi e sevape në këtë dhe botën tjetër. Për muajin e agjërimit, Allahu xh.sh., në Kuranin fisnik ka thënë: “Muaji Ramazan është muaji në të cilin zbriti Kurani, ai është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës



nga gënjeshtër). Prandaj, kush e arrin prej jush këtë muaj, le të agjërojë...”

Vëllezër dhe motra,

Populli ynë ka një traditë disa shekulllore të bashkëjetesës me mirësitë e muajit të bekuar Ramazan, të cilën e shprehin me agjërime, falje, lutje, respektim e vizita të ndërsjella me njëri-tjetrin, solidaritet, humanitet e bashkëndjesi.

Agjërimi i muajit Ramazan besimtarin e afron me Krijuesin, e largon nga egoja, urrejtja e smira, e motivon për punë e vepra të mira e të hairit.

Mësimet, vlerat dhe misioni i agjërimit janë më se të nevojshme për shoqërinë edhe ashtu të trazuar që po kalon ditë jo të mira, me luftëra e konflikte. Prandaj, në këtë natë të madhe, në vigjilje të fillimi të këtij muaji të madh, lusim Zotin xh.sh. që sa më parë të ndalen luftërat e konfliktet, dhe popujt të jetojnë të qetë në paqe e harmoni. Misioni i njeriut në këtë botë nuk është që të krijojë trazira, gjakderdhje, vuajtje e shkatërime, por të jetojë me dinjitet, ashtu siç na ka udhëzuar Krijuesi i gjithësisë.

Duke ju uruar të gjithëve mbarësi e shëndet, ju dëshiroj që muajin e madhëruar Ramazan ta përjetojmë me të gjitha mirësitë e begatitë e tij!

E lus të Madhin Zot që të na lehtësojë agjërimin dhe të na fisnikërojë me moralin dhe etikën e Ramazanit.

Urime të gjithëve muaji Ramazan!

Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, 22 mars 2023

EDITORIAL

- 4 Kurani, libri që vuan miqësinë e ngrohtë të myslimanëve

FE & SHKENCË

- 5 Shoqërimi me Kuranin në Ramazan
Hfz. Mehas Alija
- 8 Agjërimi në këndvështrimin kuranor
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 11 Përsiatje shkencore rreth ajeteve të agjërit (2)
Mr. Samir Zullufi
- 14 Vlerat edukative të Ramazanit
Dr. Ejup Haziri
- 18 Agjërimi si vlerë sociokulturore
Dr. Xhevdet Rusinovci
- 20 Ndërtimi i karakterit ndërmjet këshillave të psikologut dhe praktikimit të agjërit të Ramazanit
Mr. sci. mjek. Adem Zalihiq
- 23 Ramazani, thesar që nuk shteron
Mihana Goga – Bekteshi
- 25 Ramazani, muaj i fitoreve
Blerim Musliu
- 27 Itikafi dhe dhjetë netët e fundit të Ramazanit
Nehat Shehu
- 30 Nata e Kadrit, vlera dhe shfrytëzimi i saj
Dr. Selatin Mehani
- 34 Dhënia e sadakatul fitrit në para – kundërvlerë monetare
Jusuf Zimeri



- 38 Roli i zekatit dhe sadakatul fitrit në mbarëvajtjen e jetës fetare të myslimanëve në trojet shqiptare
Vahidin Beluli
- 41 Bajrami, festë për myslimanët
Nexhmi Hoxha
- 44 Komentimi i kaptinës El-Fet'h (3)
Sabri Bajgora
- 48 Karakteri paqësor i Profetit Muhamed, alejhi selam (3)
Flamur Vehapi



EDUKIM & FAMILJE

- 50 Feminizmi dhe racionaliteti i luftës së tyre për të drejtat e grave
Nada Dosti
- 53 Dallimet ndërmjet femrës dhe mashkullit
Mimoza Sinani



PERSONALITETE

- 56 Imam El Merginani (530h-593h)
Blerton Bahtiri


KULTURË

- 59 Përpjekja për demokratizim të Turqisë nëpërmes teksteve shkollare në Perandorinë Osmane (2)
Hasan Bello



AKTIVITETE

- 36 Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 389 • viti 36 • prill 2023
• Ramazan / Sheval1444
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavë,
mr. Vedat Shabani.
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë



“O Zoti im! Me të vërtetë, populli im (po) e merr këtë Kuran, si të braktisur.”.

(El Furkan, 30))

Kurani, libri që vuan miqësinë e ngrohtë të myslimanëve

Duke qenë se Ramazani është muaji që madhëstsinë e tij nga Zoti e fitoi për shkak të madhëstsisë së librit që ka zbritur në të, ai vjen te ne edhe me thirrjen kumbuese që të rishikojmë sërish raportin tonë kundrejt tij. Kurani, shpallja e fundit hyjnore që zbriti në Ramazan, me fuqinë e tij magjepsëse, gati sa nuk e eklipsoi edhe vlerën e muajit në të cilin ai i zbriti të Dërguarit tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!). Në këtë muaj, më mirë se kurrë, kuptojmë vobektësinë e atij botëkuptimi të disave, që librin e Zotit e marrin thjesht si dekor vitrine, apo për të pasuruar raftet e bibliotekave të tyre, siç do të bënin kështu me cilindo libër tjetër.

Ky libër, brenda tij vërtet ka kulturë, por ai nuk është libër i kulluar kulturor që ne ta relaksojmë mendjen tonë nëpërmes leximit të tij, apo që të krenohemi se po e ruajtkemi me fanatizëm nga të parët tanë. Përtej kësaj, është libër që s’jeton dot i qetë pa dinamikën, pa gatishmërinë tonë për mishërim me mësimet e tij. Ai gjen prehje vetëm atëherë kur lexohet, meditohet dhe jetësohet nga ata që besuan në hyjnitetin e mesazheve dhe porosive të tij. Ai frymon mirë vetëm atëherë kur nuk braktiset.

Andaj, edhe lidhja e përsëritur e besimtarit të vërtetë me Librin e Allahut, është e tillë që nuk e lejon që me të të krijohet lidhje periodike. Ky burim udhëzimi për njerëzimin nuk toleron që të mbahet në dorë një muaj, e të braktiset për njëmbëdhjetë të tjerë, një shprehi e rëndomtë tanimë për shtresa të gjera të myslimanëve. Urtësitë e këshillat madhështore të tij nuk janë dobiprurëse për pak kohë, e të shuhet frytdhënia e tyre më pastaj. Ato mbesin të pavdekshme gjer në kataklizëm. Pse të braktiset, atëherë?

Madje, Allahu rrëfen për ne një situatë në Ditën e Gjykimit, kur i dërguari ynë, Muhamedi a.s., i ankohet Zotit të tij për braktisjen e këtij libri. Allahu në Kuran na tha: “Dhe, Pejgamberi (Muhamed) tha: “O Zoti im! Me të vërtetë, populli im (po) e merr këtë Kuran, si të braktisur.” (El Furkan, 30). Ajeti, katërçipërisht e rrëfen gjendjen reale të myslimanëve tash e disa shekuj, të cilët miqësinë me librin e tyre e kanë zbritur në nivelin e leximit të tij, edhe atë jo gjatë gjithë vitit, por vetëm në një muaj të tij, në Ramazan. Natyrisht, që s’janë të gjithë në këtë kualifikim, por pjesa dërmuese duket se po.

Muhamedi a.s. këtë libër e morri si amanet nga Zoti i tij për të mbetur udhërrëfyes i njerëzimit gjer në amshim. Andaj, kthimi ynë te Kurani në muajin Ramazan, shfletimi e leximi i tij pa ndalë, ndërsa braktisja e tij jashtë tij, në fakt rrëfen për krizën tonë në mendësi dhe shmangien tonë nga praktika e mirëfilltë e Islamit. Kurani, vërtet do të mbetet i njëjtë dhe i pandryshuar, por që ti që po e lexon dhe mediton në madhëstsinë e leksioneve të tij, nëse je i çiltër në synimin tënd, doemos se do të ndryshosh. Ai, i pandryshueshmi mbetet gjithnjë i tillë, por doemos se ka për të të ndryshuar ty. Hasan el Basriu, si erudit i rrallë që ishte, vërejtë këtë lloj paradoksi edhe në epokën e tij. Dhe duke synuar që të kristalizoi mënyrën e shëndoshë të krijimit të miqësisë me Kuranin tha: “Për Allahun, nuk ka medituari në këtë libër ai që vetëm ka zënë përmendësh shkronjat e tij, ndërsa ka nëpërkëmbur dispozitat e tij. Madje dikush prej tyre edhe mund të pandehë se unë e kam lexuar Kuranin në tërësi, por që ai Kurani i tij nuk vërehet as në moralin e as në veprën e tij.”

Brezi i artë i myslimanëve e mbante në dorë Kuranin, për të ndriçuar fytyrat e veta me të, për të marrë nga drita e tij, e për të frymuar me mësimet hyjnore të tij. Edhe përtej kësaj, e lexonin atë që të pastronin shpirtin dhe mendjen e tyre nga çdo mbetje e epokës së injorancës nga e cila kishin vuajtur për shekuj me radhë. Kjo miqësi e vërtetë me Kuranin i bëri ata njerëz shëmbëlltyrë dhe pa asnjë dilemë se edhe u shndërruan në një brez të pavdekshëm e të lavdishëm në histori. Ky Libër hyjnor, për të tillë breza është përmalluar. Ka kohë që miqësinë e ngrohtë me të, ai nuk e ka shijuar. Pse të mos ia heqim ne brezi ynë këtë mallëngjim atij?!

Mr. Driton Arifi

Shoqërimi me Kuranin në Ramazan

Hfz. Mehas Alija

Kurani fisnik është fjala e mrekullueshme e Allahut Fuqiplotë. Ai është baza dhe themeli i fesë, mendimit dhe civilizimit islam. Siç njofton vetë Kurani, ai zbriti në muajin Ramazan, si udhëzim dhe orientim për njerëzit. Zoti e zbriti atë që njerëzimi ta lexojë, ta studiojë dhe me të ta zbulojë botën dhe sekretet e saj. Në raport me leximin e tij, njerëzit mund të ndahen në të tillë që vetëm e lexojnë si libër për sevape dhe përfitime shpirtërore, dhe të tillë që e lexojnë dhe lejojnë që Kurani t'i lexojë ata, t'i lexojë edhe mendimet dhe preokupimet e tyre.

Kurani famëlartë është një libër i hapur, që fton për t'u lexuar, për t'iu kthyer e për ta vështuar me mendim të thellë. Kushdo që i qaset atij, e lexon dhe mediton rreth porosive gjithkohore të tij, ai ka një mendje dhe zemër të hapur. Ata që nuk e lexojnë dhe nuk meditojnë rreth tij, Kurani i sfidon duke i pyetur se mos, vallë, zemrat i kanë të mbyllura me dry: "Vallë, a nuk mendojnë ata për Kuranin, apo në zemrat e tyre ka dryna?"¹

VLERA E LEXIMIT TË KURANIT NË RAMAZAN

Koha më e mirë, më e përshtatshme dhe më përfituese për shoqërim dhe angazhim me Kuranin është në muajin e bekuar Ramazan, në të cilin muaj u bë shpallja e tij. Allahu i Madhërishëm në Kuranin famëlartë thotë: "Në muajin Ramazan ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)".² Krahas agjërimit, gjatë muajit Ramazan, angazhimi dhe shoqërimi me Kuranin fisnik është edhe një specifikë tjetër e këtij muaji. Është interesant se në Kuran, muaji Ramazan, përmendet vetëm një herë. Me këtë, sikur

Koha më e mirë, më e përshtatshme dhe më përfituese për shoqërim dhe angazhim me Kuranin është Ramazani, në të cilin muaj u bë shpallja e tij.

ka dashur Alahu xh.sh. të na tregojë për specifikën dhe veçorinë e kohës që kalojmë në këtë muaj, sikur të ishte një mundësi që ofrohet vetëm një herë në jetë! Madje, sipas ajeteve të agjërimit, ku mbarojnë me mesazhin "...ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni"³, agjërimi ynë, pos të tjerash, i dedikohet edhe si mirënjohje dhe falënderim Krijuesit për dërgimin e udhëzimit dhe zbritjen e Kuranit, dritën e pashuar deri në kiamet.

Për vlerën e leximit dhe studimit të Kuranit në Ramazan, flasin të dhëna të shumta nga tradita profetike dhe nga përvoja e të parëve tanë të ndershëm. Pejgamberi a.s. në një hadith ka thënë: "Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë për njeriun në Ditën e



Kurani nuk është një tekst i vdekur e as i skaduar, por një komunikim e mesazh i gjallë. Ai thirr në jetë dhe jep jetë.

Gjykimit. Agjërimi do të thotë: “O Zot! E kam privuar nga ushqimi dhe pija, prandaj më lejo që të ndërmjetësojë për të!” Ndërsa Kurani do të thotë: “E kam privuar nga gjumi i natës, prandaj më lejo që të ndërmjetësojë për të!” Kështu që ata të dy do të ndërmjetësojnë.⁴ Po ashtu, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, fiton një sevap dhe ky sevap i shumëfishohet dhjetëfish.”⁵

Imam Tirmidhiu shënon një hadith kudsij nga Ebu Seidi r.a., në të cilin Allahu i Madhërishëm thotë: “Kënd e largon Kurani nga përmendja Ime dhe kërkimi (dhikri dhe dua) drejt Meje) prej Meje, Unë kam për t'i dhënë atij më shumë se ç'më lusin dhe ç'më kërkojnë të tjerët. Kurse vlera e fjalëve të Allahut në raport me fjalët e të tjerëve, është sa vlera e Allahut në raport me krijesat e Tij.”⁶


Pra, ai i cili nuk ka shumë kohë që ta lus Allahun xh.sh., për nevojat dhe hallet e tij, duke qenë se është i zënë me leximin dhe këndimin e Kuranit, Zoti do t'i japë atij më shumë se sa u jep atyre që e lusin vazhdimisht me dua dhe forma të tjera, të cilët në çdo lutje dhe kërkesë shprehin hallet dhe nevojat. Kjo është një nxitje shumë e fuqishme për lexuesit e Kuranit, që mos të shqetësohen se nuk kanë kohë të mjaftueshme për t'i bërë dua Allahut,

sepse Ai ka garantuar se ka për t'ua plotësuar të gjitha nevojat e tyre për shkak të meditimt dhe kapjes së tyre pas Fjalëve të Tij. Sihariqi bëhet edhe më i madh kur këto fjalë hyjnë nënë ushqim dhe freski ditore gjatë ditëve të begata të Ramazanit. Fakti që Muhamedi a.s. gjatë Ramazanit angazhohej më shumë me Kuranin, madje së bashku me Xhibrilin a.s. e përsërisnin atë, flet shumë për vlerën dhe rëndësinë e shoqërimit me Kuranin në këtë muaj të bekuar.⁷

SI DUHET TA LEXOJMË SOT KURANIN?

Kurani nuk është një tekst i vdekur e as i skaduar, por një komunikim e mesazh i gjallë. Ai thirr në jetë dhe jep jetë. Përmes tij, zemrave të vdekura u vjen shpirti, sytë e qorruar të zemrës ndriçojnë, veshët e shurdhër fillojnë të dëgjojnë, kurse gjuhët memece fillojnë të thonë të vërtetën.⁸

Duhet të pranojmë se sot ka myslimanë që e lexojnë Librin në mënyrë selektive, madje edhe të dhunshme dhe të ngurtë. Ky është një defekt në raport midis nesh dhe librit tonë të shenjtë. Fletët e tij lexohen sikur të ishin letra të dedikuara dikujt tjetër, e jo neve. Sikur ato letra të ishin relikte të shpallura për njerëz dhe popuj të tjerë të së kaluarës! Mësimet,



udhëzimet, historitë, këshillat dhe qortimet duhet t'i lexojmë sikur të jenë dërguar enkas për ne, sepse edhe ashtu janë dërguar. Kurani është për të gjitha kohët dhe për të gjithë botët, pra, ai është universal dhe mesazhet e tij janë të përbotshme. Ai duhet të lexohet si një tërësi. Sikur ky Kuran t'iu ishte shpallur sot gjermanëve ose japonezëve, ata sot nuk do të linin çast pa folur për të dhe me të.

Zoti i Madhërishtëm thotë: *“Ne, në të vërtetë, ua kemi përcjell atyre një shkrim hyjnor, të cilin e kemi shpjeguar gjerësisht, për të qenë udhëzim dhe mëshirë për njerëzit që do të besojnë.”*⁹

Në muajin Ramazan është koha më e mirë që të kapërcejmë ngurtësinë mendore dhe t'i fusim botëkuptimet kuranore në mendjet, zemrat dhe ndërgjegjen tonë, duke synuar kështu, në radhë të parë, dashurinë e Allahut, dëlirësinë shpirtërore, dashurinë e diturisë dhe të etikës. E, fryt i kësaj, pa dyshim, do të ishte formimi i një pikëpamjeje kuranore për veten dhe botën.¹⁰

Në kohën tonë bashkëkohore kemi numër të madh hatmesh, leximesh e mësimesh përmendësh të Kuranit, por nuk kemi për hatër të Kuranit respektim të tjetrit, familjes, shoqërisë, botës, xhamisë, rendit, namazit, duasë, prindërve, gruas, etj.. Kemi kuantitet, e shumë pak kualitet, respektim të lartë të Mus'hafit, e fare pak të mësimave, përmbajtjes dhe normave të tij. Recipienti, gjegjësisht lexuesi i Kuranit, sot është bërë perde ndaj rrethit ku jeton e vepron dhe pengon që drita e Kuranit të depërtojë në sistem dhe në çdo pore të jetës shoqërore. Faj kemi ne, e nuk është faji i Librit të Allahut, por kryekëput yni, i njerëzve të papërgjegjshëm, të cilët, ndonjëherë me veprimet e tyre shpërfytyrojnë madhësinë e Kuranit.

Problemi i njeriut bashkëkohor në raport me Kuranin është se ai beson në fjalët e Kuranit, beson se është i vërtetë, i drejtë dhe i saktë, si dhe beson se për çdo shkronjë të tij, kur lexohet, fitohet nga dhjetë sevape, por nuk beson se Kurani mund t'ia rregullojë jetën atij, se mund t'ia përmirësojë kualitetin e shëndetit dhe të punës, se mund të jetë rregullator dhe udhëzim drejt sukseseve në fe, teknologji, inxhinieri, shkencë, kulturë, gjuhë, sport, si dhe në rregullimin e marrëdhënieve brenda familjes dhe shoqërisë. Me fjalë të tjera, njeriu bashkëkohor beson se Kurani ka rregull të mahnitshëm brenda vetes, por nuk beson se ai mrekullisht mund t'ia rregullojë jetën atij në dynja dhe në Ahiret. Ky është problemi ynë me Kuranin sot.

Se Kurani posedon rrugëdalje dhe zgjidhje për çdo gjë të jetës sonë, nuk ka asnjë dilemë. Allahu i Madhërishtëm thotë: *“Në Libër asgjë nuk kemi lënë mangët.”*¹¹ *“Ne ty ta shpallëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët.”*¹²



Me Kuranin mund të ecësh drejt dhe mund të bashkëjetosh bukur, vetëm nëse e lexon dhe mëson, jo për kuantitet, por për kualitet dhe kënaqësi. Ai nuk u zbrit vetëm për ta lexuar gjuhët, apo për ta mësuar mendjet, por për ta mësuar dhe për të vepruar me të, me aq sa të jetë e mundur. Nëse vazhdojmë ta ruajmë Kuranin me të gjithë autoritetin e tij, do të mund ta ruajmë mesazhin dhe vizionin e tij. Kurani, ashtu siç ai vetë e përshkruan veten, është libër udhëzues, dritë mbi dritë. Ai nuk erdhi që ta kufizojë njeriun apo ta ulë atë, porse t'ia falë lirinë dhe ta lartësojë atë. Le t'ia japim mundësinë Kuranit që ai të na lexojë ne, ndërsa ne, pastaj, t'i flasim vetvetes dhe botës me gjuhët shëruese të tij. Si përgjigje përfundimtare ndaj pyetjes së parashtruar më lartë, themi se Kurani duhet lexuar për të mirën e njerëzimit, gjegjësisht, në radhë të parë për myslimanët dhe më pas për tërë botën.

1 Muhamed, 24.

2 El Bekare, 185.

3 El Bekare, 185.

4 Imam Ahmed, nr. 6589.

5 Imam Tirmidhiu, nr. 2910.

6 Muhamed Zakariyya Kandhalaëi, *Fadail-ul-a'mal – punët e vlefshme*, Tetovë, 2018, fq. 11.

7 Imam Buhariu, nr. 1809.

8 Mustafa Islamoglu, *Vetëdija mbi imanin*, Sira, Prishtinë, 2016, fq. 48-49.

9 Araf, 52.

10 Abdulhamid Ebu Sulejman, *Botkuptimi kur'anor*, Logos-A, Shkup, 2018, fq. 195.

11 El Enam, 38.

12 En Nahl, 89.

Agjërimi në këndvështrimin kuranor

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Në Islam, adhurimet paraqesin një forcë të pjekurisë psikologjike, e cila bënë ekuilibrin në karakterin e njeriut, duke siguruar kështu kontroll të brendshëm dhe të jashtëm dhe duke drejtuar atë nga dashuria, respekti, durimi, dhembshuria dhe falja.

Në Islam, adhurimet paraqesin një forcë të pjekurisë psikologjike, e cila bënë ekuilibrin në karakterin e njeriut, duke siguruar kështu kontroll të brendshëm dhe të jashtëm dhe duke drejtuar atë nga dashuria, respekti, durimi, dhembshuria dhe falja. Pra, ato përbëjnë një forcë e cila nxitë dhe strukturon njeriun në vendosmëri për t'u përballur me vështirësi të ndryshme. Pa dyshim njëra nga këto adhurime është edhe agjërimi, i cili ka si qëllim lartësimin shpirtëror, edukimin moral, përgatitjen e njeriut që t'i mbizotërojë emocionet e epshet dhe të bëhet i pavarur prej tyre. Përveç kësaj, ai është një mënyrë që ndihmon dhe kontribuon në kontrollimin e dëshirave dhe nevojave të njeriut si ngrënia, pirja etj., për të fituar zakonet e vetëkontrollit, për të rritur forcën e durimit dhe qëndrueshmërisë dhe për t'i flakur prirjet dhe zakonet e këqija.

KUPTIMI I AGJËRIMIT

Agjërimi në Kuranin fisnik, në mënyrë koncize me shprehje dhe forma të ndryshme si "saum" dhe "sijam", përmendet në disa kapitla,¹ të cilat janë shpallur në intervale të ndryshme kohore. Ndërsa si një adhurim i detyrueshëm për besimtarët përmendet në kapitullin El Bekare.² Në leksik, fjalët "saum" dhe "sijam" kanë kuptimin "të përmbahesh, të heshtësh, të qëndrosh i pa lëvizur, të frenosh diçka, të ndalosh vetveten, të përmbahesh nga të bërit diçka dhe të mos flasësh".³ Kurse në kuptimin terminologjik, agjërimi është një adhurim që çdo mysliman në moshën e përgjegjësisë (madhore) e kryen

me qëllim adhurimi, duke ndërprerë ushqyerjen dhe marrëdhëniet intime nga agimi i vërtetë (el fexhru ssadik-agimi i vërtetë) gjer në perëndimin e diellit.⁴ Ibën Kajjim el Xhevzi, në lidhje me agjërimin përmend se, meqenëse agjërimi është mënjanim i urisë dhe etjes, ai menaxhon forcën e nefsit, duke i kujtuar atij gjendjen e uritur dhe të mundimshme të të varfërve. Po ashtu thekson se me të pakësuar koha dhe mënyra e të ushqyerit të njeriut, rrugët e djallit për të hyrë në zemrat e tyre bëhen më të ngushta.⁵ Kurse sipas disa dijetarëve, agjërimi është një nga masat parësore mbrojtëse në luftën e shpirtit për të mos qenë në varësi të vetvetes së tij.⁶ Me fjalë të tjera, agjërimi është një metodë e kontrollit të shpirtit, fjalëve, sjelljeve të këqija.

QËLLIMI KRYESOR I AGJËRIMIT

Agjërimi është një periudhë e edukimit intensiv për përfitime të mëdha shpirtërore. Me këtë ibadet, agjëruesi është më afër Zotit me lutjet dhe kërkesat e veta, dhe siç kuptohet nga Kurani, nuk ka nevojë për kurrfarë ndërmjetësuesi. Njëkohësisht, heqja dorë nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime në kohë dhe ditë të caktuara është një edukim i çmuar për sa i përket qëndrueshmërisë dhe këmbënguljes. Ngase gjatë agjërit, njeriu mbështetet në durim si një vepër e virtytshme për të fituar kënaqësinë e Allahut. Po ashtu, agjërimi si një formë adhurimi kërkon lavdërimin e Zotit për dhuntitë që i janë dhënë vetë njeriut. Dhe kjo lë të kuptohet se filozofia më e rëndësishme e agjërit është gjendja

shpirtërore e njeriut. Një person që në uri dhe etje ka ushqime dhe pije me bollëk, mund të mos jetë shumë i durueshëm kur ato i mungojnë. Por agjëruesi është si një bimë që rritet në shkretëtirë. Ai i reziston pamjaftueshmërisë së ujit, qëndron i palëkundur kundër stuhive të forta dhe është i durueshëm kur sfidohet nga mungesa. Agjërimi është një shkollë edukative për shpirtin i cili me kufizime të përkohshme i jep njeriut durim, fuqi vullneti, aftësi për të qëndruar ndaj privimeve ekstreme dhe e mban zemrën të butë dhe të pastër duke i kontrolluar instinktet.

AGJËRIMI NË TEKSTIN KURANOR

Praktikimi i agjërimit është shumë i hershëm. Lashtësia e tij flet për rëndësinë e tij dhe për faktin se në shpirtin e njeriut përherë është ushqyer ndjenja për adhurimin e Allahut në forma të ndryshme. Ashtu siç shprehet edhe në Kuran, agjërimi, është një ibadet që ka ekzistuar edhe në fetë e tjera qiellore dhe shkon deri në kohë shumë të vjetra, lashtësi e cila kuptohet edhe nga ajeti i

agjërimit: *“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim, sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush”*.⁷ Komentatori bashkëkohor, Muhamed Reshid Rida, gjatë komentimit të ajetit në fjalë, ndër të tjera thotë: *“Allahu i Madhërishëm na bëri me dije se agjërimi në Islam është detyrim, siç ishte detyrim edhe për popujt e tjerë të mëparshëm dhe në këtë mënyrë është ruajtur kontinuiteti i institucionit të agjërimit në të gjitha fetë qiellore.”*⁸ Po ashtu, në librat e tefsirit, gjenden njohuri të bollshme të bazuara në Kuran që agjërimi në forma të ndryshme ishte i njohur dhe praktikohet edhe nga të dërguarit e tjerë para Muhamedit a.s. dhe ymetet e tyre. Është e ditur se Musai a.s. ka agjëruar 40 ditë para se ta pranonte Teuratin (Dhiatën e Vjetër). Po ashtu ka agjëruar Davudi, Jusufi, Isai a.s., si dhe shumë profetë të tjerë. Mirëpo duket se pas ndërhyrjeve në mësimet burimore, tek ithtarët e librit agjërimi është reduktuar në një traditë fare simbolike.

Pas një agjërimi të pastër, besimi merr një ngjyrë të re, ngase njeriu fillimisht fillon një adhurim që e afron te Zoti i tij pastaj duke i bërë lutje Atij, ai përfiton një edukim

Agjërimi është një akt adhurimi që devotshmërinë e shndërron në një mburojë të pathyeshme.



shpirtëror dhe kështu vendoset një lidhje në të cilën ai ndihet afër Zotit të tij me besim të sinqertë. Pra, kjo është një rrugë që fillon me një besim të thjeshtë dhe rezulton me një rend më të lartë besimi. Në lidhje me këtë, në Kuran thuhet: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim... kështu që të bëheni të devotshëm.”⁹ Agjërimi është një akt adhurimi që devotshmërinë e shndërron në një mburojë të pathyeshme. Agjëruesi me përmbajtjen e tij nga veprat e këqija, kalitet në drejtim të kënaqësisë hyjnore duke arritur lumturinë në të dy botët. Në këtë kontekst, në hadithin e Pejgamberit a.s. thuhet: “Kush e agjëron Ramazanin me besim të sinqertë për shpërblimin e tij (vetëm nga Allahu), atij i falen mëkatet e kaluara.”¹⁰ Andaj në dritën e këtyre argumenteve, agjërimi vlerësohet si një rrugë, fundi i së cilës kurorëzohet me piedestalin më të lartë të devotshmërisë. Në lidhje me këtë, Raziu thekson se agjërimi është një akt që thyen kërkesa dhe dëshira njerëzore të tilla si ngrënia, pirja dhe marrëdhënia intime. Sa më e madhe që të jetë dëshira e njeriut për diçka, aq më i vështirë është mosplotësimi i saj. Pikërisht, për shkak të natyrës së tij si krijesë, ngrënia, pirja etj., zënë vend kryesor mes kërkesave dhe dëshirave të njeriut dhe përmbajtja ndaj tyre është e mundur vetëm me agjërim. Personi i cili me anë të agjërimit mëson veten të përmbahet nga të tilla shprehi e dëshira, do ta ketë edhe më të lehtë t’i vë nën zotërim kërkesat dhe dëshirat e tjera.¹¹

Agjërimi është i tëri mirësi dhe begati, ai ushqen shpirtin, shëron trupin dhe vërteton sinqeritetin e zemrës, bashkon zemrat e besimtarëve dhe mbjell ndjenjën e mëshirës dhe të dashurisë. Islami, për dallim nga fetë e tjera, shtrun si kusht që agjërimi të vishet me sjellje të njerëzishme, ngase nuk ka për qëllim vetëm heqjen dorë nga ngrënia dhe pija, por përmban një tërësi urdhrash dhe ndalesash.

Rregullat e para të dëshmuara në Kuranin famëlartë mbi formën e agjërimit janë këto ajete të Kuranit që vijnë pas ajeteve të obligueshmërisë së agjërimit të cekura më lartë. “(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim, atëherë ai (le të agjërojë) më vonë po aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë) janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo po qe se e dini agjërimi është më i mirë për ju.”¹² Sipas komentatorëve të Kuranit, koha e agjërimit në Islam është muaji i nëntë i vitit hënor, e që është muaji Ramazan. Pra agjërimi në ditë të caktuara është për qëllim agjërimin të këtij muaji fisnik. Sipas dijetarit Alusi, shprehja “Ditë të caktuara” nënkupton ditët e kësaj bote që do të përfundojnë së shpejti. Këto ditë përfshijnë jetën kalimtare. Duke menduar se jeta e njeriut është e përkohshme, ai duhet të jetojë një pjesë të saj sikur të ishte duke agjëruar.¹³

Fryma humane në fenë islame në përmbushjen e adhurimeve manifestohet edhe në agjërim. Allahu i Lartësuar, në Kuran, me vënien e kësaj dispozite na bënë me dije se

duhet të kihet parasysh rrethanat, kushtet dhe gjendja e besimtarit. Për këtë duke urdhëruar: “Kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë po aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë) janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri,”¹⁴ vërteton se i sëmuri, i cili nuk ka mundësi ta përballojë agjërimin, ose udhëtari që merr një rrugë të gjatë lirohet nga ky detyrim. Lirimi nga agjërimi i njerëzve të këtyllë, argumenton faktin se me obligueshmërinë e agjërimin nuk synohet vështirësimi ndaj besimtarëve, por kalitja e tyre, arritja e devotshmërisë dhe manifestimi i nënshtrimit ndaj Krijuesit të tyre. Urtësia dhe delikatesa në këtë shihet nga përmendja e agjërimin si një adhurim i aplikuar edhe te popujt e mëhershëm, dhe obligueshmëria e tij edhe për ne, me synimin e vetëm të arritjes së devotshmërisë. Më pas theksohet përcaktimi i kohës së agjërimin në ditë të caktuara. Dhe në fund fare përcakton lehtësimin, shtyrjen e kohës ose kompensim (fidje) për kategoritë e veçanta.

Dhe kjo skenë e bukur përmbillet me inkurajim për mirënjohje ndaj Zotit të Plotfuqishëm: “Plotësimi i këtyre ditëve dhe orientimi juaj për në rrugë të drejtë janë që ta njihni madhësinë e Allahut e që ta falënderoni Atë.” Në këtë ajet, Allahu xh.sh. tërheq vëmendjen për plotësimin e ditëve të pa agjëruara, për njohjen e madhësisë së Allahut, i cili i krijoi këto lehtësi dhe se për të gjitha këto, Ai duhet falënderuar.¹⁵

Gjatë historisë, pothuajse në të gjitha fetë, agjërimi është zhvilluar si një shkollë edukative shpirtërore që forcon besimin. Agjëruetit priren drejt një jete të shëndetshme fizike dhe shpirtërore. Rizgimi dhe dhembshuria që sjell agjërimi te njeriu e bën atë një individ të ri, i cili mendon ta bëjë jetën e tij më të mirë duke hequr dorë nga një shpirt ambicioz, duke lënë luksin për të kontribuar në eliminimin e varfërisë dhe duke krijuar lehtësira për të tjerët. Pra, agjërimi ofron përfitime të panumërta për njeriun, sikur që përmendet në këtë ajet kuranor: “Mirëpo po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.”¹⁶

1 Bekare, 2/184, 196, 187; Nisa, 4/92; Maide, 5/89,95; Merjem, 19/26; Muxhadele, 58/4.

2 Bekare 2/183-186.

3 Kasani, Sana’i’f, v. II, fq.75.

4 Er-Razi, Mefatihul’l-Gajb, v. V, fq. 75.

5 Ibën Kajjim el Xhevziye, Zadu’l-Mead, v. II, fq.621.

6 Ibën Kethir, Tefsiru’l-Kur’ani’l-Adhim, v. I, fq. 497, Sulemi, Hakaiku’t-Tefsir, fq. 80.

7 Bekare, 2/183.

8 Muhamed Reshid Rida, El-Menar, v. I. Fq. 70.

9 Bekare 2/183.

10 Buhari, Iman, 28.

11 Er Razi, Mefatihul’l-Gajb, v. II, fq. 77.

12 Bekare 2/184.

13 Alusi, Ruhu’l-Meani, V. II, fq. 70.

14 Bekare, 2/184.

15 Zemahsheri, Keshshaf, v.I, fq. 172.

16 Bekare 2/84.

Përsiatje shkencore rreth ajeteve të agjërimit (2)

Mr. Samir Zullufi

“**M**uaji Ramazan është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që është prezent në këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’ua lehtësojë dhe jo që t’ua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugën e drejtë e që ta falënderoni Atë.” (El Bekare, 185).

Ky është ajeti në të cilin Allahu xh.sh. në mënyrë të prerë e obligon agjërimin e muajit Ramazan dhe derogon normën paraprake e që ishte agjërimi me mundësinë e zgjedhjes ndërmjet agjërimit e kompensimit, që është interpretuar në trajtesën paraprake. Kjo gjithashtu lë të kuptohet se ky ajet ka zbritur më vonë se ajetet pararendëse të agjërimit.¹ Shpjegimin e tij dhe mësimet kryesore që i nxjerrim nga ai mund t’i përmbledhim në pikat në vijim:

Muaji Ramazan është muaj i veçantë, sepse në këtë muaj ka zbritur Kurani, dhe për këtë zbritje kemi dy interpretime kryesore, i pari: se është fjala për zbritjen e tij të plotë nga *Leuhi’l-Mahfudh* në qiellin e kësaj bote, e pastaj pjesë-pjesë për njëzet e tri vjet i ka zbritur Muhamedit a.s.. Ky mendim shkon konform me ajetet tjera, siç është ai në suren El Kadr² dhe është mendimi i shumicës së dijetarëve.³ Kurse interpretimi tjetër është se

në muajin Ramazan i ka filluar zbritja e tij Muhamedit a.s. dhe ka vazhduar për njëzet e tri vjet, pra sipas kësaj, me zbritjen e përmendur në ajet, nënkuptohet fillimi i zbritjes së tij e jo i tëri.⁴ Si do që të jetë, nga ky ajet kuptohet se edhe Nata e Kadrit është në këtë muaj, ngase në ajetin që iu referuam më herët thuhet qartë: “Ne e kemi zbritur (Kurandin) në Natën e Kadrit” (El Kadr, 1); pra kjo natë është një nga netët e këtij muaji. Dhe meqë vlera e Natës së Kadrit dhe shumëfishimi i shpërblimeve në të dihet, kjo duhet ta motivojë besimtarin edhe më tepër për shtim të veprave të mira gjatë Ramazanit.

Folja (شَهْد) në fjalinë (فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ) në këtë ajet i ka disa shpjegime. Interpretimi më i pranuar është se e ka kuptimin: kush është prezent gjatë muajit, pra që nuk është udhëtar le të agjërojë.⁵ Kurse shpjegimi tjetër është: kush e *percepton* me mendjen e tij.⁶

Më pas, shpjegohet përsëri edhe në këtë ajet se të sëmurëve dhe udhëtarëve⁷ u lejohet t’i agjërojnë më vonë aq ditë të Ramazanit që nuk i kanë agjëruar, që të bëhet e qartë se ata janë të lehtësuar nga obligimi i agjërimit në gjendjen e tyre, e që është i prerë kësaj radhe; apo përsëritja e normës rreth tyre është bërë për ta qartësuar se lehtësimi rreth tyre i shpallur në ajetin paraprak nuk është deroguar.⁸

Më pas, vihet në pah se Allahu dëshiron për neve lehtësim dhe jo vështirësi. Kjo në kontekstin e ajetit kuptohet se dëshiron të na e lehtësojë përmes këtyre përjashtimeve për të sëmurët, udhëtarët dhe kategoritë që i pasojnë,

Në kontekstin e ajetit kuptohet se dëshiron të na e lehtësojë përmes këtyre përjashtimeve për të sëmurët, udhëtarët dhe kategoritë që i pasojnë, e nuk na e ka vështirësuar që t’i obligojë ata me agjërim në gjendjen e tyre, duke ua mundësuar agjërimin më vonë.

*Mos iu afroni atyre
(bashkëshorteve)
gjatë kohës kur
mbylleni për
adhurim në xhami!
Këta janë kufijtë e
Allahut,*

e nuk na e ka vështirësuar që t'i obligojë ata me agjërime në gjendjen e tyre, duke ua mundësuar agjërimin më vonë. Apo nuk na e ka vështirësuar që të na obligojë me agjërime më gjatë se një muaj në vit.⁹

Më pas, vijon ajeti me shpjegimin se duhet të plotësohen aq ditë të lëna për të sëmuret dhe udhëtarët kur të shërohen, respektivisht të kthehen nga udhëtimi. Dhe kështu të madhërohet Allahu dhe të falënderohet për udhëzimin e Tij, mundësimin e kryerjes së këtij obligimi, por edhe për lehtësimet e Tij. Nga

kjo pjesë e ajetit përfitohet gjithashtu edhe legjitimiteti i tekbirove të Bajramit.¹⁰

Jo më kot Ramazani quhet edhe muaji i Kuranit. Ky ajet na bën me dije madhësinë e tij dhe rëndësinë që ka zbritja e tij, duke e bërë obligim agjërimin e muajit të zbritjes. Kjo na fton që ta shtojmë përkushtimin tonë ndaj Kuranit gjatë këtij muaji përmes leximit të tij, meditimit rreth domethënies së tij, e çështje më e rëndësishme shtimit të praktikimit të tij në jetët tona.

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutës, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë. (El Bekare, 186).

Në mesin e ajeteve të agjërimit kemi këtë verset që në shikim të parë nuk ka lidhje direkte me agjërimin, porse tefsirologët e lidhin kuptimisht me fundin e ajetit paraprak, e nga vendndodhja e tij mund të nxirren shumë urtësi. Nga komenti i tij veçojmë pikat vijuese:

Për shkakun e zbritjes së këtij ajeti janë disa variacione të përcjella në librat e tefsirit. Më i afërti me përmbajtjen e ajetit është transmetimi i shënuar nga Taberiu se dikush e pyeti Pejgamberin a.s.: “O Muhamed, a është Zoti ynë afër që ta lusim me zë të ulët, apo larg që ta thërrasim?” Dhe kështu Allahu e zbriti këtë ajet.¹¹

Nga urtësitë e vendndodhjes së tij është se ky ajet jep indikacione se agjëruesi me të drejtë shpreson në përgjigje të lutjes së tij, dhe se muaji Ramazan është koha e duhur për lutje, si dhe ligshmëria e duave në fund të çdo dite të Ramazanit.¹²

Ne këtë ajet, Allahu nuk e përdorë shprehjen “thujtu” siç ndodh rëndom në përgjigjet e pyetjeve të drejtuara



Pejgamberit a.s. në Kuran. Kjo vërteton madhësinë e lutjes në shumë forma, dhe indikon afërsinë e lutësit me Allahun kur lutet, sikur do të thotë se ti mund të kesh nevojë për ndërmjetës në çështje tjera, por jo kur më lutesh Mua.¹³

“Tani është e lejuar për ju që, gjatë netëve të agjërimit, të shkoni me bashkëshortet tuaja. Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato. Allahu e di mirë se ju e keni mashtruar veten (duke shkuar me gratë para se të zbriste lejimi), por Allahu e ka pranuar pendimin tuaj dhe ua ka falur gabimin. Prandaj, ju lejohet bashkimi me bashkëshortet tuaja dhe tani kërkoni atë që ka caktuar Allahu për ju. Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin derisa të bjerë mbrëmja. Mos iu afroni atyre (bashkëshorteve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurim në xhami! Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos iu afroni atyre! Kështu, pra, Allahu ua shpjegon njerëzve urdhëresat e veta, që ata të ruhen nga të këqijat (arrijnë devotshmërinë).” (El Bekare, 187).

Ky është verseti i fundit i ajeteve të agjërimit, i cili përmbush normat rreth tij dhe përfundon me porosinë e njëjtë sikur ajeti i parë, me fjalët për devotshmërinë. Më poshtë sjellim shkurtimisht elementet kyçe të komentit të tij dhe disa norma që nxirren nga ai:

Si shkak i zbritjes së këtij ajeti përcillet se besimtarëve në fillet e para u ndaloheshin marrëdhëniet intime dhe ushqimi pas namazit të jaciesë në Ramazan; po ashtu nëse flinin gjumë pas iftarit nuk lejoheshin të njëjtat deri në iftarin e ditës tjetër. Disa nga myslimanët e thyen këtë rregull dhe u ankuan tek i Dërguari i Allahu a.s., dhe kështu zbriti ky ajet.¹⁴

Ne këtë verset përdoret shprehja (لياسي) për raportin burrë-grua, që mund të përkthehet si petk. Kjo ngase bashkëshortët janë afër njeri-tjetrit në shtrat dhe jo vetëm, sikur që janë petkat ndaj trupave. Apo se sikur që e mbron petku njeriun nga të ftohtit, edhe burri e gruaja e ruajnë njëri-tjetrin nga mëkati. Kuptimi tjetër që nxirret është se ata janë prehe për

njëri-tjetrin; dhe të gjitha këto janë shumë kuptimplota.¹⁵

Këtu përmendet tradhtia ndaj vetes pa u caktuar se për çka bëhet fjalë. Por konteksti i ajetit nga ajo që vjen përpara dhe mbrapa e qartëson se fjala është për marrëdhëniet intime pas jacisë apo pas gjumit, që ishin të ndaluara; e nëse bazohemi në shkakun e zbritjes edhe ngrënia pas jacisë apo pas gjumit. Quhet tradhti sepse është e kundërta e asaj që pritet prej besimtarëve, që të mos i thyejnë rregullat e Zotit; por edhe se çdo shkelje e normave të tij nga njeriu shkakton dënim për veten e tij, që i bie sikur ta tradhtonte atë.¹⁶

Në këtë ajet me foljen (يُسْرِوْهُنَّ) në formën urdhërore për marrëdhënie intime, e të shprehur në mënyrë metaforike, kuptohet lejimi i tyre meqë ishin të ndaluara. Kurse kërkimi për atë që e ka shkruar Allahu, sipas shumicës së tefsirologëve është për qëllim kërkimi i fëmijës/pasardhësve. Përveç këtij mendimi që është më afër kontekstit, thuhet po ashtu se mund të jetë për qëllim kërkimi i Natës së Kadrit. Rraziu këtu përmend gjithsej tetë mendime, dhe nuk e përjashton të jetë për qëllim Nata e Kadrit.¹⁷ Kurse Taberiu thotë se kuptimi i saj është kërkimi i asaj që Allahu ka përcaktuar për ju, duke theksuar se çdo gjë është e shkruar në Leuhi'l-Mahfudh; pra kush do fëmijë ta bëjë, kush kërkon Natën e Kadrit le ta bëjë, madje nuk e përjashton të synohet për ta kërkuar nga Allahu çdo gjë që është e mirë, ani pse sipas tij më afër është mendimi i parë.¹⁸

Në këtë ajet përcaktohet intervali kohor i agjërimit, që është prej kohës kur dallohet bardhësia e agimit të vërtetë nga errësira e natës deri në përfundim të diellit. Sipas Taberiu, ky interpretim është më i sakti në mesin e disa varianteve për kuptimin e perit (fijes) të bardhë dhe perit (fijes) të zi, që përdoret këtu me kuptimin alegorik. Kjo ngase ka një hadith të shënuar në dy koleksionet e sakta ku Pejgamberi a.s. ia shpjegon sahabiut Adij ibën Hatimi r.a., i cili e kishte kuptuar fjalëpërfjalshëm ajetin, duke i thënë: “ajo është errësira e natës dhe bardhësia e ditës”. (Buhariu, 1916, 4510; Muslimi, 1090).¹⁹

Më pas urdhërohet të mbahet agjërimi deri në mbrëmje,²⁰ dhe norma tjetër që përmban ky ajet është rreth itikafit. Meqenëse u lejua intimiteti gjatë natës ndërmjet bashkëshortëve në pjesën e parë të ajetit, këtu Allahu na bën me dije që një gjë e tillë nuk lejohet për ata që janë në itikaf.²¹ Dhe më pas urdhërohet respektimi i ndalesave dhe normave të Zotit duke mos i shkelur ato, dhe përmbillen ajetet e agjërimit duke theksuar se ashtu siç i ka bërë të qarta këto rregulla, Ai i ka bërë të qarta edhe dispozitat dhe argumentet e tjera, që të bëhemi të devotshëm.

Jo rastësisht këto ajete përmbillen duke ritheksuar devotshmërinë, ngase Ramazani me agjërimit dhe çdo gjë tjetër rreth tij janë mundësia më e mirë për ndryshime pozitive.

Jo rastësisht këto ajete përmbillen duke ritheksuar devotshmërinë, ngase Ramazani me agjërimit dhe çdo gjë tjetër rreth tij janë mundësia më e mirë për ndryshime pozitive. Në kohën kur e mundim unin dhe fizikun tonë duke kaluar orë të tëra pa ngrënë e pirë, mund dhe duhet të largohemi nga veset e këqija. Për më tepër, nëse do ta përkufizonim agjërimit me një fjalë, ajo do të ishte përmirësim; ngase përmes tij shtojmë imanin, durimin dhe solidaritetin me të tjerët; po ashtu përmirësojmë shëndetin dhe marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Me fjalë të tjera, Ramazani sjell shumë mirësi dhe vjen që të lërë gjurmë të ne, duke na ndryshuar për të mirë, prandaj nuk guxojmë të dalim nga ai në të njëjtën gjendje që ishim; e Allahu e di më së miri.

- 1 Meqë nga kushtet e derogimit është që teksti derogues të jetë shpallur më vonë.
- 2 El Kadr, 1.
- 3 Muhamed Xherir et-Taberi, *Xhamiu'l-bejan an te'u'il aji'l-Kur'an*, botimi i parë, Kajro: Daru Hixhr, 2001, III/188; Ismail Omer ibën Kethir, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-adhim*, botim i dytë, Daru Tajjibe, 1999, I/501-502.
- 4 Ndër ata që përkrahin këtë mendim janë Zemahsheri dhe Ibën Ashuri, (Muhamed Amr ez-Zemahsheri, *El-keshshaf an hakaiki gauamidi't-tenzil*, botimi i tretë, Bejrut: Daru'l-Kitabi'l-Arabij, 1987, I/227; Muhamed Tahir ibën Ashur, *Et-tahriru ue't-tenuir*, Tunizi: Daru't-Tunusije li'n-Neshr, 1984, I/172).
- 5 Taberiu, Zemahsheri, dhe Ibën Ashuri janë të këtij mendimi, (Taberiu, vepra e cekur, III/201; Zemahsheri, vepra e cekur, I/228; Ibën Ashuri, vepra e cekur, II/273).
- 6 Rraziu zgjedh këtë mendim, (Muhamed Omer err-Rrazi, *Mefatihul-gajb (Et-tefsiru'l-kebir)*, botimi i tretë, Bejrut: Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, V/255).
- 7 Shpjegimet e detajuara rreth të sëmureve, udhëtarëve dhe kategorive përcjellëse janë bërë në komentin e ajetit paraprak, (shiko nr. paraprak të revistës).
- 8 Abdullah Omer el-Bejdavi, *Enuaru't-tenzil ue esraru't-te'u'il*, botimi i parë, Bejrut: Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, 1997, I/125.
- 9 Taberiu, vepra e cekur, III/218; Rraziu, vepra e cekur, V/258.
- 10 Taberiu, vepra e cekur, III/221; Bejdaviu, vepra e cekur, I/125.
- 11 Shiko: Taberiu, vepra e cekur, III/222.
- 12 Ibën Ashuri, vepra e cekur, II/179.
- 13 Shiko: Rraziu, vepra e cekur, V/264; Ibën Ashuri, vepra e cekur, II/179.
- 14 Ali Ahmed el-Uahidi, *Esbabu'n-nuzul*, (botimi i dytë, Dammam: Daru'l-Islah, 1992), 50.
- 15 Taberiu, vepra e cekur, III/231-233; Rraziu, vepra e cekur, V/269-270.
- 16 Rraziu, vepra e cekur, V/270-271.
- 17 Rraziu, vepra e cekur, V/272.
- 18 Taberiu, vepra e cekur, III/247.
- 19 Muhamed Ismail el-Buhari, *Sahihu'l-Buhari*, botimi i parë, Daru Tuki'n-Nexhah, 2001, III/28, VI/26; Muslim El-Haxhaxh, *Sahihu Muslim*, Bejrut: Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, II/766; Taberiu, vepra e cekur, III/259.
- 20 Dijetarët e shkollës hanefite argumentohen me këtë për obligueshmërinë e plotësimi të agjërimit vullnetar, shiko: Ahmed Ali el-Xhessas, *Ahkamu'l-Kur'an*, botimi i tretë, Bejrut: Daru'l-Kutubi'l-Ilmiye, 2007, I-283-293.
- 21 Shiko: Xhessas, vepra e cekur, I/293-303; Muhamed Ahmed el-Kurtubi, *El-xhamiu li ahkami'l-Kur'an*, botimi i dytë, Kajro: Daru'l-Kutubi'l-Misrije, 1964, II/332-337.

Vlerat edukative të Ramazanit

Dr. Ejup Haziri

“Dhe nëse është dita e agjërimit të njerit prej jush, ai të mos bëjë vepra të pahijshme e as të mos bërtasë, nëse dikush e fyen ose e lufton, ai le të thotë: “Unë jam agjërues.”

HYRJE

Agjërimi i Ramazanit është padyshim një përvojë me ndikim të madh në të gjitha aspektet e personalitetit të individit, sjelljes, qëndrimeve, përgatitjeve, ndjenjave, vlerave, idealeve, pikëpamjeve për jetën, madje edhe në shëndetin e tij fizik. Agjërimi është padyshim një shkollë gjithëpërfshirëse për të edukuar individin për shumë vlera, virtyte, cilësi të mira dhe për shumë zakone të mira të sjelljes dhe prirjeve pozitive.

Ndjenja e bindjes krijon një ndjenjë kënaqësie dhe lumturie te besimtari. Ai duhet të vetëpërmbahet dhe të ruhet maksimalisht nga të gjitha të këqijat. Agjërimi ka një rëndësi të madhe që e mëson një person me disiplinën dhe respektimin e kohës së agjërimit dhe ia mëson oraret e gjumit, ushqimit, adhurimit, vizitave dhe gjërave të tjera.

ARRITJA E DEVOTSHMËRISË

Kur flitet në Kuran për obligueshmërinë e agjërimit, përfundohet me fjalët: “...që të bëheni të devotshëm.” (El Bekare, 183), e ky është synimi primar edukativ që njeriu e fiton përmes agjërimit, ngase kjo është esenca. Devotshmëria është një fryt i natyrshëm i një procesi jo aq të lehtë, ku myslimani investon në besimin e tij me agjërimin që bën në ringjalljen e frymës së besimit dhe kuptimeve të tij, duke përfshirë ndjesinë e sinqeritetit dhe mbikëqyrjes hyjnore. Vetëm Zoti është ai që shikon

myslimanin, dhe çdo individ mund të jetë vetëm me veten e tij dhe ta “tradhtojë” agjërimin e tij duke ngrënë, pirë ose duke bërë gjëra të tjera që e prishin agjërimin, dhe asgjë nuk e pengon atë për ta bërë këtë veçse frika nga mbikëqyrja hyjnore dhe besatimi dhënë Krijuesit. Pra, është një ndjesi shumë e fuqishme, e cila buron nga brenda, por që reflekton jashtë, që pa marrë parasysh mundimet dhe tundimet e jashtme, i qëndron besnik mesazhit hyjnor. Thjesht nuk tundohet nga ofertat joshëse, por hapëron lart në shtigjet e imanit duke u shoqëruar me vepra të dobishme. Me fjalë të tjera, agjërimi synon që ta ngrit myslimanin në një stad më të lartë dhe më të mirë. Ai synon që myslimanin ta bëjë më të mirë se që ishte para Ramazanit dhe se grada e devotshmërisë nuk arrihet duke ndenjur e shpresuar, por me një angazhim të madh që reflekton thellë në vetë qenien e myslimanit.

KONTROLLIMI I VETES DHE RUAJTJA E MORALIT

Islami, në të gjitha format thërret myslimanin për durim, maturi e vetëpërmbytje, ndërsa fokusi është më tepër gjatë periudhës së Ramazanit, ngase vetëm distancimi nga uria dhe etja nuk janë të mjaftueshme në procesin e agjërimit, mirëpo duhet mishëruar me elemente të tjera, ngase shpërblimi i agjëruesit duhet të kalojë domosdo përmes integritetit moral të agjëruesit, në përputhje të plotë me fjalët e të Dërguarit: “Dhe nëse është dita e agjërimit

të njërit prej jush, ai të mos bëjë vepra të pahijshme e as të mos bërtasë, nëse dikush e fyen ose e lufton, ai le të thotë: “Unë jam agjërues.”¹

Ndoshta gjendja fiziologjike e trupit gjatë procesit të agjërimit, mund ta bëjë atë më të ndjeshëm ndaj emocioneve dhe se ngritja shpirtërore që realisht duhet të ndodh tek agjëruesi, duhet ta bëjë atë rezistent ndaj provokimeve të jashtme dhe përmbajtjes maksimale ndaj vetes. Gjëja më e mirë është tejkalimi i një zemërimi përmes adaptimit të moralit të mirë dhe heshtjes, pa ofenduar askënd gjatë agjërimit të tij. E, në rast të hidhërimit, le ta kujtojë ai se është agjërueshëm dhe se është nën mbikëqyrjen hyjnore, që nëse nuk mund të përmbahet, më e pakta që mund të pësojë është shkuarja e një pjesë të shpërblimit.

Toleranca, butësia dhe morali duhet të jenë prej kohësh të integruara mirë në vetë karakterin e myslimanit që ta zmbarsin të keqen me të mirë dhe mos t'i lënë vend veprimeve të pamatura që mund të krijojnë reaksione të çastit, të cilat mund të sjellin edhe pasoja të palumueshme.

Tekstet fetare konfirmuan se qëllimi i agjërimit nuk është vetëm distancimi nga uria e etja. Nuk është qëllimi të testosh aftësitë tua fizike e trupore për të duruar ndaj urisë e etjes, porse qëllimi është ta mbash vetën nën kontroll dhe ta ruash dinjitetin e moralin tënd. Kjo e fundit është pikërisht bazamenti kryesor i agjërimit, që ndoshta edhe nuk i kushtohet vëmendje sa duhet, apo ndoshta nuk i kushtohet vëmendje sikur kujdesit ndaj bukës e ujit. Si konfirmim i kësaj, i Dërguari i Allahut, qartë tha në njërin prej thënieve të tij: “Ai i cili nuk i lë fjalët e këqija (rrenën, mashtrimin) dhe punët e këqija, Allahu nuk ka nevojë për të që ai ta lë ushqimin dhe pijet e tij (për të agjëruar).”²

Agjërimi i tij në rastet kur ai nuk e ruan gjuhën nga mashtrimi, rrena dhe nuk e ruan moralin e tij, është i pavlerë, ndërsa largimi i tij ndaj urisë e etjes është vetëm një vështirësi që e përjeton, e cila në fund edhe nuk ka shpërblim. Andaj në një thënie tjetër ai tha: “Ndoshta dikush prej agjëruesve nuk fiton asgjë prej agjërimit të tij përpos urisë.”³

Për agjëruesin që është në gjendje të përmbahet nga ushqimi dhe pijet dhe të frenojë epshin e tij, ky agjërimit i tij do t'i sjellë atij një shpërblim të madh dhe efekte të mëdha që kontribuojnë në përmirësimin e anës së tij shpirtërore, korrigjimin e vetes dhe forcimin e shëndetit të tij.

SHTIMI I VEPRAVE TË MIRA

Ndërgjegjësimi i besimit të myslimanit kërkon pjesëmarrjen në adhurim, agjërimit, lutje, leximin e Kuranit, dhe të gjitha këto kërkojnë që të shijohen dhe të përjetohen, përndryshe ka frikë që mbesin rite sa për t'u kryer formalisht. Mirëpo formaliteti nuk ka vlerë në Islam!


Rruga e besimit dhe e përkushtimit duhet të pasqyrohet në rrugën e ndërveprimit etik. Rruga etike-edukative është e lidhur ngushtë me shkollën edukative të Ramazanit. Forcimi i lidhjeve shoqërore dhe i lidhjeve familjare është direkt

produkt i këtij muaji madhështor që ofron zemrat, largon urrejtjen dhe shkrin pengesat mes tyre.

Agjërimi është shkollë e dëlirësisë dhe e virtytit, shkollë e largimit nga fjalët e kota, e tolerancës, e faljes, e lënies së grindjeve dhe e mosmarrëveshjeve, dhe se pikërisht në muajin Ramazan ka një atmosferë të jashtëzakonshme për mësimin e shprehive pozitive morale dhe heqjes dorë nga veset e këqija. Kur kjo të arrihet, atëherë ana tjetër e medaljes është e gatshme për shtimin e mirësive dhe bujarive. Realisht shtimi i veprave pasqyron vlerat tona dhe gatishmërinë tonë për ndryshimin pozitiv që duhet të ndodh. E pikërisht ditët e këtij muaji janë një mundësi e artë për shtimin e veprave, sepse vlera e tyre në këtë muaj është e pakrahueshme me muajt e tjerë. Sa për ilustrim, mjafton ta përmendim një thënie të të Dërguarit të Allahut që e dëshmon atë që po e elaborojmë: “Kush e falë namazin e teravisë me imam, (dhe qëndron) derisa imami ta përfundojë tërë namazin, i shkruhet atij sikur të jetë falur tërë natën.”⁴

Hadithi është sinjalizues i qartë se ai që fal namazin e teravisë derisa imami ta përfundojë atë, atij i shkruhet sikur të jetë falur tërë natën dhe se kjo vlerë e shtuar ka të bëjë veçanërisht me muajin Ramazan. Ky është suneti, ndërsa ata që falën vetëm një pjesë, e pastaj dalin prej xhamisë, gjersa imami vazhdon të falet me një pjesë tjetër, e kanë gabuar sunetin dhe realisht i kanë keqkuptuar edhe tekstet fetare!

Andaj, shtimi i veprave të mira është vlerë që duhet marrë dhe se kjo vlerë nuk mund të kufizohet brenda një apo vetëm disa veprave, por ajo është e gjerë dhe e larmishme dhe se prej të mirës sado që e vogël të jetë nuk duhet përbuzur asgjë.





Në këtë muaj të shenjtë arrihen dimensionet sociale të agjërimit, duke bashkndjerë me të varfrit dhe skamnorët, të cilët janë të privuar prej shumë gjërave.

Mjafton që myslimani të orvatet në shtimin e veprave dhe këtë duhet ta bëjë sipas prioriteteve duke thyer rutinën dhe ndryshuar përditshmërinë e tij, në mënyrë që t'i shfrytëzojë mundësitë në përfitimin dhe shtimin e vlerave.

PËRKUSHTIMI MAKSIMAL NDAJ KOHËS

Meqë Ramazani është një muaj dhe ditë të caktuara, kërkohet nga myslimani që të jetë i përgatitur maksimalisht dhe paraprakisht të hartojë ndonjë plan për gjërat që do t'i bëjë gjatë atij muaji, në mënyrë që të mos zihet në "befasi" dhe në fund t'i kalojnë ditët pa plan e pa organizim. Mjaftojnë të vështrohen ajetet e agjërimit dhe të shihet përmbajtja, shpërndarja e ajeteve dhe mesazheve që ato bartin, ku fillohet me obligueshmërinë e agjërimit, më pas zë vend vlera dhe virtytet e muajit Ramazan, pastaj normat dhe kriteret që ndërlidhen ngushtë me agjërimin, e në fund lutjet dhe pjesa intime mes bashkëshortëve. Kjo ndarje nuk është e rastësishme, por e qëllimshme dhe sipas prioriteteve, ku secilës i jepet hapësirë dhe kohë. Madje vetë agjërimi si adhurim ka bërë një hartë për kohën e myslimanit, e cila përfshin kufijtë e agjërimit, fillimin dhe mbarimin e tij, dhe se këto orare duhen respektuar, përndryshe agjërimi është i

pavlerë. Krahas kësaj, brenda kësaj harte janë edhe kohët e namazit dhe veprat që duhet bërë.

Krejt çfarë kërkohet prej nesh është t'i ndajmë prioritetet dhe t'i shënojmë punët fisnike që meritojnë të kryhen gjatë këtij muaji, si namazi, leximi i Kuranit, shtimi i veprave, bamirësia, solidariteti, vizitat në familje e miqësi, etj.

E që koha të shfrytëzohet maksimalisht, duhet të inkorporohen katër elemente dhe t'u jepet hapësirë secilës prej tyre: Koha e gjumit, koha e punës, përgjegjësia ndaj familjes dhe koha e adhurimit. Kur këto katër elemente të jenë rregulluar mirë, çdo gjë mbi to do të jetë në rregull dhe që të gjitha mund të arrihen pa ndonjë problem. E, nëse e para nuk është në rregull, atëherë ajo domosdo do të reflekton te të tjerat dhe realisht mund të humben të gjitha.

Nuk është e rastësishme se pse i Dërguari i Allahut pas namazit të jaxisë preferonte gjumin, para bisedave. Po ashtu nuk është e rastësishme se përse i Dërguari i Allahut kishte traditë të ulej para iftarit me anëtarët e tjerë dhe të lutej. Realisht para iftarit është koha kur myslimani është më i lodhur, më i etur, më i uritur dhe në vend të gjumit apo ndonjë ankese të mundshme të atyre çasteve, myslimani i shfrytëzon maksimalisht edhe ato çaste në kultivimin e vlerave të muajit Ramazan si një muaj madhështor.

QËNDRUESHMËRIA NDAJ URISË

Një nga qëllimet e agjërimit është të rrënjosë vlerën e durimit dhe qëndrueshmërisë ndaj urisë, etjes dhe privimit nga ushqimi dhe pijet. Qëndrueshmëria, vullneti dhe vendosmëria shprehen në mënyrë që vullneti i njeriut të mund të drejtojë dhe kontrollojë sjelljen e tij. Përndryshe nëse njeriu s'mund t'i kontrollojë sjelljet e tij, ai humb vlerat e larta që posedon si krijesa më e veçantë.

Në këtë muaj të shenjtë arrihen dimensionet sociale të agjërimit, duke bashkndjerë me të varfrit dhe skamnorët, të cilët janë të privuar prej shumë gjërave. Myslimani kujton njerëzit që nuk kanë për të ngrënë e për të pirë, andaj përjeton dhe ndien të njëjtat gjëra që ata i përjetojnë. Me këtë sikur ai kujton fjalët e të Dërguarit të Allahut i cili tha: "Besimtari për besimtarin është sikurse një ndërtesë që njëra pjesë mbështet pjesën tjetër."⁵

Në anën tjetër, kjo është një shenjë për të medituar e falënderuar Krijuesin për dhuntinë, prej të cilave një pjesë e njerëzve janë të privuar prej tyre.

TUBIMI NË NJË SOFËR

Në këtë dinamikë të re të jetës, njerëzit janë larguar nga njëri-tjetri dhe angazhimi i tyre ka krijuar situata që edhe nëpër familje ata të mos gjejnë kohë të mjaftueshme për të biseduar apo për t'u takuar. Muaji i bekuar Ramazan, përmes tryezës së iftarit, rrit dashurinë, krijon afërsi mes tyre, rikthen komunikimin familjar, afron ata me të dashurit dhe të afërmit e tyre dhe si rrjedhojë lidhjet e tyre bëhen më të fuqishme dhe më solide. Është sofra e iftarit që krijon atmosferë të veçantë familjare, që rikthen harmoninë dhe dashurinë në familje mes të moshuarit e të riut dhe mes gjithë anëtarëve të familjes. Në këtë tryezë takohet babai me fëmijët, pse jo edhe me nipërit e mbesat që është mundësi ideale për të forcuar lidhjet me të gjitha brezat brenda një familjeje. Shkurt e thjesht, është koha e familjes që të gjithë bashkohen pranë sofrës së iftarit, duke trashëguar një traditë të shkëlqyer për shekuj me radhë dhe kjo gjithsesi mbetet një mundësi e artë për ta rikthyer edhe një herë harmoninë dhe dashurinë mes anëtarëve të familjes.

Këtë mundësi brilante ku gjithë anëtarët mblidhen pranë një sofre nuk mund ta zëvendësojë asgjë tjetër, madje as restorantet më të shtrenjta dhe harmoninë e dashurinë e familjes pranë asaj sofre nuk mund të arrihet as në vendet më të shtrenjta e luksoze.

SHPËRBLIMI MË I MADH GJATË RAMAZANIT

Gratë në përgjithësi përveç lodhjes nga agjërimi i tyre, bëjnë një përpjekje madhështore në përgatitjen e syfyrit e iftarit. Ato kujdesen për punët e shtëpisë, për gatimin, për fëmijët, kujdesin dhe edukimin e tyre. Nuk është lehtë të

zgjohesh në mesin e natës e të përgatitësh ushqim për gjithë anëtarët e familjes, ashtu siç nuk është e lehtë që gjatë ditës kur ndoshta ajo ndien lodhje e vapë, të përgatit ushqim për kohën e iftarit. Prandaj me të drejtë, ato kanë një shpërblim të madh, sepse përveç agjërimit që bëjnë, ato përgatisin syfyr e iftar për gjithë agjëruarit. Me të drejtë ato kanë shpërblimin e agjërimit që agjërojnë, shpërblimin e punës dhe shpërblimin e përgatitjes së iftarit e syfyrit.

Sa bukur tha i Dërguari i Allahut: "Kush ushqen një agjëruar, do ta ketë shpërblimin e tij, pa i munguar asgjë nga shpërblimi i agjërimit të tij (saj)."⁶

SOLIDARITETI NË VEPËR

Myslimani kujdeset ta ndjek shembullin e të Dërguarit të Allahut, i cili gjatë tërë jetës së tij ishte bujar dhe njëhej për bujarin, por në muajin Ramazan e shtonte edhe më tepër bujarinë e tij.

Ai mishëroi modelin më të lartë të dhembshurisë dhe dhënies. Ai ndjente keqardhje, por nuk ndalej me të, mirëpo i ndihmonte nevojtarët përmes lëmoshës, zekatit e formave të tjera. Ai këtë e bënte gjithnjë, por solidariteti gjatë muajit Ramazan shtohet edhe më tepër.

Muaji Ramazan forcon konceptin e solidaritetit dhe bashkëpunimit mes komunitetit mysliman. Solidariteti dhe bashkëpunimi ndërmjet myslimanëve tregohet përmes ndihmës dhe kontributit që anëtarët e komunitetit mysliman u japin vëllezërve të tyre myslimanë në nevojë. Veprime të tilla gjithnjë shfaqen qartë gjatë muajit të bekuar Ramazan. Islami kërkon t'i rrënjos thellë në zemrat e myslimanëve manifestimet e dashurisë dhe mëshirës midis miqve dhe familjeve myslimane, të cilat përfshijnë shumë kuptime të thella dhe ndjenja fisnike. Kur ekziston një bashkëpunim i tillë, atëherë edhe rezultati do të jap frytë, ngase Allahu na bëri ftesë për një bashkëpunim të tillë në punë të mira: "...Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e assesi në mëkate e armiqësi..." (El Maide, 2).

Ky solidaritet e bashkëpunim shprehet pikërisht në muajin e bekuar, përmes ndihmave të ndryshme, që realizohen në ditët e bekuara të muajit Ramazan, gjë e cila nuk ndodh gjatë muajve të tjerë ashtu siç ndodh gjatë Ramazanit. Ramazani është muaj ku kujtohen më tepër skamnorët, jetimët e njerëzit që kanë nevojë për përkujdesje e ndihmë. Me të drejtë, gjatë këtij muaji rrezaton një altruizëm dhe shtohet një kujdes i veçantë ndaj të tjerëve, e sidomos ndaj nevojtarëve.

1 Buhariu në Sahih, nr.1904.

2 Tirmidhiu në Sunen, nr.707.

3 Nesaiu në Sunen el-Kubra, nr.3249; Ibën Maxheh në Sunen, nr.1690.

4 Ebu Davudi në Sunen dhe Tirmidhiu në Sunen.

5 Buhariu në Sahih, nr. 2341.

6 Tirmidhiu në Sunen, nr. 807.

Agjërimi si vlerë sociokulturore

Dr. Xhevdet Rusinovci

“Çdokush mund të bëjë mrekulli, secili mund t’i arrijë ëndrrat e tij. Nëse është i aftë të mendojë, nëse është i aftë të durojë, nëse është i aftë të agjërojë.”

(H. Hesse)

Përmes normës obligative hyjnore, datuar nga mijëra vjet më parë, dhe përtej dobive të vërtetuara mjekësore, agjërimi ia del të paraqes një tjetër premisë të rëndësishme në jetën njerëzore. Me përmasa të pamatshme, si një institucion i solidaritetit, besimit në Zot, rigjenerimit fizik e shpirtëror, agjërimi pashmangshmërisht tani është vlerë e shtuar në edukimin dhe emancipimin e qytetarëve praktikues. Në këtë rol të vjetër e në forma të ndryshme, agjërimi vazhdon të jetë një normë e shenjtë hyjnore, e cila historikisht e ka udhëzuar njeriun si të jetojë, të besojë dhe të bashkëveprojë me të tjerët. Sot, i transformuar në rolin e tij bashkëkohor, agjërimi si burim asetesh etike, humane dhe i vlerave

universale njerëzore, ka ndikim të dukshëm në jetën sociale dhe kulturore të individit.

Agjërimi, të paktën në shoqëritë myslimane, mbetet ndër si “festivalet” më të gjata vjetore të demonstrimit të besimit, solidaritetit, paqes, humanizmit dhe sakrificës përmes abstenimit kryesisht nga ushqimi dhe pijet. Si i tillë, objektivi kryesor i tij synon ringjalljen e qëllimit të jetës, rritjen e të bashkëndjerit me tjetrin, të jetuarit në qetësi e paqe me rrethin, të kuptuarit e jetës altruiste dhe të kuptuarit e faljes hyjnore dhe njerëzore. Kështu, përmes vlerave sublime, agjërimi vë në fokus të projektuarit e jetës së individit brenda rrethit shoqëror, duke ia prezantuar modelet e sjelljes së qytetëruar të bazuara në rend dhe ligj, me individin ‘e





reformuar, i cili do të kontribuojë për mirëqenien dhe arritjet e përbashkëta të komunitetit.

Këtij individ, në parim së paku një herë në vit, agjërimi do t'i shërbejë si shkollë e ripërtëritjes, rishikimit dhe ndryshimit substancial të raporteve të tij me personin e tij/saj: egon, vetëkontrollin, vetëbesimin, forcën dhe dobësitë. Gjithashtu, do t'i reflektojë në lidhjet me familjen, shoqërinë, profesionin, dhe të gjitha së bashku do ta bëjnë këtë individ ta testojë mjaftueshëm veten lidhur me besimin si koncept i rëndësishëm jetësor. Për më tepër, agjërimi si regjim pozitiv ditor i sjelljeve të programuara njerëzore, do ta detyrojë individin që ta njohë fuqinë e besimit të kultivuar si pragmatizëm themelor për funksionimin normal të marrëdhënieve në jetën qytetare. Si rrjedhojë, bazuar në besimin e afirmuar, agjërimi luan rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe fuqizimin e raporteve sociale brenda komuniteteve të ndryshme përmes shtimit të respektit ndaj vlerave të diversitetit, tolerancës, mirëkuptimit dhe dashurisë.

Formësimi i këtyre vlerave në pakon kulturore të individit i tejkalon kufijtë e definimit të agjërit si vetëm një ritual fetar apo formë dietale në të mirë të shëndetit. Ai do t'ia ndryshojë psikologjinë e të menduarit dhe të sjelljes, duke e bërë të ndihet tërësisht ndryshe karshi realitetit dhe botës së jashtme që shpesh e percepton për të mirëqenë dhe të pa alternativë. Individit në agjërim do të lutet, do të meditojë, do të izolohehet, do të shpreh

**Agjërimi luan
rol të
rëndësishëm në
ndërtimin dhe
fuqizimin e
raporteve
sociale brenda
komuniteteve
të ndryshme
përmes shtimit
të respektit ndaj
vlerave të
diversitetit,
tolerancës,
mirëkuptimit
dhe dashurisë.**

e veprave brenda një spektri të ri sjelljesh në kërkim të fuqizimit të besimit hyjnor dhe njerëzor. Në një formë a tjetër, ai do të luajë aktorin e vërtetë të ndjenjave origjinale humane si uria, etja, lodhja dhe dëshpërimi, dhe do të mësojë t'i besojë tjetrit dhe ndjenjave të tij, e si aktor i jetës reale t'ia shndërrojë ato në mirëqenie, gëzim, lumturi dhe shpresë.

Reflektimi kulturor i individit agjëruar manifestohet në mikro dhe makro realitetet e tij/saj. Aplikimi i agjërit si kulturë e mësimit, vetëmohimit, dhe sakrificës, ekuilibron jetën personale dhe atë në bashkësi të individit, vë në balans anën emocionale e shpirtërore, dhe shton mundësitë e planifikimit më përmbajtësor familjar, shoqëror dhe profesional.

Agjërimi si praktikë mund të shtrijë ndikimin edhe në fushën e gastronomisë dhe të protokollit të tryezës. Kultura të ndryshme praktikuese mund të imponojnë etiketat e tyre relevante të përgatitjes së ushqimit duke përfshirë edhe brendet ushqimore gjatë periudhave të ndryshme agjëruese, si dhe të përcaktojnë protokolle të veçanta të tryezës komfor normave kulturore dhe tradicionale të komuniteteve përkatëse. Në kuptim të kësaj dhe tërë asaj që përfaqëson, "festa" e agjërit ka qenë, është, dhe mbetet event i vjetër kulturor dhe po aq modern në shërbim të ringjalljes së shpirtit dhe veprës humane të krijesës njerëzore.

Agjërimi është kulturë.

Ndërtimi i karakterit ndërmjet këshillave të psikologut dhe praktikimit të agjërit të Ramazanit

Mr. sci. mjek. Adem Zalihiq

“I mirë apo i keq” karakteri në kuptimin e përditshëm përkthehet si njeri i moralshëm ose jo i moralshëm.

Karakter-i, nga fjala greke χαρακτήρα - shenjë e ngulitur në monedhë, sot shënon grupin e të gjitha attributeve dhe cilësive të një personi, si: integriteti, guximi, morali, ndershmëria, besnikëria etj..

Koncepti i karakterit shfaqet në shumë teori të personalitetit, qoftë si koncept bazë apo përcjellës në shpjegimin e reagimit individual të individit. Nënkuptohej, se karakteri është kombinim i tipareve të ndryshme të një individi, i cili jep pamje të plotë atij personi. Karakteri është meritë për qëndrueshmërinë në reagimet e ndonjë personi kur ai gjendet në situata të ngjashme. Shpesh barazohet me personalitetin në tërësi, kështu që me atë

term përdoret në mënyrë të ndërsjellë, por mund të paraqet edhe kuptim më të ngushtë, dhe si i tillë më së shpeshti kryesisht karakterizon tërësinë personale të aspekteve sociale në strukturën e personalitetit, motivues, morale apo konative (konativ: dëshirë vullnetare).

Ndonjëherë ky term përdoret në një kuptim edhe më të ngushtë, si gatishmëri e njeriut që të sillet në përputhje me normat morale. (“I mirë apo i keq” karakteri në kuptimin e përditshëm përkthehet si njeri i moralshëm ose jo i moralshëm).

Termat karakter dhe personalitet, tregojnë nevojën e përgjithshme njerëzore që të kuptohet individi, të shpjegohen veprimet



dhe të parashikohen sjelljet e tija. Kjo vlen aq sa për ta kuptuar njerëzit përreth nesh, si dhe për të kuptuar edhe veten tonë. Pa konceptet e personalitetit dhe të karakterit nuk do të ishim në gjendje të parashikojmë sjelljen e individit.

ÇRREGULLIMET E PERSONALITETIT

Të dhënat psikiatrike thonë se rreth 15% e të gjithë njerëzve të shtruar në spital me probleme mendore vijnë nga grupi i çrregullimeve të personalitetit, e në çrregullimet e personalitetit ka një shkallë të lartë të vetëvrasjeve dhe kombinimeve me lloje të tjera të problemeve mendore. Çrregullimet e personalitetit paraqesin mënyrën karakteristike dhe të vazhdueshme të sjelljes, të menduarit dhe ndjenjës që ndjeshëm deviojnë nga ajo që është normale. Këto devijime zakonisht paraqiten në sferën e vullnetit, epsheve dhe emocioneve, dhe atë në periudhën e adoleshencës. E vazhdojnë gjatë gjithë jetës, dhe nëse personat nuk kërkojnë ndihmë, është e mundur që ato të strukturohen në forma gjithnjë e më të rënda të sjelljes jo përshtatëse.

INSTINKTET DHE KARAKTERI

Instinktet janë sjellje të lindura, të trashëguara dhe të pamësuar, të cilët synojnë për kënaqësi. Nevojat instinktive nuk varen nga përvoja e individit, sipas modeleve të pamësuar të sjelljes, pakënaqësia provokon tension të brendshëm, e derisa kënaqësia përcjellët me ndjenjën e këndshme.

Dallojmë instinktet vitale dhe sociale. Instinktet vitale përfshijnë instinktin për vetë-ruajtje (instinkti për të ngrënë), instinkti për ruajtjen e llojit (instinkti seksual) dhe instinkti prindëror. Instinktet sociale janë afilative (afilativ: përshtatje, qasje) - për jetën në bashkësi me njerëzit e tjerë, instinkti për lojë dhe argëtim, për kuriozitet dhe hulumtim të risive, instinkti për vetëafirmim – të jesh i pranuar dhe i njohur nga të tjerët, të gesh vendin tënd në grup, etj..

FORMIMI I KARAKTERIT

Mbrojtjet e para të karakterit paraqiten në fëmijërinë e hershme, atëherë kur fëmija përballë me ndalesat e para, d.m.th., kur realiteti i kundërvihet dëshirave të tij. Frustrimet në kohën e fëmijërisë së hershme janë të pashmangshme, sepse gjithçka që di fëmija në vitet e para të jetës janë instinktet dhe dëshirat e tija për kënaqësitë e menjëhershme të të njëjtave. Duke mos pasur kushte që të gjitha instinktet të jenë të kënaqshëm, frustrimi është i pashmangshëm. Megjithatë, mënyra se si do të reagojë fëmija në këto ndalime dallohet nga fëmija në fëmijë, në vashmëri nga mënyra e ndërtimit të sjelljeve të tij, marrëdhëniet me rrethin, e mbi të gjitha, marrëdhëniet e prindërve ndaj tij.

Karakteri, pra, formohet nga konflikti ndërmjet nevojave të fëmijës - instinktit, dhe reagimit të mjedisit. Fëmija mëson

se si t'i kalojë nevojat dhe instinktet e veta të cilat nuk janë të pranuar, të cilat janë penguese, ndëshkuese..., dhe krijon mënyra të mirë përcaktuara, reagimi ndaj të cilat do të zvogëlojnë konfliktet dhe tensionet me mjedisin të cilat paraqiten te fëmija. Ajo që ndodh në këtë periudhë, për shkak të frikës së fortë nga ndëshkimi që fëmija i ndjen është zmbarsja e instinktit. Megjithatë, ashtu që të mbeten të zmbarsura instinktet, vetë egoja duhet të ndryshojë. Pikërisht ky ndryshim i parë i egos me qëllim të forcimit të tij në mënyrë që zmbarsja të jetë e përhershme, paraqet fillimin e formimit të karakterit. Pikërisht, në ego formësohet karakteri, aty ku është e nevojshme harmonizimi i kërkesave të ndryshme të botës së brendshme dhe të jashtme të individit. Në këtë moment vjen deri te blindimi i egos ashtu për të mbrojtur nga instinktet e shtypura të cilët kërcënojnë që të rishfaqen në hapësirë, por edhe nga ndëshkimi i cili kërcënon që instinktet të çlirohen. Shtypja e instinkteve, kënaqësia e të cilit është penguar nga ana e rrethit, krijon tipar të ri të karakterit e cila bëhet pjesë e egos dhe pas kësaj për këtë shtypje më nuk duhet të shpenzohet energji.

Ky përshkrim i krijimit të karakterit, gjithashtu, na jep një qasje në funksionin e tij të dyfishtë, përkitazi mbrojtjen e përmendur si nga rreziqet e jashtme ashtu edhe nga tensionet e brendshme.

Rreziku i jashtëm, respektivisht, ndalimi që i imponohet fëmijës, në fakt, është arsyeja fillestare e formimit të karakterit mbrojtës, por pas kësaj, kur vendoset tipari i karakterit, ajo edhe më tutje vazhdon të veprojë dhe atë gjithnjë e më shumë me qëllim të mbrojtjes nga tensioni i brendshëm. Me rritjen, gjithnjë e më pak ka rreziqe reale të jashtëm nga të cilat personi duhet të mbrohet.

Dihet mirë se kafshët nuk i frenojnë instinktet e tyre, por, gjithashtu, edhe që gjithmonë janë të ekspozuara ndaj rreziqeve reale nga mjedisi. Nga kjo mund të konkluzohet se sekretin e karakterit të shëndosh është në ekuilibrin midis kënaqësisë së instinkteve të brendshme dhe respektimit të kufizimeve të jashtme.

Sekreti i karakterit të shëndosh është në ekuilibrin midis kënaqësisë së instinkteve të brendshme dhe respektimit të kufizimeve të jashtme.

FORMIMI I KARAKTERIT PËRMES AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Karakterit, ndoshta, është gjëja më e rëndësishme që mund të zotërojmë në jetë, sepse ai na përcakton si person dhe individ. Forcimi i karakterit do të thotë të formosh veten në një person produktiv, në njeri që është i kënaqur me veten dhe që ka forcë dhe stabilitet psikik.

- Psikologët pohojnë se forca e karakterit në fakt përfaqëson zotërimin e cilësive që do të na ndihmojnë të mbajmë kontrollin mbi instinktet dhe nxitjet tona, të sundojmë veten tonë dhe t'i rezistojmë tundimeve të panumërta me të cilat çdo ditë përballemi. Dhe pikërisht është tërheqja nga instinktet vitale (ushqimi dhe kënaqësia seksuale) ai që në thelb e prish agjërimin, dhe në çka repretësishtë insistohet gjatë Ramazanit.

- Bashkëndjesia me njerëzit e tjerë, veçmas me më të dobët se vetja, dhe atyre që janë në vështirësi, ndjeshëm do të forcojë karakterin, pohojnë psikologët, e pikërisht agjërimi zhvillon këtë dhembshuri sepse vetë agjëruesi bëhet më i vetëdijshëm se është i dobët dhe që ka nevojë për ndihmën e dikujt tjetër.

Na këshillojnë që të ruhem nga nxitjet irracionale - pasionet, të cilat, edhe nëse ndonjëherë mund të jenë të dobishme, shpesh arrijnë të mposhtin intelektin tonë dhe të na shtynë të bëjmë gjëra të këqija: të hamë shumë ushqim, të ushtrojmë në mënyrë të paarsyeshme nevojat seksuale, që në mënyrë irracionale të kemi frikë nga diçka (të kemi fobi), të pushtohemi nga trishtimi ose zemërimi.

Thonë se përgjigja për këtë është që gjithmonë paraprakisht duhet menduar, të ushtrojmë shprehje të mira, në mënyrë që të lirohemi dhe të mos bëhemi skllevër të pasioneve tona. Do të shohim se ushtrimi i vetëkontrollit do të na forcojë

Ushtrimi i
vetëkontrollit
do të na
forcojë
karakterin,
dhe kjo
pikërisht është
ajo me çka ne
do ta kalojmë
provimin e
Ramazanit.

karakterin, dhe kjo pikërisht është ajo me çka ne do ta kalojmë provimin e Ramazanit.

- Propozojnë që të mësojmë të bëjmë mirë dhe të shmangim të keqen, të kërkojmë paqen tonë dhe të ngulmojmë në të. Thuhet që mos t'i arrijmë qëllimet tona duke i dëmtuar të tjerët, por që të drejtohem në qëllime fisnike dhe vërtet të vlefshme me të cilat do të zhvillojmë veten dhe shoqërinë në përgjithësi. Nëse në gjithçka kërkojmë dhe shohim vetëm interesin personal, do të vijmë në konflikte me të tjerët, e në fund, pashmangshëm do të biem. Ndërsa, nëse kërkojmë dhe arrijmë të mirën e ndërsjellët, të gjithë rreth nesh do të kenë lehtësira nga kjo, si dhe ne do t'i arrijmë qëllimet tona personale, por në mënyrë shumë më të shëndetshme dhe më të mirë. Të gjitha këto janë vlera për të cilat insiston Islami, dhe posaçërisht afirmohen në

Ramazan, derisa njeriu agjëron.

- Psikologët propozojnë që gjithmonë të jemi të qetë, sepse qetësia është një gjendje e cila na ndihmon ta shohim situatën gjithmonë në mënyrë të drejtë. Qetësia dhe meditimi çojnë kah idetë, e idetë kah mundësitë, dhe në fund mundësitë çojnë kah suksesi. Pa qetësi nuk ka karakter të fortë. E pikërisht ndjenja e qetësisë dhe rehatisë është ajo që siguron përjetojnë agjëruetit dhe e ndejnë gjatë agjërimin.

- Na thonë: "Kini durim!" – të punosh në vete nuk është aspak e lehtë. Nuk duhet dorëzuar pas dështimit të parë, duhet pasur durim dhe të jesh këmbëngulës. Durimi dhe këmbëngulja janë karakteristikat kryesore të një karakteri të fortë. E kjo është pikërisht ajo që çdo agjëruet synon, derisa kalojnë ditët e Ramazanit, ngase durueshëm dhe këmbëngulshëm përmbahet nga ushqimi, pija dhe kënaqësia seksuale, që të arrihet deri te qëllimi përfundimtar, shpërblimit i cili u është premtuar agjëruetve në fund të Ramazanit.

- Na këshillojnë të jemi të sinqertë në gjithçka që punojmë dhe në çdo aspekt të jetës sonë, sepse kur jemi të pandershëm, jemi të pandershëm se pari ndaj vetes tonë, e kjo është sulm ndaj karakterit tonë. Dhe sinqeriteti është diçka që pa dyshim forcohet në Ramazan, sepse ekzistojnë mënyra të panumërta që të fshihemi nga njerëzit, por vetëdija që jemi vazhdimisht nën mbikëqyrjen e Allahut na çon në sinqeritet ndaj qëllimeve tona të agjërimin.

E lusim Allahun e Lartësuar që t'i kemi arritur të gjitha këto virtyte, e që në mes të njerëzve të veprojmë njerëzishëm dhe me karakter!

Përktheu: Shaban Basha



Ramazani, thesar që nuk shteron

Mihana Goga – Bekteshi

Ramazani vjen si një mundësi e mirë për të gjithë myslimanët e botës mbarë, si një ripërtëritje shpirtërore, periudhë e gjetjes së vetvetes, e kërkimit të Zotit xh.sh., e rishikimit të atyre ekuilibrave të së mirës dhe së keqes në rrethin tonë, te vetja jonë. Ai vjen si përvojë për të forcuar raportet me Krijuesin, për ta përjetuar ëmbëlsinë e besimit, madje ne nuk falënderojmë mjaftueshëm për të gjitha mirësitë dhe begatitë e këtij muaji. Zoti xh.sh. në Kuranin fisnik thotë: *“Dhe (kujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: Nëse falënderoni, do t’ua shtoj të mirat.”* (Ibrahim, 7).


Pra, shtimi i të mirave e i begative na vjen si shkak i rritjes së falënderimeve dhe mirënjohjes ndaj të mirave që Zoti xh.sh. na i ka begatuar jetët tona. Deri tani kanë kaluar mjaft ditë të muajit të begatë Ramazan, andaj lum për atë besimtar që ishte i kujdesshëm ndaj adhurimeve dhe këtë vazhdon ta bëjë edhe në ditët e mbetura, lum për atë që është

Ky muaj
veçohet me
adhurim të
shtuar dhe
objektivi
madhor i këtij
muaji është
arritja e
devotshmërisë.

ngritur nga ana shpirtërore, lum ata që janë afruar te Zoti xh.sh. me namaz, sadaka e punë të mira.

Ky muaj veçohet me adhurim të shtuar dhe objektivi madhor i këtij muaji është arritja e devotshmërisë, sepse sikur ta dinim se çfarë të mira ka ky muaj, do të dëshironim që i gjithë viti të jetë Ramazan. Transmetohet nga Ebu Seleme, se Ebu Hurejra r.a. ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë për Ramazanin: “Kush falet me devotshmëri (në Ramazan) dhe besim (të vërtetë) që atë e ka obligim, duke llogaritur në shpërblimin e (Perëndisë), do t’i falen mëkatet e mëhershme të bëra (ndaj Allahut).”¹

Muhamedi a.s. ka qenë më bujari ndër njerëzit për të mirë, mirëpo në Ramazan ishte më bujar. Atë e takonte çdo natë në Ramazan Xhibrili a.s.. Pejgamberi a.s. i lexonte Kuran,



e kurdo që e takonte Xhibrilin a.s., ai ishte më i shkathët (për të bërë) mirë se era e dërguar e (freskët).²

Zoti xh.sh. e zgjodhi dhe e dalloi muajin Ramazan nga muajt e tjerë si muaj kur nisi zbritja e Kuranit. Megjithatë, edhe vetë brenda Ramazanit Zoti xh.sh. zgjodhi ca ditë, të



cilat janë më me vlerë sesa ditët e tjera. Fjala është pikërisht për dhjetë ditët e fundit. Vlera e tyre sigurisht se është më e madhe sesa vlera e njëzet ditëve të para, ngase pikërisht në këto ditë edhe ka filluar zbritja e Kuranit, siç thotë Zoti xh. sh.: *“(Ato ditë të numëruara janë) Muaji Ramazan që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)...”* (El Bekare, 185).

Në këto dhjetë net është edhe thesari shpirtëror, Nata e Kadrit, e cilësuar si më e mirë se njëmijë muaj, dhe e cila para së gjithash për ne është një rast jetik për t’u pastruar nga mëkatet, ngase Zoti xh.sh. thotë: *“Nata e Kadrit është më e rëndësishme se njëmijë muaj.”* (Kadër, 3).

“Kadr” do të thotë vlerë, rëndësi, përcaktim, andaj Nata e Kadrit është më e vlefshmja, më e rëndësishmja, ngase në të fillon shpallja e dritës për mbarë botën. Është më e dobishme se njëmijë muaj, në të cilët nuk ka ndonjë këso nate. Është më e rëndësishmja, ngase në të, në qiellin e dynjasë, në tokën rreth njerëzve zbresin melaqet. Zbresin për shkak se Zoti përcakton çdo çështje të vitit, e Ai nuk përcakton tjetër pos atë që është në të mirë për njerëzit. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Hulumtoni (kërkoni) natën e Kadrit në dhjetë netët tek të Ramazanit.”*³

Pejgamberi a.s. është dhënë pas lutjeve pak më tepër në pjesën e fundit të Ramazanit, ku netët i kalonte duke falur namaz, duke lexuar Kuran, duke menduar për Zotin xh.sh., si dhe duke kryer vepra të dobishme e të mira për njerëzit. Kur fillonin dhjetë ditët (e fundit të Ramazanit), Pejgamberi a.s. i shtrëngonte rrobat e tij (tërhiqej nga bashkëshortet) e gjallëronte çdo natë të tij (me devocion) si dhe i zgjonte të afërmit e tij (për të bërë ibadet).⁴

Muhamedi a.s. dëshironte që myslimanët në këto ditë, të flenë pak, e më tepër të kryejnë vepra të mira për veten dhe për bashkësinë e tyre. Pra, nga të gjithë ne, në këtë muaj, kërkohet që të shtojmë ibadetet, leximin e Kuranit fisnik, pastaj krahas namazeve të detyrueshme, të falim edhe nafile, të shtohet dhikri – përmendja e Zotit xh.sh., të bëhet dua, të ndahet lëmoshë, të pendohemi te Zoti xh.sh., ta falënderojmë Atë për të gjitha mirësitë që na i ka dhuruar, si dhe të lexojmë literatura të dobishme, në mënyrë që agjërimi ynë të ketë kuptim të plotë.

E lusim Allahun xh.sh. që lutjet dhe adhurimet tona të na i pranojë dhe mbi ne të derdhë mëshirën dhe rahmetin e Tij të pakufishëm! Paqja dhe harmonia qoftë mbi banorët e gjithë botës mbarë!

1 Koleksioni “Sahihul Buhari në gjuhën shqipe”, libri 5, përktheu: Ismail Ahmedi, Prishtinë, 1994, fq. 199.

2 Po aty, fq. 123.

3 Po aty, fq. 208.

4 Po aty, fq. 212.



Ramazani, muaj i fitoreve

Blerim Musliu

Sa herë që njeriu është larguar nga Smësimet dhe udhëzimet e shpalljes hyjnore ka pësuar deformime, të cilat, shpeshherë kanë tejkaluar edhe imagjinatën njerëzore. Këto deformime, që nga besimi, morali e deri te zhveshja e njeriut nga humanizmi, i kanë sjell njerëzimit pasoja të paparashikueshme. Zoti i gjithësisë, me urtësinë e Tij, është kujdesur që njeriu të jetë i udhëzuar me një udhëzim i cili i garanton njeriut jetë të dinjitetshme dhe shpëtim në të dyja botët. Për këtë, Ai ka dërguar peygamberë dhe ka zbritur libra te ta. Por, megjithatë, me kalimin e kohës, njerëzimi arriti në një pikë kritike, ku pothuajse nuk kishte mbetur asnjë shenjë e besimit të drejtë mbi sipërfaqen e tokës, e mos të flasim për moral apo për ndjenja humane.

Në këtë kohë krize, Allahu xh.sh. deshi të na tregojë se e vërteta do të triumfojë dhe se fitorja e vërtetë e vlerave ishte afër. Për këtë zgjodhi muajin Ramazan për ta shpallur mesazhin e fundit për njerëzimin, si një shenjë e parë e fitores dhe e dallimit përfundimtar ndërmjet të vërtetës dhe të kotës, e me këtë i hapi rrugën edhe fitoreve më të mëdha, e të cilat do të pasonin më pas, e do të vazhdojnë deri në ditët e fundit.


“Muaji Ramazan që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtria).” (El Bekare, 185).

E s’ka si të mos jetë fitorja më e madhe, kur edhe njëherë njerëzimit iu kthye shpresa e

humbur, kur edhe njëherë u ndal vrulli i fundosjes përfundimtare të besimit të pastër, kur edhe njëherë iu kthye shpresa të dobët, të varfrit, kur gruas, e cila nga nderi dhe dinjiteti i saj i kishte ngelur vetëm emri “grua”, tashmë po fitonte ndaj padrejtësisë që iu kishte bërë. A ka fitore më të madhe se sa të vendoset edhe njëherë lidhja e tokës me qiellin përmes rahmetit të Zotit, i Cili, me gjithë kryeneçësinë dhe rebelimin e njeriut, zgjodhi pikërisht Ramazanin për ta zbritur Librin që nuk ka dyshim në saktësinë e lajmeve për të kaluarën e për të ardhmen, për dispozitat e për vlerat të cilat i përmban. Vetë Zoti i Madhëruar për Kuranin ka thënë: *“Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej Allahut).”* (El Bekare, 2).

Duke e edukuar që ta mposht egon, e t’i marrë frerët e vetvetes në duar, e duke ngadhënjyer ndaj së keqes, kjo fe vazhdon t’i sjell fitore edhe sot besimtarit. Dëshmi e kësaj është edhe muaji Ramazan, i cili në mënyrë mahnitëse e edukon besimtarin me atë se fitorja arrihet vetëm duke qenë vetvetja, duke luftuar në radhë të parë me lakminë, urrejtjen, hasedin etj., e këto nuk arrihen nëse nuk e mposhtim nefsin tonë. Për t’i dëshmuar të gjitha këto, njeriu e ndalon veten e tij jo vetëm ndaj të ndaluarave, por e ndalon edhe ndaj atyre që janë të lejuara në esencë, dhe kështu, ai dëshmon se me ndihmën e Zotit, nëse ai e mposht lakminë dhe egon, ai është në gjendje ta mposht çdo armik.

A ka fitore më të madhe se sa të vendoset edhe njëherë lidhja e tokës me qiellin përmes rahmetit të Zotit, i Cili, me gjithë kryeneçësinë dhe rebelimin e njeriut, zgjodhi pikërisht Ramazanin për ta zbritur Librin që nuk ka dyshim në saktësinë e lajmeve për të kaluarën e për të ardhmen.



BETEJA E BEDRIT OSE “DITA E FURKANIT”

Duke qenë se feja e ka edukuar njeriun që puna e tij nuk përfundon vetëm me mposhtjen dhe kontrollin ndaj vetvetes, përkundrazi m'u këtu fillon beteja e gjatë e përhapjes së vlerave, mësimave e udhëzimeve për njerëzit, pikërisht në Ramazan, në vitin e dytë të hixhrit, saktësisht në ditën e 17 të këtij muaji, për besimtarët erdhi një provim i madh, ballafaqimi me armikun në betejën e Bedrit. Këtë betejë, Zoti me të drejtë e emërtoi si “Dita e Furkanit”. “... atë (Kuranin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhamedit) ditën e furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembëta), ditën e konfrontimit të dy grupeve...” (El Enfal, 41).

Në këtë betejë, numri i myslimanëve luftëtarë ishte vetëm 314. Ata kishin vetëm 70 deve, dy kalorës dhe një armatim shumë modest. Ndërkaq, numri i jobesimtarëve luftëtarë ishte tri herë më i madh sesa ai i myslimanëve. Ata kishin rreth një mijë luftëtar, 700 deve dhe hiq më pak se 100 kalorës.¹

Ky numër i pakrahasueshëm me këtë fuqi superiore, nuk mposhtet ndryshe vetëm se me ndihmën e Zotit Fuqiplotë. Kjo fitore e myslimanëve erdhi për të na treguar mësimin jetik se myslimanët do të fitojnë, dhe se ndihma e Zotit asnjëherë nuk do të mungojë, por kjo do të vjen vetëm atëherë kur besimtarët do t'i nënshtrohen pa rezervë Atij dhe kur të jenë të bindur se mësimet dhe rruga që ndjekin është e pa alternativë, pavarësisht numrit të kundërshtarëve.

Zoti në Kuranin fisnik na dëshmon për ndihmën që ju erdhi besimtarëve në betejën e Bedrit: “*Allahu ju ndihmoi juve në Bedër, kur ju ishit pak në numër, e për të qenë mirënjohës, keni frikë nga Zoti.*” (Ali Imran, 123).

Kjo ndihmë nuk ishte e zakonshme, marrë parasysh numrin e luftëtarëve, por, kur besimtarët i flakin dallimet e bëhen tok rreth qëllimeve të larta, ani pse nuk kanë përgatitjen e duhur, e aq më pak atë fizike siç është puna në Ramazan, por kanë imantin e plotë, ndihma e Allahut është prezentë, e ndoshta edhe e papritur jo vetëm nga armiku, por edhe nga besimtarët, ngase as ata nuk e kishin pritur një gjë të tillë. Për këtë, Zoti xh.sh. në Kuran na thotë: “*Zoti juaj ua vazhdon ndihmën me pesë mijë prej engjëjve të ushtruar (për luftë) ose të shënuar.*” (Ali Imran, 125).

Ditët kalojnë e sfidat asnjëherë nuk përfundojnë. Çdoherë ne ballafaqohemi me sfida të reja e me momente kritike, për të na e vërtetuar se betejat nuk përfundojnë asnjëherë deri në ditën kur ta takojmë Zotin e Madhëruar. “*Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja).*” (Hixhr, 99).

ÇLIRIMI I MEKËS

Pas shumë vitesh përpjekje, si në formimin e duhur, ashtu edhe në ngritjen e besimit, në ngritjen morale e në forcimin e lidhjeve ndërmjet vete, erdhi edhe një sfidë e radhës, erdhi momenti final i dëshmisë së vërtetësisë së kësaj feje. Erdhi koha për kthimin e myslimanëve në bazat e veta, në Meken e bekuar, për t'ia dhënë goditjen përfundimtare idhujtarisë dhe për ta pastruar Qabenë, e për ta kthyer atë në origjinalitetin e vet, që në të të adhurohet vetëm Një Zot. Një ngjarje kaq e rëndësishme e ngritjes së flamurit të fitores së thirrjes së Pejgamberit a.s., nuk mund të ndodh në një muaj tjetër, përveçse në Ramazan, ngase në këtë muaj filloi edhe zbritja e Kuranit, e nuk përmbillet ndryshe kjo ngjarje përveç se me çlirim dhe pastrim të Qabesë, me kthimin e Muhamedit a.s. dhe të shokëve të tij si triumfues. Edhe pse distanca ishte e largët e vështirësia ishte e madhe në udhëtim, Zoti zgjodhi ta bëjnë çlirimin e Mekës, ndonëse ata mund të ishin të dobët fizikisht, por dihet mirëfilli se për punë e fitore të mëdha historike duhet imani e ndihma e Zotit. Zoti xh.sh. na e përshkruan triumfin e jashtëzakonshëm të Pejgamberit a.s. dhe të shokëve të tij në suren Isra, në ajetin 81: “*Dhe thuaj: “Erdhi e vërteta e u zhduk e kota.” Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur.*” (Isra, 81).

Këto dy fitore janë shembulli praktik i vërtetësisë së Islamit dhe shembulli i asaj se Ramazani është muaji i fitoreve. Kjo gjë nuk ka ndryshuar, por do të vazhdojë edhe përgjatë historisë, edhe në të ardhmen, ngase rregulli i tillë mbetet ne fuqi, e nga ne kërkohet vetëm që ta zbatojmë atë.

¹ Imam Ahmedi në “Musned”, nr. hadith, 948, Shtëpia Botuese “Risale”.

Itikafi dhe dhjetë netët e fundit të Ramazanit

Nehat Shehu

Fjala itikaf në aspektin gjuhësor ka kuptim: izolim, veçim, qëndrim, apo ndenj në një vend të caktuar për një interval kohor. Kurse në aspektin terminologjik, shprehja itikaf është e definuar me definicione të ndryshme, njëra ndër to është: Qëndrimi në xhami për një kohë të caktuar duke qenë agjërueshëm dhe me nijet të adhurimit (itikafit).¹

Parimisht, norma e itikafit është sunet, mirëpo varësisht gjendjes dhe rrethanave, kjo normë mund të ndërrojë, andaj dijetarët kanë ndarë normën e itikafit në tri lloje, e ato janë si në vijim:

1) Itikafi vaxhib – obligativ. Ky lloj itikafi është rezultat i çdo fjale apo betimi të njeriut, i cili thotë se do ta kryejë, ose nëse vetë personi e bën obligim ndaj vetes. Kjo formë e itikafit kuptohet si në vijim: nëse personi thotë: “Në qoftë se Allahu më ndihmon në kryerjen e kësaj pune, ose nëse Allahu më shëron nga një sëmundje e caktuar, ose nëse e arrij këtë fitim përmes tregtisë sime, në shenjë falënderimi ndaj Zotit betohem që do hyjë në itikaf për kaq ditë.” Nëse personi e bën këtë betim, atëherë ai obligohet ta kryej në përpikëri, duke ruajtur çdo gjë që është betuar në ditët e caktuara dhe vendin - xhaminë e caktuar (nëse e ka specifikuar edhe atë).

2) Itikafi sunetun-muekede – sunet i fortë. Ky lloj i itikafit është më i njohuri dhe është pikërisht itikafi të cilin Pejgamberi a.s. vazhdimisht e ka praktikuar derisa ka vdekur. Lidhur me këtë formë, kemi hadithin e njohur të transmetuar nga Aisheja r.a., e cila ka thënë se: “Pejgamberi a.s. bënte itikaf vazhdimisht në dhjetëshin e fundit të Ramazanit derisa i erdhi vdekja.”²

3) Itikafi mustehab, i pëlqyer ose i preferuar. Ky lloj itikafi nuk ka ndonjë kohë të caktuar, prandaj bëhet edhe jashtë muajit Ramazan. Ky lloj itikafi është nga ato forma në të cilët nuk kushtëzohet që personi të jetë agjërueshëm, sepse parimisht është mustehab - i pëlqyer, prandaj nuk kushtëzohet kohëzgjatja apo të qenët agjërueshem, siç kushtëzohet te llojet e tjera.

URTËSIA E ITIKAFIT

Ne si mysliman jemi të bindur që çdo adhurim, urdhër apo ndalesë që vjen prej Zotit ka urtësinë e tij, së këndejmi, edhe te bërja e itikafit, dijetarët kanë përmendur disa urtësi, prej tyre:



1) Largimi i plotë nga punët dhe angazhimet e kësaj dynjaje dhe nga ato veprime që e ngurtësojnë zemrën e besimtarit duke u përqendruar vetëm në adhurimin ndaj Allahu xh.sh..

2) Pastrimi i zemrës nga gabimet apo sëmundjet e saj, duke kërkuar qetësinë përmes namazit, kërkim faljes, madhërimit të Zotit, e të ngjashme.

3) Dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit bujar, Allahut xh.sh., duke qëndruar në shtëpinë e Tij.

4) Meditimi në faljen, fuqinë e madhështinë e Zotit duke lexuar Kuranin e madhërishëm.

5) Pastrimin e gjuhës së tij nga përgojimi dhe fjalët e kota dhe zëvendësimi i tyre me fjalë të mira dhe përmendje ndaj Zotit.

6) Përkushtimi i tij me tërë qenien dhe fuqinë e tij ndaj Zotit të Madhërishëm.

7) Shtimi i adhurimeve gjatë kohës që është në itikaf.³

KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË ITIKAFIT

Sa u përket kushteve të vlefshmërisë së itikafit, ato ndahen në dy grupe: kushtet të cilat ndërlidhen me personin, dhe kushtet të cilat ndërlidhen me vendin ku bëhet itikafi.

Kushtet të cilat ndërlidhen me personin janë si në vijim:

1) Të jetë mysliman, sepse jobesimtarët nuk janë të ngarkuar me çështjet e adhurimit sipas mësimave të fesë islame.

2) Të jetë i shëndoshë psikikisht. Ky kusht vjen në shprehje për faktin se ata të cilët nuk kanë mendje të shëndoshë nuk llogariten në grupin e atyre që ngarkohen me obligime fetare, duke pasur parasysh që mendja është kusht esencial për të qenë i tillë.

3) Të qenët i pastër nga papastërtia e madhe, të mos jetë në ciklin mujor apo lehoni te femrat, ngase dihet që personit të papastër i ndalohet hyrja në xhami dhe kur ndalohet hyrja, atëherë ndalohet edhe qëndrimi në të.

Vlen të theksohet se arritja e moshës madhore apo pubertetit nuk është kusht për pranimin e këtij adhurim, dhe rrjedhimisht ai pranohet edhe nga fëmija i mençur, sepse ai bën pjesë në grupin e besimtarëve apo adhuruesve, dhe njëlloj siç pranohet agjërimi vullnetar i tij pranohet edhe itikafi.

Kurse sa i përket vendit që bëhet itikafi, kushtëzohet që vendi të jetë xhamia, (për gjininë mashkullore), në të cilën falen kohët e namazit. Argument për këtë është ajeti kuranor

Personi i cili është në itikaf duhet vazhdimisht të merret me ibadete e të flas vetëm fjalë të mira, duke shfrytëzuar kohën e tij në ato punë me të cilat është i kënaqur Zoti i Madhërishëm.

në suren Bekare, ku Allahu xh.sh. ka thënë: *“Dhe mos ju afroni atyre (bashkëshortëve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurimin në xhami.”*⁴ Lidhur me kushtëzimin e të bërit itikaf në xhami, kemi edhe hadithin e Pejgamberit a.s., i cili transmetohet nga Hudhejfe ibën Jemami r.a., i cili ka thënë: *“Në çdo xhami që ka imam dhe myezin, në të ka itikaf”*.⁵ Edhe Imam Ebu Hanife është i mendimit që itikafi nuk lejohet veçse në atë xhami që falen të gjitha kohët e namazit në të. Ndërsa farzi i itikafit është qëndrimi në xhami, duke pasur parasysh që fjala itikaf ka këtë kuptim.⁶

GJËRAT TË CILAT E PRISHIN ITIKAFIN

1) Kontaktet bashkëshortore (intime). *“Dhe mos ju afroni atyre (bashkëshortëve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurimin në xhami”*,⁷ gjithashtu ndalohen edhe gjërat që ndërlidhen me kontaktet bashkëshortore, siç janë përkëdhelja, puthja e të ngjashme.

2) Të dalit nga xhamia pa ndonjë arsye e prish itikafin, sepse qëllimi i tij është qëndrimi në xhami dhe dalja pa arsye është e kundërta e tij dhe rrjedhimisht e prish atë.

3) Paraqitja e ciklit apo lehonisë te gjinia femërore e prish itikafin, duke pasur parasysh që pastërtia nga to është nga kushtet e vlefshmërisë së tij.

4) Goditja e personit me sëmundje psikike, si çmenduria, gjithashtu e prish itikafin, sepse mendja apo vetëdija është prej kushteve të vlefshmërisë së tij, dhe me humbjen e saj, humb edhe qëllimi i itikafit.

5) Itikafin e prish edhe ngrënia apo pirja qëllimisht në atë lloj itikafi që kushtëzohet agjërimi.

NORMAT E PËRGJITHSHME LIDHUR ME ITIKAFIN

1) Lejohet dalja nga xhamia për ndonjë nevojë urgjente ose të domosdoshme; si në rast rreziku nga shembja e xhamisë si pasojë e ndonjë termeti, ose në rastin e nevojave fiziologjike, që personi të pastrohet nga ejakulimi në gjumë e raste të ngjashme.

2) Lejohet realizimi i kontratave të ndryshme gjatë kohës kur është në xhami, si shitblerjet, qiratë, fejesa, nikahu etj., mirëpo duke respektuar shenjtërinë e xhamisë.

3) Personi i cili është në itikaf duhet vazhdimisht të merret me ibadete e të flas vetëm fjalë të mira, duke shfrytëzuar kohën e tij në ato punë me të cilat është i kënaqur Zoti i Madhërishëm.

4) Për dallim nga meshkujt, të cilët itikafin e tyre e bëjnë në xhami (siç u sqarua më lart), femra myslimane itikafin e saj e bëjnë në faltoren e saj, gjegjësisht në dhomën e saj që e fal namazin në të. Urtësia e ndalimit të itikafit të saj në xhami, sipas dijetarëve islam qëndron në faktin që natyra e saj është në kundërshtim me fjetjen apo qëndrimin e saj në xhami, andaj ajo, itikafin e saj, e bëjnë në faltoren apo dhomën e saj ku falet.

5) Rregullat dhe normat e saj janë të njëjta me ato të meshkujve (si ato të daljes apo qëndrimin në vendin ku bëhet itikafi), pavarësisht se ajo itikafin e bëjnë në dhomën e saj.⁸

6) Fillimi i itikafit bëhet në ditët e njëzetë të Ramazanit para perëndimit të diellit, duke vazhduar deri në ditën e fundit të muajit (natën e Bajramit) pas perëndimit të diellit. Vlen të theksohet që është më e preferuar të qëndrohet pas faljes së namazit të Fitër Bajramit.

VLERA E 10 NETËVE TË FUNDIT TË RAMAZANIT

Ashtu siç e dalloj i Plotfuqishmi muajin Ramazan nga muajt e tjerë dhe siç i dalloj ditët e Dhul Hixhes nga ditët e tjera, ashtu i dalloj edhe dhjetë netët e fundit të muajit Ramazan nga të tjerat, duke i bërë ato një begati të pasiq në faljen dhe mëshirën e Tij dhe duke i liruar myslimanët nga dënimi i zjarrit.

Ndër begatitë dhe mirësitë e shumta të këtyre netëve të fundit mund të theksojmë Natën e Kadrit në të cilën ka zbritur Kurani, e cila u cilësua si më e mirë sesa një mijë muaj, si një natë e begatë e paqeje, si dhe përcaktuese apo ndarëse e çështjeve.

GJËRAT TË CILAT PREFEROHEN TË VEPROHEN GJATË KËTYRE NETËVE:

1) Itikafi.

2) Namazi i natës - është prej veprave që preferohet gjatë gjithë muajit Ramazan, e veçanërisht në dhjetëshin e fundit dhe është prej suneteve të forta, duke pasur parasysh insistimin e Pejgamberit a.s. në faljen e tij, sidomos në netët tek, duke shpresuar në gjetjen e natës së Kadrit, dhe e përforcon këtë edhe fakti që ai i inkurajonte dhe porosiste shokët dhe familjen e tij që të vepronin njësoj sikur ai.

3) Leximi i Kuranit - muaj i Kuranit, ashtu siç njihet për zbritjen e tij, njihet edhe për leximin e tij. Këtë e praktikonin të gjithë sahabët, tabiinët dhe gjeneratat që erdhën pas tyre, duke u dhënë plotësisht pas Kuranit dhe duke u larguar nga angazhimet e tjera.

4) Sadakatul fitri - kjo sadaka është obligim material për të gjithë myslimanët, moshërritur e fëmijë, dhe ka lidhje direkte me muajin Ramazan, e cila nxirret në ushqim ose në të mira materiale (të holla), këtë të fundit e lejojnë dijetarët e medhhebit hanefi, aq sa i nevojitet një personi mesatar për



ushqimin e tij ditor. Vlen të theksohet se sot punohet me këtë mendim për shkak të rrethanave dhe efektit më të madh të bamirësisë. Duhet përmendur që koha e dhënies së sadakatul fitrit lidhet ngushtë edhe me qëllimin e tij, e që është furnizimi me ushqim për ditën e Bajramit për të varfrit e shoqërisë, gjë kjo që qartësohet në hadithin e Pejgamberit a.s., që e transmeton Abdullah bin Abasi ku citon: “I Dërguari i Allahut na e bëri obligim sadakatul fitrin si pastrim për agjëruesin nga fjalët e kota dhe të pahijshme, por edhe si ushqim për të varfrit, kush e jep atë para namazit (të Fitër Bajramit) konsiderohet si sadakatul fitër i pranuar, e kush e jep pas namazit (të Fitër Bajramit), ajo është thjesht një sadaka e rëndomtë.”⁹

Pra hadithi na tregon që sadakatul fitri mund të jepet edhe para namazit të Fitër Bajramit, mirëpo kjo preferohet të jetë në dhjetëshin e fundit, kurse obligueshmëria e sadakatul fitrit llogaritet në momentin që hyn koha e namazit të sabahut në ditën e Fitër Bajramit dhe vazhdon deri në kohën e namazit të Fitër Bajramit. Nëse nuk kryhet gjatë këtij intervali, mbetet borxh i besimtarit që duhet dhënë, mirëpo vonesa të dijetarët hanefitë është e urryer.¹⁰

5) Lutja dua ja dhe kërkim falja – istigfari janë prej gjërave të cilat preferohen të bëhen më së shumti gjatë këtyre netëve, duke mos harruar që Pejgamberi a.s. porosiste të thuhet vazhdimisht dua ja “O Zot, Ti je falës, e do faljen, andaj më fal mua!”¹¹

1 Imam Burhanudin el Merginani, *El-Hidaje sherh bidajetul-mubtedi* (2/70).

2 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih El-Buhari* (2026).

3 Imam Hasen bin Amar el Shurunbulali, *Meraki El-Felah* (fq.573).

4 El Bekare 187, *Përkthimi i Hasan Nahit*.

5 Imam Daru Kutni, *Sunen Ed-Daru Kutni* 2332.

6 Imam El Kesani el Hanefi, *Bedaiu El-Sanai*(3/6,16).

7 Është përmendur më herët.

8 Shejh Abdullah bin Mahmud bin Mevlud el Muvasili el Hanefi, *El-Ihtijar Li-Talil El-Muhtar* (1/220,221).

9 Ebu Davud es Sixhiştani, *Sunen Ebu Davud* (1609).

10 Imam Hasen bin Amar el Shurunbulali, *Meraki El-Felah* (fq.582).

11 Ahmed bin Hanbel, *Musned Ahmed* (42/236, nr. 25384).

Nata e Kadrit, vlera dhe shfrytëzimi i saj

Dr. Selatin Mehani

HYRJE

Muaji i bekuar Ramazan, është padyshim muaji që Zotit e dalloi nga të tjerët, në të cilin bëri obligim agjërimin, si falënderim për dhuntinë e dhënë, siç potencon Kurani fisnik: *“Muaji Ramazan është ai në të cilin zbriti Kurani, (që është) udhërrëfyes për njerëzit, platformë i udhëzimit, dhe dallues (i së mirës nga e keqja), andaj kushdo që e dëshmon (me prezencë) kur ai të vjen, le ta agjërojë atë!...”, duke përmbyllur këtë ajet në këtë kontekst, duke thënë: “...dhe që ju t’i plotësoni ditët (e mbetura), ta madhëroni Allahun për udhëzimin që ju dha, dhe që të falënderoni.”* (El Bekare, 185).

Kështu, Ai, me urtësinë absolute, dhe nga bujaria e Tij, dalloi në mesin e netëve dhe ditëve të këtij muaji, Natën e Kadrit, duke e veçuar atë me veçori dhe vlera, të cilat nuk gjinden në netët e tjera të vitit. Për atë, i Dërguari i Zotit përgëzoi kur tha: *“Juve ju erdhi Ramazani, muaj i bekuar... në të është një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj, kush privohet nga mirësitë e saj vërtetë është i privuar”*.¹ Kështu, nëse Zoti caktoi agjërimin si adhurim të veçantë dhe specifikues në këtë muaj, ai veçoi Natën e Kadrit, si kohën më të mirë dhe të volitshme, për t’u ngritur lart në vlera, dhe për t’u pasuruar me mirësi dhe shpërblime.

KUPTIMI I FJALËS “NATA E KADRIT”

Nata e Kadrit (arab. ليلة القدر), është një emër, i lidhur me lidhje të ngushtë gjinore, i përbërë nga dy fjalë: natë, që nënkupton kohën prej perëndimit të diellit e deri në agim, dhe “Kader”, që nënkupton vlerën dhe rëndësinë, apo gjykimin dhe vendimin, nënkupton edhe ndarjen dhe dallimin.²

Nata e Kadrit është njëra nga netët e muajit të bekuar Ramazan, dhe në këtë nuk ka asnjë mëdyshje, ngase Zoti i Madhërishëm e filloi zbritjen e Kuranit në muajin Ramazan. Kurani e vërteton këtë kur thotë: *“Muaji Ramazan, është muaji në të cilin zbriti Kurani...”* (El Bekare, 185), dhe po ashtu thotë: *“Ne e zbritëm atë, në Natën e Kadrit”* (Kadr, 1), e që

nënkupton se Nata e Kadrit është një nga netët e bekuara të këtij muaji, në të cilën zbriti Kurani famëmadh. Dhe, duke qenë se vlera dhe madhështia e një gjëje, korrespondon me vlerën dhe madhësinë e asaj që përmban ajo, kjo natë mori këtë vlerë dhe madhësi, ngaqë në të zbriti fjala e Zotit të Madhërishëm, për këtë arsye Zoti e cilësoi si natë të bekuar kur tha: *“Ne e zbritëm atë, në një natë të bekuar...”* (Duhan, 3).

Pra, Nata e bekuar e Kadrit, është ajo natë në të cilën toka vuri kontakt me qiellin, ku zbriti drita hyjnore dhe ndriçoi tokën, duke shënuar kështu një nga ngjarjet me brilante dhe madhore të historisë së njerëzimit, me ç’rast u nda e vërteta nga gënjeshtra, dhe u dallua e sakta nga e kota.

ARSYEJA E EMËRTIMIT ME KËTË EMËR

Mendimtarët islam kanë shfaqur mendimet e tyre, duke përmendur arsye të ndryshme të emërtimit të kësaj nate me këtë emër. Ata kanë disa mendime, dhe më të dalluarat janë këto:

Mendimi i parë - është quajtur kështu, për shkak të vlerës që ka, ngase fjala “kader” nënkupton vlerën, siç përmend Kurani: *“...وما قدروا الله حق قدره...”* *“dhe ata nuk e vlerësuan Allahun siç Ai e meritoi...”* (En’am, 91), dhe kjo padyshim për shkak të vlerës së ngjarjes madhore të ngjarë në të, apo edhe vlerës së madhe që kanë veprat dhe adhurimet nëse ato veprohen në të, dhe kjo veçori nuk i është dhënë ndonjë nate tjetër.³ Kështu jep të kuptojë hadithi profetik ku thekson: *“...kush e ngjallë (në adhurim) Natën e Kadrit, me besim dhe shpresë në praninë, do t’i falen mëkatet e kaluara.”*⁴

Mendimi i dytë - për shkak të ngushtësisë që ajo natë gjen, me rastin e zbritjes së melaikëve, të cilat mbushin horizontin dhe tokën,⁵ siç përmendet në po këtë sure: *“Në të zbresin melaiket dhe Shpirti (Xhibrili), me lejen e Zotit të tyre, me (duke bartur) çdo çështje”* (Kadr, 4), dhe fjala “kader” nënkupton këtë, siç përmend ajeti *«ومن قدر عليه رزقه...»* *“dhe atij që i ngushtohet furnizimi...”* (Talak, 7).

Mendimi i tretë - për shkak se në të caktohen gjërat dhe sillen vendimet, që do të ndodhin gjatë një viti, deri në Natën tjetër të Kadrit, siç përmendet në ajetin: *“Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar, Ne (me këtë) ishim paralajmërues. Në të caktohet (ndahet) çdo çështje me urtësi”* (Duhan, 3-4). Muxhahidi kishte thënë: “Nata e Kadrit është nata e gjykimit (vendimit).” Ngjashëm kishte thënë edhe Imam Neveviu: “Është quajtur kështu, sepse është nata e gjykimit dhe vendimit.”⁶

KOHA E SAKTË E KËSAJ NATE

Nata e Kadrit është njëra nga netët e muajit të bekuar Ramazan, siç sqaruar, dhe këtu nuk ka asnjë dilemë, ndërsa janë të shumta mendimet dhe idetë që flasin se cila është ajo natë, kjo për shkak të shumëllojshmërisë së argumenteve në këtë temë.

Mendimi i parë - se ajo është në muajin Ramazan, e lëvizshme në tërë muajin, autorët e këtij mendimi madje thonë se ajo mund të jetë në tërë vitin, duke mos caktuar natë të veçantë, dhe ky mendim i atribuohet imamet Ebu Hanife, Allahu e mëshiroftë, Ibën Abasit, Ibën Mesudit, Ikrimë, etj..⁷ Ibën Umeri kishte thënë: E pyeta të Dërguarin e Zotit për Natën e Kadrit, se kur është ajo? Ai më tha: *“Ajo është në tërë Ramazanin.”*⁸ Dhe, ky është argument i qartë, nëse nuk do të ishte për qëllim çdo Ramazan, ngaqë hadithi «هي في كل رمضان» nënkupton të qenët e saj në tërë Ramazanin, apo në çdo Ramazan, sepse fjala كل (çdo/secili) nënkupton tërësinë në një kohë, por edhe një kohë të caktuar, në formë të përsëritur.

Mendimi i dytë - ajo është në dhjetëshin e mesëm të Ramazanit, dhe e paqartë për ne cila është ajo, kështu

“Për Zotin,
unë e di cila
është ajo, është
nata për të
cilën i
Dërguari na
urdhëroi që ta
ngjallnim me
ibadet, e ajo
është nata e
njëzet e
shtatë.”

(Ubejj ibën Ka’bi)

mendonte Imam Neveviu, Hasan el Basriu, dhe disa nga shafitë⁹.

Mendimi i tretë - është në dhjetëshin e fundit të Ramazanit, pa theksuar një natë të veçantë prej tyre. Kështu i kishte orientuar i Dërguari a.s. disa nga shokët e tij, të cilët e pyetën për këtë natë, duke ju thënë: *“Kërkojeni atë në dhjetëshin e fundit.”*¹⁰

Mendimi i katërt - është i përafërt me mendimin paraprak, i cili kufizon Natën e Kadrit në dhjetëshin e fundit të Ramazani, por duke precizuar më shumë, dhe duke e kufizuar atë në netët tek, konkretisht në natën e njëzet e një, tre, pesë, shtatë dhe nëntë. Kështu duke u bazuar në hadithin e lartpërmendur dhe në hadithin e Ubade ibën Samit r.a., i cili e kishte pyetur të Dërguarin për Natën e Kadrit, i Dërguari i kishte thënë se: *“Ajo është në Ramazan, andaj kërkojeni në dhjetëshin e fundit të netëve, ajo është në ato tek, në njëzet e një, ose njëzet e tre, ose njëzet e pesë, ose njëzet e shtatë, apo njëzet e nëntë apo në natën e fundit...”*¹¹.

Hadithi i lartshënuar është bazë në këtë mendim, ndërsa fjala e fundit e tij *“ose në natën e fundit”*, sado që disa janë bazuar në të për të ndërtuar kështu mendim të ri, ai nuk bie ndesh me të qenët e asaj nate në netët tek, ngase muaji është njëzet e nëntë ose tridhjetë ditë, siç është shpjeguar në hadithe të tjera, andaj atëherë kur muaji është 29 ditë, i bie që nata e fundit të jetë tek, dhe me gjasë të madhe që ajo të jetë Nata e Kadrit, ashtu siç mund të kuptohet si shpjegim i pjesës së fundit të këtij hadithi, në ndërkohë që Shuajb Arnauti, këtë pjesë e konsideronte të dobët dhe shtojcë të pasaktë.¹²

Mendimi i pestë - është i ngjashëm me atë paraprak, e që e përkufizon Natën e Kadrit në dhjetëshin e fundit të netëve



të Ramazanit, më konkretisht në netët tek të tij, por në mënyrë më decrive në natën e njëzet e shtatë. Argumentet për këtë janë më të shumta, duke qenë ky edhe mendimi i shumicës së dijetarëve, andaj edhe është përmendur në mënyrë decrive, në ndërkohë që, edhe argumentet e tjera e përfshijnë atë. Të këtij mendimi janë shumë nga sahabët, prej tyre: Ubejj ibën Ka'bi, i cili edhe ishte betuar se ajo është nata e njëzet e shtatë, duke thënë: "Për Zotin, unë e di cila është ajo, është nata për të cilën i Dërguari na urdhëroi që ta ngjallnim me ibadet, e ajo është nata e njëzet e shtatë." I këtij mendimi është edhe Enes ibën Maliku, dhe, ky është njëri transmetim i imam Ebu Hanifes, Imam Ahmedit, etj.. Ndërsa kur ishte pyetur Ubejj ibën Ka'bi për fjalën e Ibën Mesudit r.a: "Kush falet tërë kohën (në kërkim të Natës së Kadrit), do ta qëllojë atë", ishte përgjigjur duke thënë: "Zoti e mëshiroftë Ibën Mesudin, ai deshi që njerëzit mos të pasivizohen, sepse për Zotin ai e dinte që ajo është në Ramazan, madje në dhjetëshin e fundit të tij, dhe më konkretisht është nata e njëzet e shtatë..."¹³

Ngjashëm transmetohet nga Ibën Abasi r.a., i cili tregon se një njeri kishte ardhur tek i Dërguari i Allahut, duke u ankuar se ishte plakur dhe lodhur, andaj nuk mundte që të qëndronte

*"Kush e ngjallë
(në adhurim)
Natën e Kadrit,
me besim dhe
shpresë në
pranim, do t'i
falen mëkatet e
kaluara."*



gjatë, duke kërkuar t'i tregonte për një natë, me shpresë që Zoti do t'ia mundësonte ta qëllonte Natën e Kadrit, andaj i Dërguari atij i tha: "Përpiku në të shtatën"¹⁴, që është për qellim nata e shtatë e dhjetëshit të fundit.

Këto janë mendimet më kryesore rreth ndodhjes së Natës së Kadrit në muajin Ramazan, ndonëse ka edhe mendime të tjera, por thuajse të gjitha shpjen në atë se Nata e Kadrit është në muajin Ramazan, në mes të pjesës së parë të muajit, të mesmes dhe asaj të fundit, pastaj në net të caktuara të këtyre tri pjesëve. Ndërsa, arsyeja e ekzistimit të argumenteve të shumta dhe të ndryshme, gjegjësisht arsyeja e mosdefinimit të kohës së saktë të saj, është ajo që qëndron në hadithin e të Dërguarit të Zotit, i cili përcillet të ketë thënë: "Mua më është shfaqur Nata e Kadrit, por më ka dalë nga mendja, ndërsa ju kërkojeni atë në dhjetëshin e fundit, respektivisht në netët tek..."¹⁵. Kurse, arsyeja

pse dija rreth saj është ngritur nga i Dërguari i Zoti duke e harruar atë, është ajo që transmeton Ubade ibën Samiti r.a., i cili thotë: "Doli (nga dhoma e tij) i Dërguari i Zoti për të na lajmëruar për Natën e Kadrit, dhe gjeti dy nga myslimanët tek grindeshin, me ç'rast ai tha: "Dola për t'ju lajmëruar për Natën e Kadrit, dhe gjeta filanin dhe filanin tek grindeshin, pastaj (dija rreth saj) u ngrit nga unë, e shpresoj të jetë më mirë për ju..."¹⁶

Nuk ka dyshim se harresa e shkaktuar nga grindja, është një mësim i madh dhe mesazh i qartë, se grindjet në mes të myslimanëve nuk janë në dobi të tyre, ato shkaktojnë ngecje, privim nga dija, dhe jo qartësi në vizion. Megjithatë, në rastin në fjalë duket se ka qenë urtësi e Krijuesit të Madhërishëm, dhe kjo kuptohet nga fjala e të Dërguarit ku thotë: "...dhe unë shpresoj të jetë më mirë për ju." Kështu e kuptoi këtë Imam Bejhekiu, andaj edhe tha: "I Dërguari i Zotit, në fillim e dinte kohën e saj, përveçse nuk i ishte lejuar ta kumtonte atë, në mënyrë që njerëzit mos të pasivizoheshin dhe ta ngjallnin atë natë përveç të tjerave, më pas i Dërguari i Zotit e harroi atë, në mënyrë që të mos pyetej për diçka nga feja dhe ai të mos përgjigjet për të..."¹⁷

SI (TË) SHFRYTËZOHET KJO NATË?

Vlera dhe rëndësia e natës së Kadrit është e jashtëzakonshme dhe me peshë të madhe. Madhështia e saj qëndron në veprat që kryhen brenda asaj nate. Këtë e vërteton i Dërguari i Zotit kur thotë: "Kush e ngjallë (në adhurim) Natën e Kadrit, me besim dhe shpresë në pranim, do t'i falen mëkatet e kaluara..."¹⁸

Zbritja e një sureje dhe emërtimi i saj me emër të kësaj nate, dëshmon më së miri për pozitën dhe vlerën që ka kjo natë te

Zoti i Madhërishëm, andaj nuk do fjalë që vlerësimin më të mirë kjo natë e mori nga Zoti i gjithësisë, kur Ai tha: “*Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.*” (Kadr, 3). Muxhahidi thoshte: “Vepra në të, agjërimi i ditës që pason këtë natë dhe ngjallja e saj, janë më me vlerë se të gjitha këto në një mijë muaj, dhe kjo padyshim se është madhështi dhe vlerë e madhe.”

Vlerën kësaj nate, ia shton edhe më, zbritja e melaikëve në krye me Xhibrilin, të cilat vijnë me shpërndarjen e vendimeve dhe përcaktimeve, sjellin furnizimet dhe caktojnë afatizimet. I Lartësuar thotë: “*Në të zbresin melaiket edhe Shpirti (Xhibrili), me lejen e Zotit të tyre, me (duke bartur) çdo çështje.*” (Kadr, 4). Zbritja e melaikëve, shoqërimi i tyre ata që ngjallin këtë natë, mbushja e tokës me mysafirë të ndritur dhe të dalluar të qiellit, ndër ta edhe meleku Xhibril, i cili solli Kuranin në këtë natë të bekuar, nuk ka dyshim se ia rrisin vlerën dhe madhësinë kësaj nate. Ndërsa, Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Zotit kishte thënë: “*Nata e Kadrit është e njëzet e shtata apo njëzet e nënta, dhe se melaiket në atë natë do të jenë në tokë, më shumë sesa numri i guralecëve.*”¹⁹ (Ibën Huzejme, 2196).

Këto melaiket, përveç pranisë së tyre, me vete sjellin paqen, qetësinë dhe sigurinë, rehatinë, lumturinë dhe stabilitetin, dhe kjo natë mbaron, ashtu siç edhe vetë surja, me: “*Selam (paqe) është ajo, deri në agim të mëngjesit.*” (Kadr, 5).

Nata e vlefshme, është e bekuar, kështu e cilësoi Zoti në Kuranin fisnik: “*Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar.*” (Duhan, 3), andaj si e tillë, ajo është dhuratë e madhe që i është dhënë njerëzimit në përgjithësi, dhe veçanërisht besimtdrejtëve, andaj nuk duhet neglizhuar dhe as anashkaluar, ngase ai që privohet nga të mirat e saj, vërtet është i privuar.

Duke parë vlerën e madhe që ka kjo natë, dhe që mos të privohet nga përfitimet e mëdha të saj, Aisheja r.a., e kishte pyetur të Dërguarin e Zotit, se çfarë të thoshte gjatë kësaj nate. II Dërguari e orientoi që të shpeshkonte së luturi me këtë lutje: “*O Zot, Ti vërtet je Falës (dhe Sigurues), dhe e do faljen (e sigurinë), andaj të lutem, më fal mua!*”²⁰ (Ahmedi, 25384). Fjala “el afv” (falje, siguri) e përmendur në këtë hadith, është nga kuptimet më madhore dhe shprehjet më përmbledhëse në të cilat orientonte i Dërguari i Zotit kur i mësonte besimtarët se si të luteshin, duke qenë se kjo fjalë nënkupton faljen dhe sigurinë në këtë, por edhe Botën Tjetër, e që është asemi më i vlefshëm në jetën e kësaj bote, por edhe fitimi më i madh i botës së amshuar.

“O Zot, Ti
vërtet je Falës
(dhe Sigurues),
dhe e do faljen
(e sigurinë),
andaj të lutem,
më fal mua!”

Nga ajo që kam përmendur mund të konkludojmë se:

1- Nata e Kadrit është njëra ndër netët e muajit Ramazan, dhe është nata në të cilën zbriti Kurani fisnik, si e tillë ajo është nata më e vlefshme e vitit.

2- Mendimet rreth ndodhjes së saj në muajin Ramazan janë të shumta dhe të llojllojshme, dhe sipas mendimit më të saktë, ajo është në netët tek të dhjetëshit të fundit të Ramazanit, e argumentet se ajo është në natën e njëzet e shtatë janë më të zëshmet, megjithatë, kërkohet që besimtari të jetë përherë aktiv, e më aktiv në dhjetëshin e fundit, e posaçërisht në natën e njëzet e shtatë.

3- Atë natë, banorët e qiellit nga melaiket e ndritura, dhe ata të tokës nga besimtarët e përkushtuar, bëhen bashkë si një xhemat, të unifikuar rreth madhërimit dhe lavdërimit të Zotit të gjithësisë, andaj ajo natë është paqe

dhe rehati, deri në agim të diellit.

4- Besimtari, pasi të kuptojë vlerën dhe peshën e kësaj nate, me përkushtim dhe aktivitet si asnjëherë më parë, angazhohet duke kërkuar mirësitë dhe shijuar frytet e saj, ngase ai e kupton që, neglizhimi i asaj nate dhe humbja e mirësive të saj, është humbje e madhe dhe privim real nga çdo e mirë.

1 Ahmed ibën Hanbel, *Musned Ahmed*, (i recensuar nën mbikëqyrjen e Shuajb Arnautit, muesseset er risale, 2001), nr.7148, 12/59.

2 Muhamed ibën Mukerrem, *Lisan el Arab*, (Kairo, Dar el Mearif), lënda فَزْر, fq. 3545-3547.

3 Mahmud Shukri el Alusi, *Ruh el Meani fi Tefsir el Kuran el Adhim ve es Seb' el Methani*, (Bejrut, Dar ihja et turath el arabi), 30/192.

4 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Damask-Bejrut, Dar ibën Kethir, 2002), nr. 2014, fq.484.

5 Ahmed ibën Ali ibën Haxher el Askalani, *Fet'h el Bari bi sherh Sahih el Buhari*, (recensoi Shuajb Arnauti dhe Adil Murshid, muesseset er Risale, 2013), 6/554.

6 Ahmed ibën Ali ibën Haxher el Askalani, *Fet'h el Bari* 6/554.

7 Ibën Haxher el Askalani, *Fet'h el Bari*, 6/569.

8 Sylejman ibën el Esh'ath es Sexhištani, *Sunen ebi Davud*, (recensoi Shuajb Arnautit, dar er risale el alemije, 2009), nr.1387, 2/535.

9 Ibën Haxher el Askalani, *Fet'h el Bari*, 6/571.

10 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Damask-Bejrut, Dar ibën Kethir, 2002), nr. 2021, fq. 485.

11 Ahmed ibën Hanbel, *Musned Ahmed*, nr.22741, 37/406.

12 Po aty, gjykimi i hoxhës mbi pjesën e fundit, në fusnotën me nr.2.

13 Muslim ibn el Haxhaxh, *Sahih Muslim*, (dar Tajjibe, 2006), nr.220 (762), fq.524.

14 Ahmed ibn Hanbel, *Musned Ahmed*, nr.2149, 4/49-50.

15 Muhamed ibn Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, nr. 2016, fq.484.

16 Muhamed ibn Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, nr. 2023, fq.486.

17 Ahmed ibn el Husejn el Bejheki, *Fedail el evkat*, (Bejrut, dar el kutub el ilmije, 1997), fq.62.

18 Buhari në Sahih, nr. 2014.

19 Muhamed ibn Is'hak, *Sahih iben Huzejme*, (el mekteb el islamij), nr. 2196, fq.1048-1049.

20 Ahmed ibn Hanbel, *Musned Ahmed*, (nr.25384, 42/236, dhe të tjerë.

Dhënia e sadakatul fitrit në para – kundërvlerë monetare

(TRAJTIM JURIDIK SIPAS SHKOLLËS HANEFITE)

Jusuf Zimeri

LIGJËSIMI I SADAKATUL FITRIT DHE DISPOZITA E SAJ

Nocionin “sadakatul fitri”¹ në literaturën përkatëse të jurisprudencës islame, shpeshherë e gjejmë edhe me nocionin “zekatul fitri” me të njëjtin kuptim. Sadakatul fitri, siç e përshkruan Imam Kasani në veprën e tij “*Bedaiu es-sana'i*” është sadaka e obliguar për kokë të njeriut.²

Dispozita e sadakatul fitrit sipas juristëve të medhhebit hanefi, është *vaxhib* për çdo besimtar islam, mashkull apo femër qoftë, i vogël apo i madh, i mençur apo i sëmure mendor. Nga sadakatul fitri nuk lirohen as edhe ata që nuk e agjërojnë Ramazanin, apo nuk e falin namazin përderisa thirren se janë myslimanë.

Sadakatul fitri është bërë *vaxhib* në vitin e dytë sipas hixhretit, respektivisht në të njëjtin vit kur është bërë farz edhe agjërimi i muajit Ramazan dhe të zekatit.³ Në veprën “*Telhisul habir*” nga Ibni Haxher el Askalanit thuhet: “Agjërimi i muajit Ramazan është bërë farz një muaj pas ndërrimit të kibles (nga *mesxhidi aksaja* në *mesxhidid*

haram), i cili është bërë tetëmbëdhjetë muaj pas hixhretit. Në këtë vit është urdhëruar edhe dhënia e sadakatul fitrit, e kjo ishte ende pa u bërë farz zekati për pasurinë.”⁴

Argumentet për ligjësimin dhe obligimin e dhënies së sadakatul fitrit janë të shumta, e ne do të përmendim disa prej tyre. Hadithi i cili transmetohet nga Abdullah ibën Tha'lebe ibën Sair el Udhriju, i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut a.s. na mbajti një ligjëratë në të cilën përveç tjerash tha: “Për çdo të lirë dhe rob, të vogël e të madh, jepni sadaka nga gjysmë sa'i nga gruri, ose nga një saë nga hurmat, apo nga një saë prej elbit.”

Në hadithin tjetër të transmetuar nga Abdulla ibën Omeri r.a., ka thënë: “I Dërguari i Allahut a.s. e përcaktoi sadakatul fitrin për çdo mashkull dhe femër, të lirë dhe rob nga një saë me hurma ose nga një saë me elb.” (Muslimi). Juristët e shkollës hanefite, nocionin “*fereda-farz*” që përmendet në hadith, e interpretuan në kuptimin gjuhësor të saj, që do të thotë “përcaktim” e jo në kuptimin terminologjik të sheriatit islam. Në bazë të kësaj, nga hadithi nënkuptohet se “*Pejgamberi a.s. ka përcaktuar sadakatul fitrin...*” e nuk e ka



bërë farz. Prandaj juristët tanë janë të vendosur se dispozita e sadakatul fitrit është vaxhib, e jo farz.

Marrë parasysh faktin se sadakatul fitri në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhet me Ramazanin dhe agjërimin, përveç vlerave humane dhe sociale që ka, ai bënë edhe rigjenerimin dhe pastrimin agjëruetit dhe të agjërimin nga mangësitë eventuale dhe veprimet e shëmtuara, dhe e pastron agjëruetin ashtu si e pastron uji papastërtinë e trupit. Këtë dimension të sadakatul fitrit, më së miri na e bënë të qartë hadithi që e transmeton Ibni Abasi r.a. i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. përcaktoi sadakatul fitrin pastrues për agjëruetin nga fjalët e këqija dhe ushqim për të varfrit, andaj kush e paguan atë para namazit (të *Fitër Bajramit*), ajo është sadaka e pranuar, e kush e nxjerr pas namazit (të *Bajramit*), atëherë ajo është sadaka sikur edhe sadakatë e tjera”⁶.

SASIA E PËRCAKTUAR E SAKEDATUL FITRIT

Sipas juristëve të medhhebit hanefi, sasia e përcaktuar e sadakatul fitrit është gjysmë sa i me grurë ose një saë me elb, hurma apo rrush të thatë.⁷ Në shpjegimin e veprës “*Multekal ebhur*” nga shejh Vehbi Sulejman Gavoxhi thuhet: “Sadakatul fitri është obligim një saë me drithë.” Transmetohet nga Ebu Seid el Huderiju r.a., i cili ka thënë: “Në kohën e të Dërguarit të Allahut a.s., sadakatul fitrin e jepnim një saë me ushqim, ose një saë me hurma ose një saë me elb, ose një saë me rrush të thatë...” (Buhariu 1/204).⁸ Ajo që bie në sy dhe që ka specifikën e vet, është fakti se këto artikuj, në kohën e Pejgamberit a.s. kanë qenë të barabartë në vlerë, që nënkupton se gjysmë sa i grurë ishte i barabartë me një saë hurma ose rrush të thatë, kurse sot, ky dallim është shumë i madh. Pra, sasia e përcaktuar tek artikujt ushqimor është vlera e tyre. Nga tërë kjo që u tha, konstatohet se juristët e medhhebit hanefi thonë se sadakatul fitri jepet prej katër gjërave që janë: gruri, elbi, hurma dhe rrushi i thatë.⁹

PAGESA E SAKADATUL FITRIT NË KUNDËRVLERË (MONEDHA)

Është fakt i pa kontestuar se në esencë, përcaktimi i dhënies së sadakatut fitrit dhe vlera e saj është përcaktuar në artikuj ushqimorë që i përmendëm më parë dhe ky përcaktim është bërë pikërisht për ruajtjen e interesit të të varfrit, por a lejohet dhënia e sadakatul fitrit edhe në kundërvlerë të këtyre artikujve, pra në monedha të ndryshme?

Juristët e medhhebit hanefi janë të mendimit se, lejohet dhënia e sadakatul fitrit në vlerën e artikujve me para ose kartëmonedha. Ky është edhe mendimi i Imam Buhariut, si dhe i shumë dijetarëve eminent bashkëkohorë.

Fillimisht të theksojë se, në këtë çështje juristët islam janë të ndarë në dy mendime kryesore. Sipas mendimit të parë, nuk lejohet largimin nga tekstet që nënkupton se sadakatul fitri detyrimisht duhet të paguhet nga artikujt e lartpërmendur dhe si rezultat i kësaj nuk lejohet pagesa me kundërvlerën e tyre ose me monedha.

Mendimi i dytë është se pagimin e sadakatul fitrit në kundërvlerë, nuk është largim nga tekstet autentike, porse pikërisht mbështetje në tekstet e tilla, andaj ndërtuan mendimin se sadakatul fitri mund të paguhet me artikujt bazë të përmendur në tekste, por lejohet të paguhet edhe kundërvlera e tyre, pra në monedha të llojeve të ndryshme ku jetojnë njerëzit, e përparësi do t'i jepej asaj që kanë nevojë më shumë marrësit e sadakatul fitrit dhe që është më e lehtë për dhënësin e sadakatul fitrit.

Mirëpo, meqenëse, që të dy këto qëndrime janë të përfaqësuar nga dijetarët e Ehli Sunetit dhe që të dy mendimet kanë bazë autentike, për të mos i lodhur lexuesit me argumente dhe kundër argumente, sepse ky debat është i nivelit akademik të fushës islame, si dhe

marrë parasysh faktin se popullata jonë shqiptare islame në tërësi i takon medhhebit hanefi, në vazhdim këtë çështje do ta trajtojmë vetëm nga metodologjia e argumentimit të këtij medhhebi.

Juristët e medhhebit hanefi janë të mendimit se, lejohet dhënia e sadakatul fitrit në vlerën e artikujve me para ose kartëmonedha. Ky është edhe qëndrimi i Imam Ataut, Hasan Basrijut, Omer ibën Abdulazizit, Imam Thevrijut, Imam Ebu Hanifes, Ebu Jusufit, Imam Tahavijut etj., kështu kanë vepruar dhe kështu jepet fetvaja edhe për zekatin, edhe për sadakatul fitrin.¹⁰ Ky është edhe mendimi i Imam Buhariut, si dhe i shumë dijetarëve eminent bashkëkohorë.

Imam Mevsiliju në librin e tij, “*El ihtijaru li talilil muhtar*” thotë: “Sadakatul fitri është gjysmë sa i me grurë ose mielli i tij, ose një sa me elb ose mielli i tij, ose një sa hurma apo një sa me rrush i thatë, ose kundërvlera e tyre.” Në realitet, gruri dhe elbi përmenden në tekst (hadith), kurse mielli i tyre nuk përmendet, por jepet sepse ka të njëjtin trajtim me bazën e tyre, madje ndoshta edhe më e nevojshme. Imami nuk ndalon vetëm këtu, por thotë: “ose kundërvlera e tyre”. Imam Ebu Jusufi thotë: “Për mua, mielli është më i preferuar të jepet se sa drithi, derhemët për mua janë më me prioritet se sa mielli, sepse kjo është më e lehtë për të pasurin dhe më e dobishme për të varfrin”. Nuk lejohet të jepet bukë dhe

bylmet për sadakatul fitër, por duhet llogaritur kundërvlera e tyre, për shkak se nuk ekziston tekst për të.¹¹

Imam Serahsiju në veprën e tij *“El Mebsutu”* thotë: “Nëse për sadakatul fitr, jepet kundërvlera e grurit, lejohet sipas mendimit të fukahave hanefi, sepse ajo që është në konsideratë është intenca e arritjes së pasurimit ditën e Bajramit, e kjo arrihet edhe me pagesën e kundërvlerës, ashtu si arrihet me dhënien e grurit.”¹² Fekihu i njohur, Tahaviju ka thënë: “Dhënia e sadakatul fitrit në vlerë është më e mirë, sepse është më afër dobisë së të varfrit, ngase me to mund të blejë gjërat që i nevojiten atij, kurse përcaktimi tekstual për grurin dhe elbin ishte sepse në atëkohë në Medine shitblerja bëhej me to, kurse në vendet tona shitblerja realizohet me monedha dhe monedhat janë pasuria më e dashur, andaj edhe pagesa me të oshtë më vlefshme.”¹³ Imam El Kasani në veprën e tij, *“Bedaiu es-sanai”* thotë: “Sipas fukahave tonë, (hanefi) artikujt që përmenden në tekst motivohen për shkak se konsiderohen pasuri me vlerë komerciale, prandaj i përmendi ato për lehtësim, sepse me to bëhej tregti dhe shitblerje në kohën e Pejgamberit a.s.”¹⁴ Në veprën *“El fikhul islami ve ediletuhu”* nga dr. Vehbe Zuhejli thuhet: “Sipas fukahave të medhhebit hanefi, lejohet pagesa e sadakatul fitrit në vlerën e artikujve të përmendur pavarësisht me cilën monedhë paguhet, sepse sipas juristëve hanefitë, vaxhib është pasurimi i të varfrit në bazë të hadithit të Pejgamberit a.s., e ky pasurim për ditën e Bajramit edhe më mirë dhe më lehtë realizohet me pagesën e vlerës.”¹⁵

Këtë mendim e gjejmë në mbarë literaturën e medhhebit hanefi, me ca ndryshime të vogla, por ne përmendëm vetëm disa burime më kryesore.

ARGUMENTET KU MBËSHTETET KY MENDIM

Nga argumentet ku mbështetet mendimi i fukahave të medhhebit hanefi dhe i disa fukahave të tjerë, edhe nga shkollat e tjera, për lejimin e dhënies së sadakatul fitrit në kundërvlerë, janë të shumtë, e ne do të përmendim vetëm disa prej tyre:

- Allahu xh.sh. në Kuranin famëlartë thotë: *“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën do t'i pastrojë ata dhe me të cilën do t'u rrisësh veprat e mira.”* (Et Tevbe, 103). Nocioni “emval” që është shumësi i nocionit “malun”, pasuritë, që përmendet në ajet, nënkupton të gjitha llojet e pasurisë që njeriu i ka në pronë e tij, qoftë flori, argjend, apo pasuri tjetër, kurse atë që e ka përcaktuar Pejgamberi a.s. në mënyrë tekstuale është sqarim për lehtësim dhe pezullim të vështirësive, e nuk nënkupton përkufizimi të obligimit.¹⁶

- Hadithi Pejgamberit a.s. i regjistruar tek Imam Buhariu, i cili thotë: Transmetohet nga Tavusi, i cili ka thënë: “Muadhi r.a. (kur ishte dërguar në Jemen si mësues dhe gjykatës i Jemenit, popullit të Jemenit) u kishte thënë: “Më jepni sadakanë në rroba dhe veshmbathje në vend të elbit dhe drithit, sepse kjo është më lehtë për ju dhe më e dobishme për shokët e Pejgamberit a.s. në Medine.” Hadithi na e bënë të qartë se Muadhi r.a. në vend të zekatit dhe sadakatul fitrit,



kishte mbledhë artikujt të tjerë të barasvlershëm në vlerë me zekatin dhe sadakanë, duke mbajtur llogari në lehtësimin e atij që jep sadaka dhe në interesin e atij që e pranon sadakanë. Muadhi r.a. këto sadaka dhe këtë zekat të grumbulluar në këtë formë, e dërgonte te Pejgamberi a.s. në Medine dhe ai ua shpërndante të varfërve, por nuk e kontestoi këtë veprim të Muadhit që konsiderohet se ka dhënë pëlqimin.¹⁷ Prandaj, imam Ajniu në shpjegimin e këtij hadithi thotë: “Fukahatë e medhhebit tonë (hanefi) me këtë hadith argumentojnë lejimin e dhënies së zekatit dhe sadakatul fitrit në vlerë.”¹⁸ Për këtë çështje, Imam Ajniu thotë se Ibni Reshidi ka thënë: “Edhe pse Imam Buhariu kundërshtohet në shumë çështje me fukahatë hanefi, në këtë mesele pajtohet me ta,”¹⁹ që argumenton se ky është edhe mendimi i Imam Buhariut.

- Hadithi i regjistruar te Sahihu i Imam Buhariut, ku Ebu Bekri r.a. kur e kishte nxjerrë Enesin r.a. dhe të tjerët në teren për të grumbulluar zekatin, e të cilëve u kishte dhënë një shkresë të vulosur me vulën e Pejgamberit a.s., në mesin e tjerave thuhet:... “Nëse dikush ka deve sa të japë zekat një deve që ka mbushur katër vite (xhedh'atun) por nuk ka prej tyre, atëherë, duhet të japë një deve që i ka mbushur tri vite (el hikatu), atëherë pranohet prej tyre deveja tre vjeçare dhe bashkë me të jep edhe dy dele nëse i vjen më lehtë, ose njëzet derhem. Nëse dikush ka për obligim të japë sadaka një deve që ka mbushur tri vite (el hikatu), por nuk ka prej tyre, atëherë jep zekat një deve që ka mbushur katër vite (el xhedh'atu) kurse sadaka mbledhësi i rikthen dy dele ose njëzet derhem.” (Buhariu).

- Hadithi i transmetuar nga Ibni Omeri r.a., i cili ka thënë: “I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Mos i leni ta dalin të varfrit për të lypsur bile në këtë ditë.”²⁰ Nga hadithi kuptohet se Pejgamberi a.s. ka urdhëruar që përmes sadakatul fitrit t'u mundësohet të varfërve të sigurojnë ushqimin dhe nevojat e tjera në këtë ditë festive të Bajramit, në mënyrë që ata të mos

kërkojnë këtë ditë, e kjo arrihet edhe me nxjerrjen e sadakatul fitrit nga vetë lloji i artikullit të përmendur, por edhe nga dhënia e vlerës së tyre, madje kjo e dyta është më e përshtatur, sepse nevojat e të varfërve janë të ndryshme, nuk janë vetëm ushqimi, andaj është më me prioritet. Ndoshta motivi i përcaktimit të artikujve të përmendur në tekst për dhënien e sadakatul fitrit, është sepse në kohën e përcaktimit, nevoja më e madhe ishte ushqimi dhe se me këto artikuj ushqimor bëhej edhe tregtia mes veti, e monedhat ishin shumë më të rralla dhe nuk gjendeshin kudo.

- Nga dijetarët bashkëkohorë që e ka shkoqitur në detaje çështjen e zekatit dhe të sadakatul fitrit, është edhe prof. dr. Jusuf Kardavi, i cili në veprën e tij të njohur "*Fik'hu et-zekat*" thotë: "Ajo që më rezulton mua është se, i Dërguari i Allahut a.s. sadakatul fitrin e obligoi me artikuj ushqimor për dy shkaqe që janë:

-për shkak se monedhat në atë kohë ishin të pakta dhe të rralla tek arabët, e dhënia e sadakatul fitrit në ushqime për ta ishte më e lehtë, dhe

-vlëra e monedhave ndryshon fuqinë e saj ekonomike nga koha në kohë, për dallim nga sa i me ushqim, që në çdo kohë mbulon nevojën njerëzore për ushqim. Pastaj dhënia e sadakatul fitrit në ushqime atëherë ishte më e lehtë edhe për dhënësin e sadakasë."²¹

Në bazë të këtyre argumenteve që u paraqitën deri më tani dhe shumë argumenteve të tjera, kuptohet qartë se zekati dhe sadakatul fitri janë ligjësuar për të përmbushur nevojat e të varfërve, e nevojat e të varfërve janë të llojllojshme,²² prandaj duhet parë cila është nevoja më parësore e të varfërve, e veçanërisht në kohën e industrializimit bashkëkohor, kur shumica e njerëzve tani nuk i gjejnë ose i gjejnë por me vështirësi artikujt e përmendur në tekstet autentike, kurse kundërvlerën e tyre, pra monedhat i kanë për çdo ditë në duart e tyre.

PËRMBYLLJE

Kohëve të fundit, duke u bazuar në nevojën e kohës, në dinamikën e jetës në shoqërinë njerëzore në përgjithësi, por edhe në shoqërinë islame në veçanti, qendrat shkencore, kërkimore e studimore në botën islame, gjithnjë e më shumë po unifikojnë qëndrimet e tyre dhe fetvatë për dhënien e zekatit dhe sadakatul fitrit në para – kartëmonedha, pra në vlerën e artikujve të përmendur në hadithet e Pejgamberit a.s.. Kjo na tregon se sa vigjilentë dhe sa thellë e kishin kuptuar fukahatë fushën e jurisprudencës islame kur lejuan një veprim të tillë. Në pamundësi që të sjellë të gjitha fetvat dhe vendimet e qendrave shkencore islame që janë bartës dhe përgjegjës për dinamikën e zhvillimit të jetës islame në botë, në veçanti, si rezyme po sjell vetëm unifikimin e mendimeve të disa qendrave përgjegjëse islame që lejojnë pagimin e vlerës së zekatit dhe sadakatul fitrit në vendet e tyre.

Qendrat botërore shkencore që kanë përcaktuar kundërvlerën e sadakatul fitrit në monedha për vendet e tyre janë: Akademia e Fetvasë në Egjipt, Akademia e Universitetit

të Az'harit në Kajro, Akademia e Fikhut Islam në Sudan, Këshilli për Fetva, Hulumtime dhe Studime Islame në Jordan, pastaj këshillat për fetva në Libi, Siri, Turqi, Allxhir, Tunis, etj.. Në të gjitha këto vende islamike, përmes qendrave studimore shkencore islame apo varësisht nga komisionet që posedojnë, bënë përcaktimin e vlerës së sadakatul fitrit me valutën vendore ku jetojnë ata. Një përcaktim të këtillë e ka bërë edhe Arabia Saudite.

Si përfundim i tërë kësaj është se, po të mos kishte bazë juridike islame për ligjësimin e pagimit të sadakatul fitrit në kundërvlerën e artikujve të lartpërmendur, sigurisht se këto qendra islame nuk do të lejonin as përcaktimin e vlerës së sadakatul fitrit. Mendoj se në këto qendra shkencore janë bërë studime dhe analiza të thella shkencore duke marrë parasysh edhe rrethanat sociale, shoqërore dhe ekonomike të kohës që po jetojmë, kurse zërat individual që po qarkullojnë edhe në vendin tonë, duke kundërshtuar të gjitha këto mendime si të pabaza, i konsiderojmë me tendencë jo të mira e as të pastra për islamin dhe për myslimanët, e veçanërisht kur dihet roli dhe rëndësia e zekatit dhe sadakatul fitrit në zhvillimin e islamit institucional në trevat tona.

- 1 Nocioni sadakatul fitr nënkupton: sadakaja të cilën e paguan besimtarët islam gjatë muajit Ramazan deri në faljen e namazit të Bajramit, për ta pastruar agjërimin e tyre nga mangësitë eventuale. J. Zimeri, Fjalor terminologjik i Fikhut Islam Arabisht – Shqip, f. 281, Botim Rijaseti i BFI-së Shkup, 2021.
- 2 El Kasani, Alaudin Ebu Bekr ibën Mes'ud, *bedaisu es-sanai fi tertibi esherai*, 2/69, Darul kutub el ilimije Bejrut- Liban.
- 3 Grup autorësh, "*Pesë shtyllat e fesë islame*", f. 454, bot. i tretë- Shkup.
- 4 El Halebij, Ibrahim ibën Muhamed ibën Ibrahim, Multekal Ebhuru, përkthim në gjuhën shqipe nga J. Zimeri 1/421. Bot. Rijaseti i BFI-së Shkup, 2020.
- 5 Nje sa'ë, si njësi matëse e kohës profetike sot është e barabartë me 3 kg e 260 gr. Sipas juristëve hanefitë.
- 6 Ebu Davudi, 1609, Ibni Maxhe 1827.
- 7 Abdulgani el Gunejmi el Midani, *El-lubab sherhul kitab*, f. 152-153.
- 8 El Halebij, Ibrahim ibën Muhamed ibën Ibrahim, Multekal Ebhuru, përkthim në gjuhën shqipe nga J. Zimeri 1/423. Bot. Rijaseti i BFI-së Shkup, 2020.
- 9 Dr. Zuhejli Vehbe, *El fikhul islami ve ediletuhu*, 2/909. Darul fikr , Damask.
- 10 Ahmed ibën Muhamed ibën Sadik el Gumarij el Hasenij, *Tahkikul amal fi ihraxhi zekazil fitri bil mal*, f.45.
- 11 Mevsiliju, Abdullah ibën Mahmud, *El ihtijar i ta'lilil muhtar*.
- 12 Es Serahsij Muhamed ibën Ahmed ibn Ebi Sehl Shemsul eimet, el mebsutu 3/108, babu sadakatul fitri).
- 13 Po aty.
- 14 El Kasani, Alaudin Ebu Bekr ibën Mes'ud, *Bedaiu es-sanai fi tertibi esherai* 2/541).
- 15 Dr. Zuhejli Vekhebe, *El fikhul islami ve ediletuhu*, 2/909-910, Daraul fikr, Damask 1989.
- 16 Ahmed ibën Muhamed ibën Sadik el Gumarij el Hsenij, *Tahkikul amal fi ihraxhi zekazil fitri bil mal*, f.59.
- 17 Po aty, f. 52.
- 18 El Ajniji, Alame Bedrudin Ebi Muhamed Mahmud ibën Ahmed, *Umdetu el karij sherh Sahihul buhari*, 9/6, Darul kutub el ilimije, Bejrut- Damask, bot. parë, 2001.
- 19 Po aty, 9/6.
- 20 Hadithin e ka bërë tahirix Darekutni në librin e zekatit (2/152) nr. Hadithit (67), Bejhekiju në "*Sunenul kubra*" në librin e zekatit, kapitulli koha e dhënies së sadakatul fitrit (4/175) nr. (7528), me transmetim nga Ibni Omeri r.a.
- 21 Dr. Kardavi Jusuf, "*Fikhu ez-zekat*" 2/949, botimi i dytë 1985, Muesesetu er-risale, Bejrut –Liban.
- 22 Dr. Ahmed Ebu Dahir, nadhratun fi hukmi ihraxh kimetu zekatil emvali fil fikhil islami, Mexhl-le xhamiatu Dimesh lil ulumi iktisadije vel kanunije, muxheled 22, nr. 2006.

Roli i zekatit dhe sadakatul fitrit në mbarëvajtjen e jetës fetare të myslimanëve në trojet shqiptare

Vahidin Beluli

Sadakatul fitri është obligim material që besimtari ngarkohet në përmbushjen e tij gjatë muajit Ramazan, konkretisht deri para faljes së namazit të Bajramit

gjatë muajit të agjërimit, edhe pse nuk është e detyrueshme koha e zekatit në Ramazan. Meqë aspekti financiar është celulë e zhvillimit, nuk mendoj që ndonjë sistem, qoftë shoqëror apo edhe fetar, e ka integruar më mirë se feja islame. Integrimi i zekatit në shtyllat e fesë islame është argument i pa kontestueshëm se sa i rëndësishëm është individi dhe mirëqenia e tij.¹ Mos përmbushja e kësaj shtylle paraqet besimtarin e paqëndrueshëm dhe të pa sigurt, sepse nuk mund të ketë qetësi dhe siguri në një objekt që nuk plotëson shtyllat e parapara për ekzistencën e tij. Varfëria është një segment që paraqet vështirësi në jetën e njeriut, e që realisht mund të krijojë pasiguri, depresion e mund të çojë edhe deri te veprat e shëmtuara dhe kriminale, gjë të cilën e përshkruan edhe i Dërguari i Allahut kur thotë: “Varfëria është gati

Ardhja e muajit të bekuar Ramazan, bartë me vete vlera shumëdimensionale, duke përmbushur kështu nevojat shpirtërore të besimtarëve përmes plotësimit të një shtylle të Islamit, që sfidon dhe parandalon çdo gjë negative, si dhe ngrit dhe motivon besimtarët për avantazhe shpirtërore, morale dhe sociale. Edhe pse urdhri për dhënien e zekatit vjen i pandarë me urdhrin për faljen e namazit, e që është motivim dhe stimulim i besimtarit, Ramazani është koha kur besimtari plotësohet shpirtërisht dhe energjinë e akumuluar me urdhrin e dhënies së zekatit të ripërsëritur në Kuranin famëlartë e shkarkon pikërisht

pabesim”. Për këtë arsye, feja islame e lufton varfërinë përmes tre instrumenteve të rëndësishme dhe domethënëse: Zekatit obligativ njëherë në vit, sadakatul fitrit po ashtu obligativ në muajin Ramazan dhe sadakasë vullnetare në çdo kohë dhe sipas mundësive.

Për shkak të peshës që ka ky faktor financiar, parimisht është e paraparë sipas kornizave të fesë islame, që institucioni kompetent të merret profesionalisht me marketingun, udhëzimet, organizimet, ruajtjen dhe shpërndarjen e mjeteve të tubuara. Këtë e argumenton ajeti kuranor, i cili i drejtohet Muhamedit a.s. në formë urdhërore: “*Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’ua shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. Allahu dëgjon e sheh.*” (Teube, 103). Edhe caktimi i punëtorëve institucional të zekatit në kategorinë e pranuesve të zekatit argumenton për peshën e kësaj çështje që nuk guxon të kryhet shkel e shko, por me njerëz kompetent me ekzistencë financiare të garantuar. “*Allahu caktoi obligim që lëmoshat (zekati etj.) t’ju takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që tubojnë)...*” (Teube, 60). Përdorimi i fjalës sadaka në Kuran në tri ajete (Teube 58, 60, dhe 103), si dhe në disa hadithe edhe nëse nganjëherë përkthehet si lëmoshë, ai është sinonim i fjalës zekat.² Po ashtu, zotimi të cilin e bëri Ebu Bekri r.a., se do t’i luftojë të gjithë ata që bëjnë dallim në mes namazit dhe zekatit, nëse edhe një litar (kafshësh) do ta ndalojnë,³ si dhe miratimi i këtij qëndrimi nga sahabët argumenton për përgjegjësinë institucionale të zekatit.

Nga aspekti tjetër, edhe besimtari i ngarkuar me këtë obligim, detyrohet të ndjek udhëzimet e organit kompetent, ngase kryerja e këtij obligimi është ibadet i drejtpërdrejtë dhe plotësim i shtyllave të Islamit.

SADAKATUL FITRI

Sadakatul fitri është obligim material që besimtari ngarkohet në përmbushjen e tij gjatë muajit Ramazan,

konkretisht deri para faljes së namazit të Bajramit, bazuar në transmetimin e Ibni Abasit, i cili thotë: “I Dërguari i Allahut ka obliguar sadakatul fitrin, si pastrim për agjëruesin nga përgojimet dhe lëshimet, si dhe furnizim për nevojtarët. Kush e kryen atë para faljes së namazit (të Bajramit) llogaritet sadakatul fitr i pranuar, e kush e kryen pas namazit, atëherë ajo është sadaka e rëndomtë.”⁴ Kujdestari i familjes obligohet për pagesën e sadakatul fitrit për vete dhe gjithë anëtarët e familjes për të cilët ai kujdeset financiarisht, qoftë edhe për fëmijën që lind para faljes së namazit të Bajramit, bazuar në transmetimin e Ibni Omerit ku thuhet: “I Dërguari i Allahut ka obliguar sadakatul fitrin për çdo të lirë, të robëruar, qoftë mashkull apo femër nga myslimanët”, apo edhe sipas transmetimit të Ebu Hurejres: “... çdo të lirë apo të robëruar, mashkull apo femër, i madh apo i vogël, i varfër apo i pasur.”⁵ Disa nga dijetarët preferojnë dhënien e sadakatul fitrit edhe për fëmijën në barkun e nënës.⁶

Urtësia e obligueshmërisë së sadakatul fitrit, bazuar në thënien e Pejgamberit a.s., të transmetuar nga Ibni Omeri ka dy dimensione, atë individual, pra të agjëruesit, ngase llogaritet si pastrim i agjërimit të tij nga ndonjë përgojim apo lëshim i mundshëm, dhe atë shoqëror, me të cilin janë në konsideratë nevojtarët që së paku ata, në ditën e festës ta kenë të garantuar sofrën e Bajramit. Kjo e fundit përforcohet më tepër nga thënia e Pejgamberit a.s. ku thuhet: “Furnizoni ata (nevojtarët) që të paktën në këtë ditë të mos bredhin (duke lypur)”⁷, si dhe nevojat e tjera shoqërore që janë në interes specifik apo edhe të përgjithshëm, bazuar në ajetin e 60-të sures Teube, që përcakton grupet me të drejtë pranimi të fondeve të obligimeve financiare fetare.

Gjithashtu urtësi e kësaj çështje llogaritet edhe sasia e vogël (minimale), gjë që ua lehtëson njerëzve ta ndajnë atë me mjetet e tyre që posedojnë, e që shumica e ymetit mund të participojnë në këtë ofertë fisnike dhe në këtë rast të bekuar.⁸

Sasia e shumës që duhet dhënë si sadakatul fitr llogaritet në vlerën e dy shujtave ditore në kuzhina publike, duke u bazuar në sasinë e masës së gjërave ushqimore që janë transmetuar nga Pejgamberi a.s.. Transmetohet nga Ibni Omeri r.a. të ketë thënë: “I Dërguari i Allahut ka obliguar sadakatul fitrin në Ramazan një sa’a⁹ nga hurmat apo një sa’a nga elbi...”¹⁰ Pra, shumica e sadakatul fitrit me valuta bashkëkohore është e ndryshme në çdo shtet dhe llogaritet me çmimet e vendit. Në vende ku gjendja ekonomike e besimtarëve është e ndryshme, atëherë edhe sasia e pagesës së këtij obligimi material është e ndryshme dhe llogaritet në bazë të standardit të të ushqyerit të familjes. Çmimi për sadakatul fitrin do të caktohet nga organi kompetent për çështje fetare, kurse standardi i të

Çmimi për sadakatul fitrin do të caktohet nga organi kompetent për çështje fetare, kurse standardi i të ushqyerit duhet të caktohet nga vetë paguesit e sadakatul fitrit.

ushqyerit duhet të caktohet nga vetë paguesit e sadakatul fitrit.

FORMA E TUBIMIT DHE DESTINIMIT TË ZEKATIT DHE SADAKATUL FITRIT

Edhe pse forma e tubimit dhe destinimit të zekatit dhe sadakatul fitrit parimisht duhet të jenë të institucionalizuar, çuditërisht në pjesën më të madhe të myslimanëve, kjo gjë është lënë nën mëshirën e vetë besimtarëve, dhe ata me kapacitetin e vetëdijes së tyre fetare vendosin dhe përzgjedhin kategoritë ku i derdhin ibadetet e tyre materiale. Se sa ato janë të qëlluara, Allahu e dinë më së miri. Por nuk duhet të harrojmë se sipas primeve islame, po të jetë i informuar zekatspaguesi se vendi ku e ka dhënë zekatin apo sadakatul fitrin është i gabuar, obligohet të paguajë atë edhe njëherë. Meqë kategoritë e pranimit të zekatit dhe sadakatul fitrit, bazuar në ajetin e 60 të sures Teube, janë më shumë se një, më konkretisht ato janë tetë, automatikisht lënë të kuptohet se këtu duhet të shikohen prioritetet, dhe për të caktuar prioritetet duhet patur organ kompetent religjioz. Meqë jetojmë në një sistem demokratik dhe aspekti fetar është i organizuar brenda secilit shtet në formë të pavarur nga shtetet e tjera, dhe se secili shtet

ka bartësit e përgjegjësive fetare, pra ai institucion njeh më së miri rrethanat e shtetit të vet, nevojat e popullit të vet, dhe parashikon edhe të ardhmen e popullatës në përgjithësi dhe



myslimanëve në veçanti. Prandaj, parimisht këtij institucioni i takon edhe trajtimi i çështjeve fetare e konkretisht edhe menaxhimi i tubimit dhe destinimit të mjeteve materiale fetare, siç është zekati dhe sadakatul fitrit. E kjo gjë është më se e nevojshme në vendet ku nuk ka varfëri të skajshme dhe ku njerëzit nuk janë të rrezikuar me kafshatën e gojës. Bazuar në këtë, mendoj se Bashkësia Islame e ish-Jugosllavisë ka qenë largpamëse dhe duke u mbështetur në parimet fetare dhe gjendjen e popullatës ka rikthyer institucionalizimin e tubimit dhe destinimit të ibadeteve materiale fetare dhe ka përzgjedhur kategoritë prioritare, konkretisht “*ve fi sebili lah*” për ngritjen e fjalës së Allahut. Dhe ky institucionalizim ka sjell frytet e veta në atë kohë dhe ka trashëguar këtë traditë deri në ditët e sodit në të gjitha rajonet e ish-Jugosllavisë ku jetojnë myslimanët, e konkretisht edhe në trojet shqiptare.

ROLI I IBADETEVE MATERIALE NË NGRITJEN E FJALËS SË ALLAHUT NË TROJET SHQIPTARE

Forma e tubimit dhe destinimit të zekatit dhe sadaktul fitrit në trojet shqiptare, jo që ka qenë vetëm vepër bamirësie, por është shndërruar në vepër riprodhuese. Pra, jo vetëm material harxhues, por është rikthyer në riprodhim shpirtërore-edukativ. Kështu që ky realitet nuk duhet neglizhuar, por duhet thellësisht të analizohet dhe të nxirren modele që do t'i shërbejnë avancimit të jetës fetare edhe në kohën moderne, por edhe në të ardhmen. Themelimi i Medresesë së Ulët në Prishtinë më 1952, zhvillimi i saj dhe marrja e statusit të Medresesë së Mesme në vitet e -60ta, hapja e Medresesë Isa Beu në vitet e 80-ta në Shkup, hapja e Medresesë në Novi Pazar në vitin 1990, hapja e paraleleve në Prizren dhe Gjilan, hapja e Fakultetit të Studimeve Islame në vitin 1992 në Prishtinë dhe hapja e paraleleve të vajzave në vitin 1997, rangimi i Medresesë në shkollë të Mesme e Lartë publike pas viteve 2000, hapja e Fakultetit të Shkencave Islame në RMV, me gjithë paralelet e Medresesë anëmbanë Maqedonisë, Malit të Zi e Preshevës, nuk janë gjëra që kanë pikë nga qielli, por janë riprodhim i zekatit, sadakatul fitrit dhe sadakave vullnetare të njerëzve të devotshëm, që tashmë nuk jetojnë, por jam shumë i bindur se çdo lutje që bëhet në këto vatra të diturisë, në xhami pas namazeve, në mevlude e tribuna, ata do të përfitojnë nga ajo që kanë kontribuar derisa kanë qenë gjallë.

Për ta argumentuar efektivitetin e zekatit dhe sadakatul fitrit institucional, po e rikujtoj gjendjen kur unë isha në Medrese, në vitet 1993-1989. Të gjithë nxënësit e Medresesë shpërndaheshin në të gjitha hapësirat shqiptare dhe nuk mbuloheshin nevojat për imam, kurse tash të gjitha fshatrat kanë më shumë se një imam, të gjitha xhamitë janë me imam, e gjithë diaspora është e mbuluar me imam.

Apelojmë që ibadetet materiale-fetare të derdhën në fondin shpirtëror-edukativ për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare në trojet tona.

Efekt tjetër që nuk duhet lënë anash është forma e interpretimit autoktonë të fesë islame dhe ruajtja e traditave fetare, ngase institucionet tona fetare janë financuar nga vetë qytetarët dhe nuk kanë pas nevojë të domosdoshme të financohen dhe ndikohen nga jashtë. Për ta kuptuar këtë, më së afërmi mund të bëjmë një krahasim me shtetin amë, pra Shqipërinë, ku fatkeqësisht për shkak të rrethanave politike komuniste është çrrënjësuar kjo traditë institucionale dhe për këtë arsye edhe sot Medresetë e Shqipërisë nuk e kanë fatin të funksionojnë të pavarura dhe të financuara nga mjetet e veta, por menaxhohen nga shoqata të ndryshme, gjë për të cilën mund të themi se kemi edhe laramani interpretuese dhe ideologjike.

Është për keqardhje se si shumë njerëz e nganjëherë besa edhe imamë e teologë nuk e shohin rezultatin e ibadeteve materiale fetare në fushën e ngritjes së fjalës së Allahut të Lartësuar dhe bëjnë përpjekje për de kanalizimin e zekatit dhe sadakatul fitrit në materiale harxhuese në vend të atij riprodhues. Mendoj se kjo është përgjegjësi e madhe dhe se është e rëndë për ta arsyetuar para Allahut të Gjithëfuqishëm.

Edhe pse në trojet tona varfëria është e theksuar, megjithatë nuk është e skajshme dhe anëmbanë trojeve shqiptare ekzistojnë zyrat sociale që janë përgjegjëse për nevojtarët, po ashtu shoqatat humanitare, aksionet e Ramazanit, të cilat përbushin sadopak nevojat e nevojtarëve, prandaj, apelojmë që ibadetet materiale-fetare të derdhën në fondin shpirtëror-edukativ për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare në trojet tona.

Apel të veçantë u dërgojmë bizneseve që obligohen me zekat, ashtu sikurse që mundohen që kapitalin e tyre ta vënë në shërbim profiti të vazhdueshëm, që të kujdesën edhe për obligimet fetare materiale, t'i destinonjë aty ku janë me profit riprodhues, me qëllim të mbarëvajtjes së punës së tyre dhe përfitimit të vlerave shpirtërore në këtë botë dhe në botën tjetër. Këtë po e potencoj nga njohurit teorike lidhur me këtë temë, si dhe nga përvojat praktike, ngase e shoh se sa dëm u bëhet institucioneve kompetente me de kanalizimin e derdhjes së ibadeteve materiale fetare, në interesa të ngushta e nganjëherë edhe banale.

1 Më gjerësisht për rolin e zekatit tek individit dhe shoqëria shih. Vahidin Beluli, Takvimi 2004, fq.133.

2 Shih Vahidin Beluli, Zekati në të mbjella dhe fruta fq.10-12.

3 Transmeton Buhariu nr. 7284 si dhe Muslimi nr. 20.

4 Ebu Davudi hadithi nr. 1609 dhe Ibën Maxheh hadithi nr. 1827.

5 Transmetojnë Buhariu, Muslimi, Nesaiu dhe Ahmedi, hadithi nr. 186.

6 Shih dr. Jusuf Kardavi, Fikhu Zekat, vol. 2 fq. 928.

7 Dare Kutni, vol. 4 hadithi nr.628, Bejhekiu, vol. 4 fq. 175.

8 Shih dr. Jusuf Kardavi, Fikhu Zekat, vol. 2 fq. 923.

9 Sa'a është njësi matëse për drithëra që përputhet me 2.176 kg.

10 Rewahul Xhemaatu

Bajrami, festë për myslimanët

Nexhmi Hoxha

Në rrugëtimin jetësor të njeriut në këtë botë, festat, pa dyshim se zënë një vend të rëndësishëm. Do të ishte e pakuptimtë jeta sikur të jetohej çdo ditë e saj e mos kishte ditë feste, gëzimi e hareje. Nëse i hedhim një shikim historikut të njerëzimit, vërejmë se festat ishin dhe janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit të kulturës dhe besimit të secilit prej tyre.

Festimi i festave në ditë të caktuara luante dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e besimit të një komuniteti, si dhe në ruajtjen e identitetit kombëtar, racor apo edhe gjuhësor të popujve. Për këtë, popujt dhe besimet e ndryshme kanë edhe festat e tyre, të cilat kanë në thelb të tyre përkujtimin e ndonjë ngjarje të madhe që e karakterizon atë popull apo atë besim, qofshin këto ngjarje me karakter fetar, kombëtar, racor, gjuhësor, etj..

Kjo gjë manifestohet edhe në fenë islame, ku ne si myslimanë kemi dy festa: festën e Fitër Bajramit dhe festën e Kurban Bajramit. Të dyja këto festa vijnë për të shënuar ngjarje të rëndësishme në jetën e besimtarit mysliman. Të dyja këto ndërlidhen me kryerjen e dy prej kushteve themelore të Islamit, agjërimin dhe haxhit.

Festa e Fitër Bajramit ndërlidhet me përfundimin e agjërimin, që është një ngjarje shumë e rëndësishme për jetën e besimtarit. Agjërimi që është një ritual madhor, në të cilin edukohen shpirti dhe qenia e myslimanit. Me agjërim edukohet shpirti në përkushtim të plotë në adhurim ndaj Krijuesit, edukohet qenia e besimtarit duke forcuar vullnetin dhe durimin e tij, që duke lënë anash ushqimin, pijen dhe kënaqësitë e tij, për hir të Zotit, mundohet ta arrijë kënaqësinë e Tij. Derisa

Festimi i festave në ditë të caktuara luante dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e besimit të një komuniteti, si dhe në ruajtjen e identitetit kombëtar, racor apo edhe gjuhësor të popujve.



festa e dytë është Kurban Bajrami, që ndërlihet ngushtë me kryerjen e haxhit.

Fitër Bajrami është festa e besimtarëve myslimanë, të cilët festojnë përfundimin e muajit të bekuar Ramazan, ashtu siç i ka urdhëruar Zoti i Madhërishtëm. Besimtarët festojnë këtë ditë duke e falënderuar Allahun xh.sh., që u ka dhënë mundësi dhe forcë për të përballuar vështirësitë e agjërimit.

Festojnë e gëzojnë për suksesin e arritur gjatë muajit Ramazan, gëzohen në shpirt që me vullnet, dëshirë e durim arritën që t'i përgjigjen Zotit të tyre në thirrjen e Tij për agjërim. Se agjëruesi ka gëzim për agjërimin e tij, na kishte mësuar edhe Pejgamberi a.s. kur thoshte: "Agjëruesi ka dy gëzime, gëzohet kur ta çelë iftarin e tij dhe gëzohet kur ta takoj Zotin e tij."¹

Festa e Fitër Bajramit është dita që mbulon me gëzim e hare zemrën e besimtarit, atij besimtarit i cili përgjatë një muaji iu përkushtua me plot sinjeritet Zotit, duke agjëruar, falur namaz, dhënë sadaka-lëmshë, duke lexuar Kuran dhe duke bërë dua-lutje. Bajrami është rasti thelbësor që me dinjitet besimtarët të tregojnë falënderimet ndaj Allahut të Lartësuar për begatitë e panumërta që Ai na i ka dhuruar, përfshirë këtu edhe muajin Ramazan.

Për këto begati besimtari duhet të gëzohet, ashtu siç na ka mësuar Allahu xh.sh. në Kuran: "Thua: Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata." (Junus, 58).

Bajrami është festuar edhe në kohën e Pejgamberit a.s.. Madje ai kishte porositur shokët e tij që mos t'i pengonin besimtarët në festimin e këtyre festave, mos t'i pengonin që të luanin apo këndonin.

Bajrami është një ditë e veçantë dhe duhet të jetë e tillë, të jetë një ditë që harrohet pikëllimi e shqetësimi dhe të jetë një ditë që shumëfishohet gëzimi e hareja. Për këtë arsye, në ditët e Bajramit ndalohet edhe agjërim për çfarëdo arsye. Në thëniet profetike qëndron se festat janë ditë të ngrënies, pijes dhe përmendjes së Zotit, e jo ditë zie e agjërimi.

Ajo që e bënë këtë festë më të fuqishme dhe këtë gëzim më gjithëpërfshirës është fakti se festa është shoqërore, dhe festohet në mënyrë kolektive e jo individuale. Festa e besimtarit nuk dallon vetëm nga motivet, por edhe nga mënyra e manifestimit. Logjikisht, nëse besimtari feston për adhurimin që ka bërë, atëherë shthurja nuk duhet të jetë imazh i kësaj feste. Besimtari festën e vet nuk duhet ta degjeneroj me mëkate, me festime të shthurura, në organizime që përcjellin imazhe të kundërta me arsyen dhe motivin e festës. Besimtari, festën duhet ta bëjë me gjërat që na i ka lejuar feja jonë e bukur.

Nëse hedhim një vështrim te popujt e mëhershëm, vërejmë se ata kishin festat e tyre që i festonin për motive të ndryshme dhe në

forma të ndryshme.

Kur Pejgamberi a.s. erdhi në Medinë, ai i gjeti banorët e Medinës duke festuar dy festa, festa e Nevruzit dhe Karnavaleve-Mihrixhanit.² Sipas hulumtimeve, këto ishin festa persiane, por që medinasit i kishin futur në traditën e tyre. Fjala Nevruz është fjalë persiane dhe ka kuptimin "Ditë e re", ndërsa fjala Mihrixhan gjithashtu është fjalë persiane që ka kuptimin "Festival".



Pejgamberi a.s. u interesua për këto dy festa dhe i pyeti ensarët për karakteristikat e tyre dhe motivet e festimit. Ata i thanë se në periudhën e injorancës argëtoheshin në forma të ndryshme në këto ditë. Pas kësaj Pejgamberi a.s. urdhëroi e tha: “Pa dyshim se Allahu këto festa i ka zëvendësuar me dy festa më të mira dhe me të vlefshme, e ato janë: Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami.”³

Siç e dimë, festa e Bajramit është festuar edhe në kohën e Pejgamberit a.s.. Madje ai kishte porositur shokët e tij që mos t'i pengonin besimtarët në festimin e këtyre festave, mos t'i pengonin që të luanin apo këndonin. Transmetohet nga Aisheja r.a. se një ditë gjatë festës së Kurban Bajramit, në praninë e saj, në shtëpinë e saj, dy vajza të vogla këndonin këngë dhe poezi që kishin përmbajtje të një lufte që kishte ndodhur para ardhjes së Islamit në Medinë. I Dërguari a.s. ishte në dhomën tjetër, i shtrirë në shtratin e tij, i mbuluar dhe me shpinën e kthyer duke pushuar. Në atë moment hyri Ebu Bekri r.a. dhe duke menduar se janë duke e shqetësuar të Dërguarin e Allahut gjatë pushimit, iu drejtua Aishes: “Pranë Pejgamberit me instrumente të shejtanit?” Pas këtij reagimi të Ebu Bekrit, i Dërguari i Allahut zbuloi fytyrën dhe urdhëroi: “O Ebu Bekr! Mos i pengo ato, sepse këto janë ditë feste.”⁴

Kemi edhe transmetime të tjera nga i Dërguari i Allahut a.s., e që na mësojnë për mënyrën e manifestimit të festave të Bajramit. Transmetohet se në një ditë Bajrami, disa vajza të vogla po këndonin në xhami, ndërsa disa etiopianë luanin me shtiza dhe mburoja në xhami. I Dërguari i Allahut a.s. së bashku me Aishen r.a. ishin duke i shikuar. Në një moment Pejgamberi a.s., e ndaloi Omerin r.a. që të ndërhynte në shfaqje dhe nuk kishte lejuar që dikush t'i shqetësonte ata në lojën e tyre. Duke u bazuar në jetën e Profetit a.s. dhe sahabëve të tij, dijetarët kanë ardhur në përfundim se lejohet manifestimi i Bajramit me organizime e lojëra të ndryshme, këngë e ilahi që nxitin në dashurinë ndaj fesë dhe vatanit. Normalisht lojëra që burojnë nga tradita e vendit apo edhe lojëra bashkëkohore që janë të lejuara dhe që nuk bien ndesh me normat islame.

Sot, sipas traditave të vendeve të ndryshme ku jetojnë myslimanët, festohet edhe Bajrami, në forma të ndryshme, por normalisht, gjithmonë duke i zbatuar normat islame. Mënyra universale që i bashkon gjithë myslimanët në shënimin e kësaj feste, padyshim është përgatitja e ëmbëlsirave

Duke u bazuar në jetën e Profetit a.s. dhe sahabëve të tij, dijetarët kanë ardhur në përfundim se lejohet manifestimi i Bajramit me organizime e lojëra të ndryshme, këngë e ilahi që nxitin në dashurinë ndaj fesë dhe vatanit.

në shtëpi, për të treguar se shtëpitë e myslimanëve janë ëmbëlsuar në këtë ditë feste e gëzimi.

Vizitat te njëri-tjetri, urimet e ndërsjella, shtrirja e dorës së pajtimit në këtë ditë, tregojnë që besimtari është afruar për një muaj, në rrafshin vertikal, me Allahun xh.sh. dhe tash afrohet edhe në rrafshin horizontal me familjar e fafesisin e tij, duke lënë anash zënkën dhe hasmëritë e mëhershme dhe duke ua shtrirë dorën e pajtimit. Zbukurimi i shtëpive dhe veshja e rrobave të reja dhe më të bukura, gjithashtu e karakterizojnë mënyrën se si festohet Bajrami. E kjo praktikë e zbukurimit ishte edhe njëra nga traditat e të Dërguarit, Muhamedit a.s..

Transmetohet nga Omeri r.a., të ketë thënë: “Për Bajram, ai vishte rrobat më të mira dhe më të bukura që kishte.”⁵

Nga praktika e Pejgamberit a.s. gjatë ditës së Fitër Bajramit ishte dhënia e sadakatul-fitrit, dhënien e të cilit e urdhëroi të bëhet para faljes së namazit të Bajramit “Sadakatul-fitri të jepet para daljes së njerëzve për namaz.”⁶ Kjo tregon për kujdesin që duhet të kenë besimtarët ndaj atyre që kanë nevojë, që edhe ata të kenë mundësi të gëzojnë në familjet e tyre festën e Bajramit. Disa veprime që i bënte i Dërguari i Allahut a.s. gjatë ditës së Fitër

Bajramit ishin edhe këto: Nuk dilte nga shtëpia ditën e Fitër Bajramit pa i ngrënë disa kokrra hurme, shkruarjen në Bajram e bënte për një rrugë, ndërsa kthimin nga Bajrami e bënte nga një rrugë tjetër.

Besimtari duhet pasur kujdes që sa ma shumë të mundohet të futë gëzim në zemrat e njerëzve gjithmonë, e sidomos në këto ditë. T'i largojë nga njerëzit hidhërimet dhe mërzitë e tyre. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Prej punëve më të mira të besimtarit është, bërja të gëzuar një besimtar dhe largimi i një brenge të tij.”⁷ Për këtë arsye nuk preferohet që në këto ditë feste, gëzimi e hareje, ta bëjmë praktikë që të shkojmë te varrezat dhe të mbajmë zi për ata që nuk i kemi në mesin tonë në këtë botë.

1 Transmetojnë Buhariu, 1904 dhe Muslimi, 1151.

2 Sherh suneni ibën Maxhe, 123.

3 Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesaiu.

4 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, marrë nga libri “Islami nëpërmjet haditheve VII”, botoi Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, fq. 493.

5 Bejhakiu në “Sunenul-kubra” (3/281).

6 Transmetojnë Buhariu, 1509 dhe Muslimi, 986.

7 Transmeton Buhariu, 5773.

Komentimi i kaptinës El-Fet'h (3)

MIRËSITË E VEÇANTA TË PAQES SË HUDEJBIJES PËR MUHAMEDIN A.S.

Sabri Bajgora

Kjo sure fillon me një hapje madhështore dhe triumfaliste, dhe jep shenjë përgëzuese për fitoren e qartë, fitoren më të madhe të Islamit deri atëherë-marrëveshjen e Hudejbijes, e cila i dha krah të Dërguarit të Allahut

إِنَّا فَتَحْنَا لَكَ فَتْحًا مُبِينًا ﴿١﴾ لِيَغْفِرَ لَكَ اللَّهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ وَيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَيَهْدِيَكَ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا ﴿٢﴾ وَيَنْصُرَكَ اللَّهُ نَصْرًا عَظِيمًا ﴿٣﴾

“Ne të dhamë ty një fitore të madhe, që Allahu të t'i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Vet ndaj teje dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë, dhe që Allahu të të përkrahë me një ndihmë të fortë.” - (El Fet'h, 1-3)

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETEVE (1 DHE 2)

A shtu siç kemi përmendur në fillim të sures, kjo sure ka zbritur në tërësi në lidhje me Marrëveshjen e Hudejbijes. Në lidhje me këtë është transmetuar nga Misver ibn Mahzime dhe Mervan ibn Hakemi të kenë thënë: “Ka zbritur surja El Fet'h në mes Mekës dhe Medinës, në lidhje me çështjen e Hudejbijes, prej fillimit e deri në fund.”¹

- Transmetohet nga Enes ibn Maliku r.a. të ketë thënë: “Kur pati zbritur “Inna fetahna leke fet'han mubina” deri tek ajeti “fevzen adhima”, në të kthyer nga Hudejbija, shumë prej sahabëve i kishte kapluar pikëllimi dhe trishtimi. Ndërkohë, i Dërguari i Allahut pasi i preu kurbanet në Hudejbije kishte thënë: “Sonte më ka zbritur një ajet, që është më i dashur për mua se e tërë bota dhe ç'ka në të.”²

- Imam Sujutiu përcjell një transmetim nga Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Hakimi, e këta nga Enesi r.a. të ketë thënë: “I ka zbritur Pejgamberit a.s. ajeti: “që Allahu të t'i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Vet ndaj teje dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë” - (El Feth, 2), në të kthyer nga Hudejbija, ndërsa i Dërguari i

Allahut në lidhje me këtë pati thënë: “Më ka zbritur një ajet, që për mua është më i dashur se krejt çka ka në Tokë.”³

KOMENT:

1. Ne të dhamë ty një fitore të madhe

Kjo sure fillon me një hapje madhështore dhe triumfaliste, dhe jep shenjë përgëzuese për fitoren e qartë, fitoren më të madhe të Islamit deri atëherë-marrëveshjen e Hudejbijes, e cila i dha krah të Dërguarit të Allahut për të vazhduar i palëkundur në rrugën e thirrjes në Njëshmërinë e Allahut Fuqiplotë. Kjo sure zbriti si një qetësim shpirtëror për Pejgamberin a.s., dhe për besimtarët, duke i përgëzuar ata se tashmë kishte ardhur koha e fitoreve dhe e ngadhënjimeve të mëdha. Nga shumica dërrmuese e dijetarëve, marrëveshja e Hudejbijes, radhitet si fitorja më e madhe politike dhe diplomatike e myslimanëve, meqë aty nuk pati në betejë të vërtetë, me armë.

Se vërtet bëhet fjalë për një fitore dhe ngjarje madhështore, siç është Marrëveshja apo Traktati i Hudejbijes, për këtë do të bindemi gjatë komentimit të kësaj sureje, po edhe të analizës së ngjarjeve që rrodhën në vitet e pakta pas nënshkrimit të saj, ku Islami mori hov dhe gufoi me tërë madhështinë e tij edhe jashtë kufijve të Gadishullit arabik.

Në lidhje me këtë fitore - çlirim apo “Fet'h”, shumica dërrmuese e dijetarëve kanë thënë se kjo fitore nënkupton marrëveshjen e Hudejbijes. Për këtë dëshmon edhe vetë zbritja e kësaj sureje të bekuar gjatë kthimit



nga Hudejbija. Se “*Fet’hu-l mubin*” nënkupton marrëveshjen e Hudejbijes, kemi shumë transmetime nga sahabët, ndër të cilët do të veçonim thëniet e disa prej tyre. Ibn Mesudi ka thënë: “Ju e llogaritni fitore, çlirimin e Mekës, kurse ne për fitore e llogarisim marrëveshjen e Hudejbijes”⁴ I njëjti transmetim me një shtesë në fund përcillet edhe nga Berraë bin Azib kur thotë: “... Ne e llogarisim si fitore “*Bejatu’r-Rridvan*” në ditën e Hudejbijes”, të cilin transmetim e ka regjistruar Imam Buhariu.⁵

Po ashtu, kur Umeri r.a. e pati pyetur të Dërguarin e Allahut: A është kjo një fitore (*Fet’h*) ja Resulullah?, kurse i Dërguari a.s. iu përgjigj: “Po, pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim (jetën time) kjo (Marrëveshja e Hudejbijes) është fitorja më e madhe.”⁶

Ashtu siç kemi përmendur më herët, pas nënshkrimit të Marrëveshjes, sahabët kishin mbetur të nemitur, pa fjalë dhe të zhgënjyer, për shkak se sipas tyre “u lëshua pe” në dobi të idhujtarëve. Madje, ky zhgënjim u reflektua edhe në fjalët e sjelljet e tyre. Transmeton Bejhekiu nga Urvete bin Zubejri të ketë thënë: Në të kthyer nga Hudejbija, njëri prej sahabëve të Resulullahut s.a.v.s. kishte thënë: “A thua çfarë fitore (çlirim) është kjo, kur ne u penguan nga Shtëpia e shenjtë së bashku me kurbanet tonë?!”. Kur i Dërguari i Allahut i dëgjoi këto fjalë, tha: “Sa

fjalë të shëmtuara janë këto që po i dëgjoj. Përkundrazi, kjo (marrëveshja) është fitorja më e madhe. Idhujtarët janë pajtuar që t’ju largojnë (pengojnë) për një kohë nga vendi i tyre, por gjithashtu kanë kërkuar prej jush që ta merrni parasysh edhe çështjen e sigurisë suaj. Ata, vërtet ndiejnë urrejtje ndaj jush, por Allahu ju ka bërë ngadhënjimtar ndaj tyre, duke ua mundësuar që të ktheheni të qetë e të sigurt, si triumfues e të shpërblyer, prandaj dijeni se kjo është fitorja më e madhe. Vallë, a mos e keni harruar ditën e Uhudit, kur ju ngjiteshit (kodrës, duke ikur nga fushëbeteja), pa i hedhur sytë askujt, ndërsa unë ju thërrisja që të ktheheshit?! Vallë a mos e keni harruar ditën e Ahazabit (luftën e Hendekut), kur ata ju erdhën prej së larti edhe prej së poshtmi, dhe kur shikimet tuaja u shtangën, e zemrat erdhën në fyt (nga frika), dhe ju filluat të sajoniit lloj-lloj mendimesh (të kota) për Allahun?!” Atëherë myslimanët, të turpëruar nga këto fjalë, u kthyen e thanë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij po e thonë të vërtetën. Pa dyshim, kjo po që është fitorja më madhështore. Betohe mi në Allahun o i

Dërguari i Allahut se nuk e kemi menduar këtë që po e thoni. Ti vërtet je më i ditur së ne për Allahun dhe për çështjet e tjera.”⁸

Megjithëse një grup i vogël i dijetarëve, me në krye Zemahsheriun, mendojnë se me këtë “*Fet’h*” është synuar çlirimi i Mekës,⁹ prapëseprapë ky mendim, nuk ka gjetur ndonjë mbështetje a përkrahje të madhe nga ana e shumicës dërrmuese së dijetarëve. Ndërkohë, ka edhe të tillë që thonë se me fjalën “*Fet’h*” këtu, është synuar çlirimi i Hajberit¹⁰ një ish fortifikatë çifute, por ky mendim, është shumë larg të qenit i pranuar, sepse dihet se surja ka zbritur në të kthyer nga Hudejbija, kurse çlirimi i Hajberit ka ndodhur disa muaj më vonë.

2. që Allahu të t’i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Vet ndaj teje dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë,

Ashtu siç pamë edhe te shkaku i zbritjes së këtij ajeti, kur i Dërguari a.s. tha: “*Sonte më ka zbritur një ajet, që është më i dashur për mua se e tërë bota dhe ç’ka në të*”, ai e kishte fjalën pikërisht për këtë ajet, të dytin të kësaj sureje, nëpërmjet të cilit, i Madhërishmi shpërfaq tërë mirësitë e Tij ndaj Pejgamberit a.s.. Është ky një ajet që ka zbritur i veçantë vetëm për të Dërguarin e Allahut, ashtu siç e ka përmendur edhe Ibn Kethiri kur thotë: “Ky ajet është i posaçëm vetëm për Resulullahun s.a.v.s., në të

Kur Umeri r.a. e pati pyetur të Dërguarin e Allahut: A është kjo një fitore (*Fet’h*) ja Resulullah?, kurse i Dërguari a.s. iu përgjigj: “Po, pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim (jetën time) kjo (Marrëveshja e Hudejbijes) është fitorja më e madhe.”

cilin, Allahu nuk e bën hisedar askënd tjetër. Ai ia ka falë të gjitha gabimet e mëparshme dhe ato të mundshme të mëvonshme. Në këtë ajet ka nderim madhështor për Pejgamberin a.s., sepse ai me përkushtimin e tij në të gjitha çështjet siç janë nënshtrimi ndaj Zotit, mirësia dhe përqendrimi, ishte i paarritshëm nga asnjë njeri, as nga gjeneratat e para e as nga ato të mëvonshme të njerëzimit. Ai është absolutisht dhe padyshim njeriu më i kompletuar dhe zotëria i krejt njerëzimit në këtë dynja dhe në Ahiret.”¹¹

Se për çfarë plotësimi të mirësive nga ana e Allahut bëhet fjalë këtu, mjafton të përmendim se Ai, ia kishte besuar të Dërguarit të Vet - Muhamedit a.s., lartësimin e fesë islame dhe shpërndarjen e këtij mesazhit hyjnor në të katër anët e botës. Ai e kishte fuqizuar me udhëzim të drejtë, duke mos e lënë asnjëherë të vetëm në këtë mision të vështirë të përudhjes së njerëzve, duke i dhuruar gjithashtu një ligj-shariat madhështor, i cili do t'i nxjerrë njerëzit nga errësira e kufrit në dritën e së vërtetës.

I Lartmadhërishtëmi, nëpërmjet këtyre ajeteve që ndërliiden me Marrëveshjen e Hudejbijes, të cilësuar si një fitore e madhe, e kishte veçuar të Dërguarin e Vet edhe me këto mirësi:

a) Dëlirësi dhe ngritje shpirtërore për Pejgamberin a.s., deri në atë stad, kur nga Krijuesi i falen të gjitha gabimet e kaluara, dhe ato të mëvonshmet, të cilat në

**Kur Allahu
xh.sh. ia largoi
Muhamedit
a.s., të gjitha
pengesat e
mundshme që
kumtimi të
gjente rrugën
e vet të
natyrshme në
zemrat e
njerëzve, i
Dërguari i
Allahut ishte
ndjerë aq i
lumtur, sa që
nuk e fshihte
dot gëzimin,
pasi që i kishte
zbritur kjo
sure.**

fakt janë dëshmi të nderimit të tij nga ana e Allahut, si i përzgjedhuri i Tij, për ta përcjellë mesazhin e fundit qiellor te banorët e Tokës.

b) I Madhërishtëmi ia bashkoi të Dërguarit të Vet, profecinë dhe pushtetin, për t'ua dëshmuar njerëzve se Muhamedi a.s. përveçqë ishte i Dërguar i Zotit, po ashtu ishte udhëheqës ushtarak dhe strateg politik.

c) Udhëzimin në rrugën e drejtë dhe trasimin e rrugës për kumtimin e Shpalljes, dhe

d) Dhurimin e fitores dhe ngadhënjimin mbi armiqtë e Njeshmërisë, duke e përkrahur e fuqizuar atë në çdo hap të kumtimin.¹²

Pikërisht për shkak të këtyre mirësive, që ishin fryt i Marrëveshjes së Hudejbijes, kur Allahu xh.sh. ia largoi Muhamedit a.s., të gjitha pengesat e mundshme që kumtimi të gjente rrugën e vet të natyrshme në zemrat e njerëzve, i Dërguari i Allahut ishte ndjerë aq i lumtur, sa që nuk e fshihte dot gëzimin, pasi që i kishte zbritur kjo sure. Ai, ndonëse edhe para zbritjes së kësaj sureje, e adhuronte Allahun me përlulësi gjatë namazit duke ndenjur gjatë në ruku e sexhde, e duke bërë lutje-dua, megjithatë, pas kësaj dite, ai e kishte shumëfishuar ibadetin e tij. Ai tash lutej dhe falej aq gjatë, sa që në lidhje me këtë kanë folur shumë prej sahabëve dhe sidomos bashkëshortja e tij, Aisheja r.a..

Transmetohet nga Mugire ibn Shu'beh r.a. të ketë thënë. “I Dërguari i Allahut falej aq gjatë sa që i ënjteshin këmbët. Kur



i thuhej: A nuk t'i ka falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ai me modesti përgjigjej: “Vallë, a mos të jem rob falënderues.”¹³

Një transmetim i ngjashëm përcillet edhe nga Aisheja r.a. të ketë thënë: “Kur i Dërguari i Allahut falej, qëndronte aq gjatë në namaz sa që edhe këmbët i plasariteshin, e pastaj Aisheja e pyeste: “Përse po e bën këtë kur Allahu t'i ka falur gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme”, kurse ai i përgjigjej: “Oj Aishe, vallë, a mos të jem rob falënderues.”¹⁴

Kur jemi tek ajeti i dytë i kësaj sureje, “që Allahu të t'i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme”, lidhur me faljen e gabimeve të Pejgamberit a.s. nga ana e Allahut, ato të kaluarat dhe të ardhshmet, është mendim unanim se të gjithë të dërguarit e Zotit kanë qenë të mbrojtur nga mëkatet edhe para, edhe pas gradimit me pejgamberi, që do të thotë se është e pamundur të paramendohet që ndonjëri prej të dërguarve të Allahut të ketë bërë kufër ose shirk ndonjëherë. Pra, asnjëri prej tyre nuk ka pasur ndonjë lëshim kur është në pyetje kumtimi i Shpalljes hyjnore, sepse janë të mbrojtur nga ana e Krijuesit Fuqiplotë, ndërkohë që në aspektin e njerëzores së tyre, mund të ketë pasur ndonjë lëshim emocional gjatë përballjes së tyre me jobesimtarët, derisa ishin duke ua kumtuar porositë e të Madhit Zot.

Imam Maturidiu, duke konfirmuar se të dërguarit e Allahut janë të mbrojtur nga rënia në mëkate, sjell një mendim, se me këtë ajat synohen mëkatet e ymetit, d.t.th., ty o i Dërguar, Allahu t'i ka falë mëkatet e ymetit tënd, përderisa ti kërkon falje për ta, duke ndërmjetësuar tek Allahu për t'ua falur mëkatet.¹⁵

3. dhe që Allahu të të përkrahë me një ndihmë të fortë.

Kjo përkrahje nga ana e Allahut, nënkupton përkrahje të plotë në çdo hap të misionit të Pejgamberit a.s., i cili për asnjë çast nuk do ta ndjente veten të vetmuar në këtë rrugëtim drejt shpëtimit të njerëzve nga myku i robërisë shpirtërore. Vetë fakti se i Madhërishti e kishte zgjedhur Muhamedin a.s. nga i tërë njerëzimi për ta bartur këtë dritë të udhëzimit drejt zemrave të njerëzve, flet mjaft, andaj edhe përkrahja hyjnore kurrë nuk do të mungonte, ashtu siç nuk i mungoi edhe gjatë rrugëtimit dhe arritjes së Marrëveshjes së Hudejbijes, marrëveshje e cila, do t'ia hapte krah e krah dyert Islamit, që të depërtonte në zemrat e njerëzve, lirshëm dhe natyrshëm.

POROSIA E AJETEVE (1-3)

- Marrëveshja e Hudejbijes ishte fitorja më e madhe e myslimanëve në rrafshin politik dhe diplomatik. Frytet e saj do të shiheshin menjëherë pas nënshkrimit të saj, andaj i Madhërishti me plot të drejtë e ka quajtur “Fitore të madhe e të qartë” - “Fet'un mubin”, sepse kjo marrëveshje i hapi rrugë fitoreve dhe çlirimeve të tjera islame, e një prej tyre ishte edhe vetë çlirimi i Mekës nga idhujtaria.

- Nëpërmjet marrëveshjes së Hudejbijes u realizuan tri qëllime madhore të myslimanëve:

a) Myslimanët tashmë e kishin të qartë se ç'forcë ka armiku dhe sa mund të rezistojë ajo forcë në betejat e ardhshme luftarake, politike dhe diplomatike në mes tyre,

b) Nga mesi i myslimanëve, u panë dhe u dalluan në mënyrë të haptë mynafikët-hipokritët, dhe

c) Përzjerja në mes myslimanëve dhe idhujtarëve ndikoi në pranimin e Islamit nga shumë prej idhujtarëve, dhe ende pa kaluar mirë dy vite e ca, numri i myslimanëve u dhjetëfishua.

- Frytet dhe mirësitë e kësaj fitoreje, kishin ndikim të drejtpërdrejtë te Pejgamberi a.s., personalisht, sepse Allahu e kishte ngritur aq lartë duke e nderuar me faljen e ndonjë lëshimi nga e kaluara dhe ndonjë të mundshëm në të ardhmen, dhe e kishte përkrahur me ndihmë për të ngadhënjyer ndaj armiqve të tij.

- Marrëveshja e Hudejbijes rezultoi e frytshme për myslimanët, për faktin se idhujtarët u detyruan të nënshkruanin Marrëveshje paqësore me Muhamedin a.s., duke e pranuar kështu edhe zyrtarisht ekzistencën e shtetit islam në Medinë, të cilin e kishte themeluar i Dërguari i Allahut në themelet e shëndosha që buronin nga burimi-kroi hyjnor i Islamit. - vijon -

1 Transmetojnë Hakimi në *El-Muštēdrek* (2/459); Imam Sujutiu në *Ed-Durrul Menthur* (7/507) dhe në *Lubabu-n-nukul fi esbabi-n-nuzuli*, Bejrut, 2002, f. 237; Shih: Imam Vahidij en Nejsaburi, *Esbabun-n-nuzuli*, Demmam, 1992, f. 382.

2 Sahihul Buhari “*Kitabul Megazi-Gazvetul Hudejbije*”, hadithi nr. (3895); Sahihu Muslim “*Kitabul xhihadi ve-s-sejri-babu Sulhu Hudejbije*”, nr. i hadithit (3854); Vahidij en-Nejsaburi, *Esbabun-n-nuzuli*, f. 382; Fahrudin bin Zubejr el Muhsi, *Ed-Durrer min sahihi fedaili-l ajati ve-s-suver*, UAE, 2004, f. 40.

3 Imam Sujutiu, në *Lubabu-n-nukul fi esbabi-n-nuzuli*, f. 237.

4 Mustafa ibnul Adevij, *Et-Tes'hil li te'vili-t-tenzil, tefsir xhuz'u Ahkaf fi sualin ve xhevabin*, f. 190.

5 Sahihul Buhari, nr. (4150).

6 Imam El-Kurtubij, *El-Xhamiu li ahkamil Kuran*, Bejrut, 2006, vëll. 19, f. 297.

7 Abdulhamid Kishk, *Fi Rihabi-t-tefsir*, vëll. 26, f. 5665; Imam Kurtubiu, *El-Xhamiu li ahkami-l Kuran*, Bejrut, 2006, vëll. 19, f. 297. (Redaktuar nga Dr. Abdullah et-Turki)

8 *Et-Tahriru ve-t-Tenviru*, vëll. 26, ff. 145-146; *Tefsir sureti-l Fet'h*, ff. 32-33.

9 Ky është qëndrim i Zemahsheriu. Shih: *El-Kesh-shaf*, Rijad, 1998, vëll. V, f. 534.

10 Ky është mendim i Muxhahidit, që është cituar nga Ibn Adil ed-Dimeshkij el Hanbelij në tefsirin e tij, *El-Lubab fi ulumil Kitab*, Bejrut, 1998, vëll. 17, f. 474.

11 Ibn Kethir, *Tefsirul Kurani Adhim*, Rijad, 1999, vëll. 7, f. 328. (redaktuar nga Sami bin Muhamed es-Selame).

12 *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. 26, f. 477.

13 Transmetojnë Buhariu (1130); Muslimi (2819); Nesaiu (3/219); Tirmidhiu (412); Ibn Maxhe (419) dhe Imam Ahmedi (4/255).

14 Transmetojnë Buhariu (4837); Muslimi (2820); dhe Imam Ahmedi (6/115).

15 Imam Maturidiu, *Te'vilatu Ehli-s-Sunneti*, Bejrut, 2005, vëll 9, f. 293 (Redaktuar nga dr. Mexhdi Basel-lum).

Karakteri paqësor i Profetit Muhamed a.s. (3)

Flamur Vehapi

Ndershmëria e tij ishte aq shembullore saqë as armiqtë e tij më ngulmues nuk mund t'i binin mohit për këtë. Mekasit ia jepnin gjërat me vlerë për t'i ruajtur rioshit Muhamed a.s. dhe ky zbatim vazhdoi edhe pasi ai u bë profet.

Ajo që është më e pazakontë në lidhje me Profetin Muhamed a.s. është se, ai ishte po aq fisnik dhe i jashtëzakonshëm jashtë fushës së betejës sa ishte në të. Në Islam, nuk mjafton thjesht të përmbushen ritualet dhe praktikatat e besimit pa i shoqëruar me një karakter fisnik. Përmes një karakteri të mirë mund ta zmbarsë njeriu të keqen brenda vetes dhe të tjerëve. Anasjelltas, një karakter i keq mund të shkaktojë shumë dëm mes shoqi-shoqit. Sipas Kuranit, Profeti a.s. kishte karakterin më të mirë dhe më të madhnueshëm, i cili është themeli për arritjen e paqes së brendshme.¹ Kjo pastaj rrezaton si paqe e jashtme dhe është ajo që e bën diplomat të suksesshëm që zgjidh ndërlidhjet dhe realizon zgjidhje paqësore për situata të vështira. Aspekti më i jashtëzakonshëm i karakterit të Profetit ishte se ai ishte falës, bujar e i mëshirshëm, jo vetëm për miqtë dhe ndjekësit, por të gjithë ata që haste; ndaj dhe thuhet se kushdo që e takonte një herë do të dëshironte të takohej me të rishtas.²

Ndershmëria e tij ishte aq shembullore saqë as armiqtë e tij më ngulmues nuk mund t'i binin mohit për këtë. Mekasit ia jepnin gjërat me vlerë për t'i ruajtur rioshit Muhamed a.s. dhe ky zbatim vazhdoi edhe pasi ai u bë profet. Kemi përmendur se Kurejshët ndërmorën një komplot vrasjeje kundër Profetit a.s. për ta penguar atë të shpërngulej në Medinë. Në këtë periudhë, Profeti a.s. ruante gjërat e vlefshme të shumë jomyslimanëve. Natën e mësymjes, ai ia dha të gjitha këto amanete kushëririt të tij Aliut,

për t'ua kthyer pronarëve të ligjshëm - pikërisht te njerëzit që orvateshin ta mbysnin.³

Profeti a.s. ishte njeriu më i duruar; durimtar përballë fatkeqësive dhe humbjeve vetjake, durimtar edhe si mësues, edhe me njerëzit që e rrethonin. Veçmas durimit, ai kishte një butësi - një gjendje të sjelljes së ndershme dhe një qetësi përkundër ngacmimeve kur kishte të bënte me njerëz të vrazhdë dhe të pakulturuar. Një herë, një beduin erdhi për t'i kërkuar Profetit disa lekë, ai e tërhoqi gunën e Profetit aq fort sa i la shenjë në qafë. Megjithatë, Profeti a.s. nuk tregoi shenja bezdie dhe kërkoi që beduinit t'i jepej ajo që kishte kërkuar.⁴

Si familjar, Profeti a.s. ishte bashkëshort i vëmendshëm dhe i kryente pjesën e tij të detyrave shtëpiake. Gruaja e tij, Aisheja r.a., tregon se ai i rregullonte teshat dhe këpucët, milte delet dhe shërbente vetë.⁵ Ai ishte baba i dashur i katër vajzave, të cilat i trajtonte me shumë dashuri dhe nder, në një kohë kur të kishe vajza quhej gjë e rëndë. Ai ishte gjithashtu një gjysh i përkushtuar. Ai është parë duke mbajtur në krahë mbesën e tij teksa po kryente namazin me xhemat në xhami.⁶ Një parashtrësë tjetër thotë se ai pa dy nipat e tij të vegjël duke ecur drejt tij në xhami, ndërsa ai po mbante një ligjëratë. Ai u ndal, i mori, i uli pranë tij dhe vazhdoi me ligjërimin e tij.⁷ Kjo ishte një sjellje e pashoqe në një shoqëri ku burrat i kuanin gratë e tyre pronë të tyre, vajzat e tyre si detyrim dhe nuk shihej burrërore të tregosh dashuri ndaj carrokëve.

Jeta në shtëpinë e Profetit ishte e përkorë dhe e thjeshtë. Ai ka ngrënë në tokë dhe ka

fjetur në tokë, në një dyshek që ka lënë vrage në kurmin e tij. Ai nuk flinte derisa i kishte dhënë të gjitha paratë në shtëpinë e tij në atë shkallë sa ai dhe familja e tij shpesh rrinin pa ushqim. Sidoqoftë, ai ishte jashtëzakonisht i mirëpritur për mysafirët, duke shtrirë cohën e tij që ata të uleshin dhe të ndante gjithçka që kishte. Ai zgjodhi ta jetonte jetën e tij në këtë mënyrë ndonëse atij i ishte ofruar rehati në shumë raste nga shokët e tij.

Në nivel shoqëror, ai vizitonte të sëmurët, sado i vështirë të ishte udhëtimi dhe dëshironte mirëqenien e njerëzve që njihte. Ai ulej me të varfrit dhe u fliste njëlloj, pranonte ftesat e të gjithë atyre që e ftonin: skllëvërve apo fisnikëve. Ai madje ishte dashamirës ndaj kafshëve. Është treguar se Profeti a.s. hyri në një fermë dhe pa një deve. Profeti ia fërkoj veshët devesë dhe pyeti se kujt i përkiste. Pronarit, ai i tha. “A nuk do t’i frikësoheni Zotit në trajtimin e kësaj kafshe që Zoti ju ka vënë në dorë? Devoja m’u ankua se e mbani të uritur dhe e mundoni shumë.”⁸

Është karakteri, integriteti, ndershmëria e dhembshuria e këtyre përmasave ato që shkrin zemrat më të forta, nismojnë ndryshime shoqërore për mirë, zgjidhin përplasjet dhe rrezojnë paqe. Këto nuk ishin cilësi që jetuan dhe vdiqën me Profetin a.s., por një shembull se si duhet të sillen myslimanët në mbarë botën dhe gjatë gjithë kohës. Pavarësisht se çfarë

pozicioni mban një mysliman, mbret apo mëditës, punëtor apo prind, i pjekur apo i ri, ata të gjithë përpiqen të shkërbejnë shëmbëlltyrën e Profetit a.s., sepse për një mysliman, të vetmit njerëz që meritojnë të shkërbehen janë profetët, ku Profeti Muhamed shënon të mbramin dhe përfundimtarin. Për shembullin e jashtëzakonshëm të Profetit a.s., burrështetasi francez i shekullit të nëntëmbëdhjetë, Alphonse de Lamartine, shkroi:

“Nëse madhështia e synimit, vogëlsia e mjeteve dhe arritjet mahnitëse janë tri kriteret e gjenialitetit njerëzor, kush do të guxonte të përqaste çdo njeri të madh në historinë moderne me Muhamedin? Burrat më me zë krijuan armë, themeluan ligje e perandori, e, në mos fare, kurrëgjë me tepër se fuqi materiale nuk arritën, të cilat shpesh iu shkërmoqën përpara syve. Ky njeri tundi jo vetëm ushtritë, legjislacionin, perandoritë, popujt dhe dinastitë, por miliona njerëz në një të tretën e botës atëherë, dhe më shumë se kaq tundi altarët, perënditë, fetë, shllimet (idetë), besimet dhe shpirtat. Durimi i tij në fitore, ambicia e tij, që ishte tërësisht i përkushtuar ndaj një synimi dhe në asnjë mënyrë nuk rrekej për një perandori të tijën; lutjet e pafundme, bisedat e tij mistike me Zotin, vdekja dhe triumfi i tij pas vdekjes, të gjitha këto dëshmojnë jo për një mashtrim, por për një bindje të fortë, e cila i dha fuqinë për të rivendosur një dogmë. ...Filozof, orator, apostull, ligjvënës, luftëtar, pushtues i shllimeve, rivendosës i dogmave racionale, i një kulti pa imazhe; themeluesi i njëzet perandorive tokësore dhe i një perandorie shpirtërore është Muhamedi. Sa u përket standardeve me të cilat mund të matet madhështia njerëzore, mund të pyesim fare mirë, a ka ndonjë njeri më të madh se ai?”⁹

Edhe Michael Hart, një ideolog i njohur amerikan, i cili për më tepër e shihte Islamin si kërcënim për qytetërimin perëndimor, nuk mund ta mohonte madhësinë e gjithanshme të Profetit a.s.. Në librin e tij “100-shi: Një renditje e personave më me ndikim në histori”, Hart-i e rendit Profetin Muhamed në vendin e parë. Ai e hap kreun me shënimin, “Zgjedhja ime që Muhamedi të prijë listën e vetave më me ndikim në botë mund të befasojë disa lexues dhe mund të vihet në dyshim nga të tjerët, por ai ishte i vetmi njeri në histori që ishte jashtëzakonisht i arrirë në të dyja aspektet: fetare dhe sekulare.”¹⁰

1 El Kalem, 4.

2 Musharraf Hussain, *Seven Steps to Moral Intelligence*, 2009, fq. 29.

3 Salahi, 2013, fq. 47.

4 Hadith në *Sahih al-Bukhari* and *Sahih Muslim*.

5 Hadith në *Sunan al-Bayhaqi*.


6 Hadith në *Sahih Muslim*.

7 Salahi, 2013, fq. 127.

8 Ibid., fq. 136.

9 Alphonse de Lamartine, *Histoire de la Turquie*, 1854, fq. 276-77.

10 Michael Hart, *The 100: A Ranking of the Most Influential Persons in History*, 1978, fq. 3.



Feminizmi dhe racionaliteti i luftës së tyre për të drejtat e grave

Nada Dosti

Feminizmi nuk përfaqëson domosdoshmërisht një ideologji, e cila gjithmonë lufton për ta prishur familjen, për të ushtruar presion te gratë se mund t'ia dalin dhe vetë në çdo sferë të jetës edhe pa pasur një partner përkrah dhe se nuk kanë nevojë të jenë nëna për t'u ndjerë të plotësuar.

Kur flitet për feminizmin, në të shumtën e rasteve mendohet si një ideologji që synon të nxjerrë gratë nga binarët, që ka për qëllim prishjen e familjes, që diskriminon meshkujt karshi grave, e shumë paragjykime të tjera të ngjashme.

Në fakt, të gjitha këto paragjykime apo bindje rreth ideologjisë feministe burojnë nga një degë ose valë e caktuar, që ndryshe njihet si feminizmi ekstrem, feminizmi i bardhë apo nënkategori të tjera. Kohë pas kohë, rryma të ngjashme kanë propaganduar idenë se gratë nuk kanë nevojë të kenë një burrë në krah, ia kanë mohuar grave një pjesë të natyrshmërisë së tyre, siç është edhe mëmësia. Para se të kritikohet e gjithë ideologjia, duhet theksuar fillimisht se në ideologjinë feministe mund të gjejmë edhe disa element të dobishëm, pavarësisht qëllimit që qëndron pas, kjo për të qenë më objektiv dhe për të njohur edhe disa aspekte të cilat duhen vlerësuar.

Sidoqoftë, feminizmi nuk ka qenë kurrë një lëvizje monolite. Feminizmi nuk përfaqëson domosdoshmërisht një ideologji, e cila gjithmonë lufton për ta prishur familjen, për të ushtruar presion te gratë se mund t'ia dalin dhe vetë në çdo sferë të jetës edhe pa pasur një partner përkrah dhe se nuk kanë nevojë të jenë nëna për t'u ndjerë të plotësuar.

Por, ajo çfarë e karakterizon feminizmin në përgjithësi, pavarësisht rrymave apo valëve të ndryshme të themelimit dhe

veprimit, është fakti se një mbisundimin e meshkujve ndaj grave dhe lufton për barazi gjinore. Një ndër aspektet e dobishme mund të jetë pikërisht kjo këmbëngulje për t'i ndërgjegjësuar fillimisht vetë gratë, pastaj dhe burrat për ligësinë dhe dëmet e patriarkalizmit, si dhe për të luftuar kundër këtij sistemi, i cili shtyp të drejta themelore të grave të garantuara nga vetë Zoti. Andaj duhet të bëjmë kujdes kur flasim në emër të feminizmit duke specifikuar se për cilën rrymë apo valë po flasim.

Gjithashtu, duhet të bëjmë kujdes edhe kur përdorim termin feministe. Sa e përshtatshme është të quash një grua feministe vetëm e vetëm sepse ngre zërin rreth të drejtave të disa grave, dhe jo të gjithave grave? Sa korrekt është politikisht të quash feministe gra të cilat vetët e tyre nuk i kanë quajtur të tilla?

Sabina Lovibond, specialiste e çështjeve gjinore, duke e kritikuar feminizmin radikal, shprehet se një nga dështimet e kësaj rryme ka të bëjë me mos përcaktimin e një grupi vlerash të qarta dhe të dallueshme nga feminizmi reformist. Ky i fundit mund të përkufizohet si një rrymë e kohës sonë, post-moderniste, e cila synon të rishikojë edhe një herë ideologjinë feministe, duke e parë nga lente të ndryshme, përveçse të feminizmit të bardhë. Kjo arrihet duke marrë parasysh praktikatat vendase, tipare lokale dhe duke u përpjekur për t'i kuptuar në një kontekst global.

Sipas Elizabeth Grosz, kriza e racionalitetit të feminizmit ka të bëjë edhe me krizën e maskulinitetit. Vitet e fundit, të ndjerë nën presion nga lobimi i fuqishëm feminist, duket se ka një rrizgim dhe vetëdijesim për maskulinitetin.

FEMINIZMI DHE POST-MODERNIZMI

Vetë termi post-modernizëm duket si një sinonim i një periudhe kohore bashkëkohore përtej modernizmit, duke e bërë këtë të fundit si diçka të prapambetur dhe që tashmë i takon të shkuarës. Në thelb, feminizmi i ka rrënjët të ngulitura në idetë e iluminizmit. Si i tillë promovohet nga elita për të theksuar më shumë përpjekjet kolonialiste duke propaganduar filozofitë perëndimore, veçanërisht liberalizmin sekular. Andaj si i tillë, nuk ka për qëllim mbrojtën e të drejtave të grave, por për promovimin e ideologjisë liberale. Këtë e vërteton fakti se sa herë që bëhet fjalë për drejtat e grave të kulturave dhe feve të ndryshme, feministet heshtin. Deri më sot, asnjë grup apo organizim feminist nuk janë bërë bashkë për të luftuar të drejtën e grave myslimane për të mbajtur hixhabin dhe për të hedhur poshtë të gjitha ligjet që e ndalojnë atë.

ÇFARË ËSHTË “FEMINIZMI ISLAM” DHE A KANË NEVOJË MYSLIMANËT PËR FEMINIZMIN?

Së pari, ka më shumë pika ku Islami dhe feminizmi ndahen se sa bashkohen. Parimet islame promovojnë nocionin e “drejtësisë hyjnore”, e jo të barazisë gjinore, të cilën e promovon feminizmi duke iu dhënë grave të drejta, me pa të drejtë, në kurriz të meshkujve. Duhet theksuar se Islami mbi të gjitha sigurohet që njerëzimi, pavarësisht gjinisë, të meritojë të drejtën që i takon pa u dënuar, as pa u privilegjuar me pa të drejtë vetëm për shkak të gjinisë.

Parimet islame promovojnë nocionin e “drejtësisë hyjnore”, e jo të barazisë gjinore, të cilën e promovon feminizmi duke iu dhënë grave të drejta, me pa të drejtë, në kurriz të meshkujve.

Edhe pse qëllimi i kësaj analize nuk është të përshkruaj gjendjen aktuale të myslimanëve dhe vendeve islame, dështimin e një komuniteti të tërë në mësimin e vlerave dhe parimeve islame, apo dhënia përparësisë së traditave dhe zakoneve vendase para parimeve islame. Qëllimi është vënia në pah e atyre parimeve islame, të cilat iu dhurojnë grave të drejtat që iu takojnë nga Zoti dhe që nuk kanë nevojë për ndonjë lëvizje reformiste për ta arrirë këtë. Ndërgjegjësimi i shumë grave myslimane sot, ndoshta për shkak të efektit të internetit për të përhapur informacion, për të arrirë më lehtësisht të dija fetare e zgjedhur dhe e kërkuar me përpjekje personale dhe jo me imponim nga të tjerët, ka bërë që shumë gra myslimane të ndërgjegjësohen, të kuptojnë dhe të artikulojnë më mirë të drejtat e tyre. Kjo lloj vale ndërgjegjësimi, fatkeqësisht është ngatërruar me ndikimin nga lëvizjet feministe. Nëse sot, gratë myslimane refuzojnë të bëjnë punët e shtëpisë, apo ta mbajnë rrogën e tyre për vete pa qenë të detyruara ta sjellin në shtëpi, nuk duhet ta akuzojmë ideologjinë feministe si fajtorë, por t'i kthehemi mësimave islame duke hulumtuar

më shumë për fenë tonë. Por, nga ana tjetër edhe vetë gratë myslimane nuk duhet të manipulohen nga ideologji të tilla, por t'i matin veprimet e tyre në përputhje me parimet islame. Nëse për shembull, për çështjen e punëve të shtëpisë, vendimi/hukmi i përgjithshëm nuk përcaktohet nga rolet gjinore, atëherë në këtë rast mësimet islame e lënë të lirë gruan dhe burrin të vendosin me mirëkuptim se kush do merret me disa punë, e kush me disa të tjera dhe kjo mund



të variojë nga kushtet dhe rrethanat përkatëse. Mirëpo, nëse dikush e mohon totalisht nevojën e kontributit të një mashkulli në punët e shtëpisë, atëherë kjo mund të përkthehet si një aplikim i partriakalizmit, duke lënë mënjanë parimet hyjnore. Nga tradita profetike, kuptojmë se vetë i Dërguari i Zotit, kalonte një pjesë të mirë të kohës në shtëpi, duke bërë punë, të cilat ishin të pranueshme deri diku nga kultura dhe mentaliteti vendas, si për shembull arnimi, përkujdesja për fëmijët, etj.. Gjithashtu, edhe në rastin kur vetë bija e tij, së bashku me bashkëshortin e saj, iu qasën atij duke iu ankuar për punët e rënda në shtëpi dhe lodhjen e madhe deri në atë gradë sa të merrnin në konsideratë angazhimin e një ndihmëse, tregon gjithashtu se barra e punëve të shtëpisë u kishte rënë të dyve. Edhe në rastet të ekspeditave gjatë natës të udhëheqësit Omer r.a., dalin në pah disa episode ku ai vetë, me ndihmën e gruas së tij filluan të gatuajnë apo të kryejnë shërbime të ngjashme, të cilat hyjnë në kategorinë e punëve të shtëpisë. E njëjta skenë na vjen në mënyrë indirekte kur vetë kalifi zbulon për një grua të moshuar, të verbër dhe të braktisur e cila dëshmon për një vizitor, Ebu Bekrin r.a., i cili përkujdeset për punët e shtëpisë si pastrimi dhe gatimi, nga e cila skenë deduktojmë se edhe meshkujt e kësaj periudhe kohore kanë qenë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të ushtruar kontributin në punët e shtëpisë.

Për t'iu përgjigjur pyetjes se nëse kanë apo jo nevojë myslimanët për feminizmin, ndoshta së pari duhet theksuar se duhen njohur mirë qoftë parimet islame qoftë ideologjia feministe. Përveçse duhen njohur mirë se ku ndahen dhe përputhen, duhet të ndërjegjësohemi mirë për këto dallime:

Ideologjia feministe ka në fokus gjininë dhe veçanërisht gruan, duke promovuar dëshirën e grave për më shumë të drejta, ndërsa Islami ka në fokus Zotin dhe vullnetin e Tij (irade).

Ideologjisë feministe i mungon autenciteti, pasi nuk ka një libër ku të mblidhen dhe të bien dakord të gjitha manifestet, platformat si dhe aktivistët feminist. Ndërsa Islami është një formë e strukturuar me një autoritet të plotfuqishëm (Zoti), një manifest (libër hyjnor, Kurani) dhe një legjislacion i mirë përcaktuar (Sheriati).

Po nëse biem dakord se Islami me feminizmin më shumë kontradiktohen se sa përputhen, atëherë çfarë është feminizmi islam? Feminizmi islam është një lloj lëvizje, e cila synon ri interpretim të parimeve islame nga këndvështrimi feminist, sipas logjikës se, meqenëse një pjesë e mirë e

Duhet sjell më në pah dhe promovuar akoma më shumë kontributi i grave në historinë islame dhe në teologjinë islame në përgjithësi.

haditheve janë transmetuar nga meshkuj, se një pjesë e mirë e dijetarëve dhe mendimtarëve islam janë meshkuj, atëherë si të tillë kanë bërë një interpretim të gjithë Islamit nga një këndvështrim maskilist dhe se lind nevoja për një interpretim më feminist. Kjo nuk do të thotë se duhet hedhur poshtë puna e të gjithë këtyre kontributorëve të teologjisë islame, por se duhet sjell më në pah dhe promovuar akoma më shumë kontributi i grave në historinë islame dhe në teologjinë islame në përgjithësi.

Për të arrirë këtë, duhen marrë parasysh se shumë nga këta dijetarët islam të mëdhenj, duke nisur nga sahabët dhe tabiinët kanë mësuar hadithe dhe fikh nga nënat e tyre, disa nga vetë gratë e Profetit, për shembull, shumë hadithe të transmetuara nga Aisheja, bashkëshortja e vetë të Dërguarit. Duhet festuar dhe promovuar momente kyçe në historinë islame kur gratë kanë ngritur zërin,

disa prej të cilave janë regjistruar edhe në Kuran. Për shembull në suren Muxhaadele (Kad'semiaAllahu) "Vërtet, e dëgjoi Allahu ankuesen e cila u ankua ...", (Muxhadele, 1), bashkëshortet, bijat, mbesat apo kushërirat e tij, të cilat në raste të ndryshme kanë ngritur zërin për të kërkuar hapësira faljesh në xhami, ligjërata të posaçme për to për çështje grash, angazhim në luftë për të fituar edhe ato sevape të barabarta, deri në konsultime se si duhet të veprojnë në situata të caktuara kur vetë duhej të merrte ndonjë vendim delikat, si për shembull, martesë përsëri pas humbjes së Hatixhes r.a., lirimi nga ihrami pas një nijeti për të bërë haxh dhe më pas në pamundësi për ta kryer atë etj..

Nga kjo mund të arrijmë në përfundimin se Islami është një sistem vlerash dhe parimesh ndërtuar mbi drejtësinë hyjnore, ku femra dhe mashkulli kanë të drejta meritore dhe zë të barabartë.

Burimet:

1. Braidotti, R. (2003). *Becoming woman: Or Sexual Difference Revisited. Theory, Culture & Society*, 20(3), 43–64. <https://doi.org/10.1177/02632764030203004>
2. Lovibond, S. (1989, December 1). *Feminism and Postmodernism. New Left Review*. <https://newleftreview.org/issues/i178/articles/sabina-lovibond-feminism-and-postmodernism>
3. Lovibond, S. (1994, October 1). *Feminism and the "Crisis of Rationality."* *New Left Review*. <https://newleftreview.org/issues/i207/articles/sabina-lovibond-feminism-and-the-crisis-of-rationality>
4. *White Feminism. (n.d.). Book by Koa Beck | Official Publisher Page | Simon & Schuster.*
5. Z. (2018, April 11). *Do Muslims Need a Feminist Theology?* Zara Faris.

Dallimet ndërmjet femrës dhe mashkullit

Mimoza Sinani

Të flasësh në shekullin e njëzetën për dallimet ndërmjet femrës dhe mashkullit tingëllon si ide absurde! Për disa, idetë e tilla tanimë janë vjetruar dhe kanë dalë jashtë mode. Në epokën e mesjetës, në periudhën e dominimit të burrave mbi gratë, ishte arritur në përfundimin se femra është gjini inferiore; se femra nuk është qenie e plotë njerëzore, se femra është një hallkë lidhëse mes kafshëve dhe njerëzve, se femra nuk e ka aftësinë për të jetuar një jetë të pavarur dhe të lirë, se ajo është e detyruar të jetojë nën patronazhin dhe kujdestarinë e mashkullit. Sot argumentohet se këto spekulime janë plotësisht të pabaza dhe e vërteta është pikërisht e kundërta, pra femra është gjini superiore, kurse mashkulli është gjini inferiore dhe e paplotë. Pra kohët e fundit, është bërë një kthesë e plotë dhe bëhen përpjekje për të provuar me 1001 argumente të ndryshme se mashkulli është i papërsosur, inferior dhe i pavlerë dhe se femra është e përsosur dhe superiore. Në librin “*Superioriteti natyror i grave*”, të shkruar nga Ashley Montague,¹ autori dëshiron të provojë se femra është më e përsosur sesa mashkulli. Ky libër, për sa i përket paraqitjes së rezultateve të zbulimeve të mjekësisë, të psikologjisë apo të statistikave sociale, është shumë i vlefshëm, por kur shkrimtari dëshiron të nxjerrë konkluzionet në mbështetje të teorisë së tij, ai shkon në ekstreme të pakuptimta. Ky autor e paraqet femrën si një specie superiore ndaj mashkullit, ndërsa veçoritë dalluese të mashkullit i paraqet si rezultat të faktorëve historikë dhe socialë dhe jo si rezultat të faktorëve natyrorë.

ORIGJINA E IDEVE

Çështja e dallimeve ndërmjet mashkullit dhe femrës nuk është shtruar për diskutim vetëm kohët e fundit. Kjo çështje është e vjetër të paktën dy mijë e pesëqind vjet. Ajo ishte diskutuar në të njëjtën formë në ‘Republikën’ e Platonit.²

Teoria e Platonit: Origjina e të gjitha ideve të reja që janë shtruar për shqyrtim në lidhje me femrën në shekullin e XX dhe XXI gjenden në mendimet e Platonit, që njihet edhe si babai i filozofisë. Platoni, në librin e pestë të ‘Republikës’ së tij, ka argumentuar në favor të kontrollit të shtetit mbi gratë dhe fëmijët, të privimit nga ana e shtetit të disa grave dhe burrave nga e drejta e tyre për t’u riprodhuar, dhe të caktimit nga ana e shtetit të së drejtës për t’u riprodhuar vetëm atyre që kanë cilësi posaçërisht të shkëlqyera dhe veçanërisht superiore. Ai më tej kishte nxitur në favor të dispozitës ligjore ku arsimi dhe edukimi i fëmijëve të bëhej jashtë ambientit familjar dhe në favor të lejitimit të riprodhimit vetëm gjatë disa viteve të caktuara të jetës së burrave dhe të grave, në moshën në të cilën ata do të ishin më vitalë dhe më energjikë. Platoni, pohon, me terma të qartë, se gratë dhe burrat zotërojnë aftësi të ngjashme, se gratë mund t’i kryejnë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë të cilat u janë ngarkuar burrave dhe se ato përfitojnë të gjitha të drejtat që gëzojnë burrat. Ai ishte i mendimit se edhe femrat duhet të stërviten ushtarakisht të njëjtën mënyrë si burrat. Platoni e pranon se gratë nga pikëpamja e fuqive fizike,

Natyra e aftësive të femrës dhe të mashkullit është e ndryshme dhe se funksionet të cilat ligji i krijimit i ka vendosur te secili prej tyre bashkë me të drejtat të cilat u janë caktuar atyre janë të ndryshme në shumë aspekte.

shpirtërore dhe mendore janë më të dobëta sesa meshkujt, pra ai e pranon dallimin ndërmjet grave dhe burrave për sa i përket sasisë, por jo edhe për sa i përket cilësisë së talenteve të tyre. Platoni e falënderon Zotin për të qenët e tij mashkull dhe jo femër.

Teoria e Aristotelit: Aristoteli, nxënësi i Platonit, në librin e tij 'Politika'³, shprehu idetë e tij në lidhje me dallimet ndërmjet grave dhe burrave dhe e kundërshtoi me forcë mësuën e tij, Platonin. Aristoteli mendonte se dallimi ndërmjet burrave dhe grave nuk është vetëm në sasinë e aftësive të tyre, por edhe në cilësi. Ai thoshte se natyra e aftësive të femrës dhe të mashkullit është e ndryshme dhe se funksionet të cilat ligji i krijimit i ka vendosur te secili prej tyre dhe të drejtat të cilat u janë caktuar atyre janë të ndryshme në shumë aspekte. Pikëpamjet e Aristotelit ia zunë vendin pikëpamjeve të Platonit në botën e lashtë dhe mendimtarët që erdhën pas tyre u dhanë përparësi pikëpamjeve të Aristotelit ndaj atyre të Platonit.

DALLIMET NDËRMJET GJINIVE NË DEDITËN E SHKENCËS BASHKËKOHORE

Në botën e lashtë, burrat dhe gratë vlerësoheshin thjesht mbi bazën se njëri ka një trup më të madh dhe tjetri më të vogël, njëri është më i ashpër dhe tjetri më delikat, njëri është më i lartë dhe tjetri më i shkurtër, njëri ka një zë më të fortë dhe tjetri më të butë. Mashkulli konsiderohej si simbol i intelektit dhe femra simbol i ndjenjave të butësisë dhe të dhembshurisë. Bota moderne nuk mbështetet thjesht mbi supozime dhe hamendje. Në deditën e zbulimeve dhe përparimeve moderne në shkencën e biologjisë, të fiziologjisë, të psikologjisë dhe të sociologjisë mes burrave dhe grave janë zbuluar dallime të shumta. Në to nuk ka trillime apo spekulime, por fakte të pakundërshtueshme dhe të vërteta shkencore. Këto dallime janë bërë më të qarta dhe janë dokumentuar më mirë dhe është zbuluar që ky dallim nuk është një ndryshim i thjeshtë në organet përbërëse, por se ai ka efekt në strukturën e tyre themelore fizike dhe shpirtërore. Është zbuluar se bota e femrave dhe e meshkujve ndryshon në shumë aspekte dhe se këto dallimeve janë aq të qarta dhe të dukshme sa që është e pamundur që të mohohen.

Dallimet fizike: Mashkulli, zakonisht, është më shtatlartë, ndërsa femra më e shkurtër; mashkulli është më i ashpër, ndërsa femra më e delikate; mashkulli ka një zë më të fortë dhe ton më të ashpër, ndërsa femra ka një të folur më të butë dhe një zë më të ëmbël; zhvillimi i trupit të një femre bëhet më shpejt se sa zhvillimi i trupit të mashkullit, përgjithësisht fetusit i një vajze zhvillohet më shpejt se ai i një djali. Zhvillimi i muskujve dhe forca e trupit të një mashkulli është më e madhe se ajo e një femre. Fuqia rezistuese e një femre ndaj shumë sëmundjeve është më e madhe sesa e një mashkulli. Femra e arrin moshën e pjekurisë seksuale më herët se mashkulli dhe bëhet joproductive më shpejt sa i përket aftësisë riprodhuese. Një femër fillon të flasë më herët se sa një mashkull. Truri normal i një mashkulli është më i madh se sa truri normal i një femre, por në krahasim me madhësinë



proporcionale të organeve të tyre, truri i një femre është më i madh se ai i një mashkulli. Mushkëritë e një mashkulli kanë kapacitet për të thithur më shumë ajër se mushkëritë e një femre. Rrahja e zemrës së një femre është më e shpejtë sesa ajo e mashkullit.⁴ Në pjesën e katërt të librit 'The pleasures of Philosophy', nën titullin "Dashuria", Will Durant shkruan: "Në moshën e pubertetit, dashuria këndon qartë këngën e saj të parë... Mbirja e menjëhershme e qimeve së bashku me trashjen e zërit është në mesin e 'tipareve seksuale sekondare' që i shfaqen mashkullit në moshën e pjekurisë, ndërsa natyra e lulëzimit të vajzës sjell përvijime të buta që joshin syrin, komblik të zgjeruar që lehtëson lindjen dhe gjoks të fryrë që shërben për të ushqyer fëmijën." "...Kur vjen moshë e pubertetit, qelizat riprodhuese fillojnë të prodhojnë jo thjesht vezët dhe spermatozoidet, por edhe disa 'hormone', të cilat kalojnë në gjak dhe shkaktajnë një transformim fizik dhe psikik."⁵

Dallimet psikologjike: Mashkulli ka një preferencë më të madhe për ushtrimet dhe punët fizike, sesa femra. Ndjenjat e mashkullit janë sfiduese dhe luftarake, ndërsa ndjenjat e femrës janë paqësore. Mashkulli është më agresiv, ndërsa femra është më e qetë dhe më e butë. Një femër përmbahet nga marrja e veprimeve drastike, dhe kjo është arsyeja për numrin më të vogël të vetëvrasjeve të gratë sesa të burrat. "Natyra e femrës është që të kërkojë strehë në vend të luftës dhe, në disa specie, femrat janë pothuajse krejtësisht pa instinktin e qëndrimit luftarak. Kur ajo lufton drejtpërsëdrejti, ajo lufton për fëmijët e saj."⁶ Ndjesitë e femrës ngjallen më shpejt se sa ato të një mashkulli. Femra reagon më shpejt, ndërsa mashkulli është më gjakftohtë. Femra priret në mënyrë të natyrshme më tepër se një mashkull drejt dekorimit, stolisjes, zbukurimit, hijeshimit dhe veshjes. Ndjenjat e femrës janë më të paqëndrueshme sesa ato të një mashkulli. Femra është më e kujdesshme, më e turpshme dhe

më formale sesa mashkulli. Femra është më e lidhur me familjen dhe vëmendja e saj është e drejtuar në mënyrë të nënvetëdijshme më shumë sesa mashkulli drejt rëndësisë së shtëpisë. Në aktivitetet që bazohen mbi arsyetimin, si dhe në problemet e thella intelektuale, femra nuk mund të barazohet me mashkullin, por në letërsi, pikturë dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me estetikën, ajo nuk mbetet pas mashkullit. Mashkulli ka më shumë aftësi për të ruajtur një sekret sesa femra.⁷

Dallimet në ndjenjat ndaj njëri-tjetrit: Mashkulli dëshiron ta marrë në zotërim femrën dhe të ketë pushtet ndaj saj, ndërsa femra dëshiron të pushtojë zemrën e mashkullit dhe të mbizotërojë tek ai përmes zemrës së tij. Mashkulli dëshiron ta zotërojë femrën përmes kokës së saj, ndërsa femra dëshiron të ndikojë te mashkulli përmes zemrës së tij. Femra është në gjendje t'i kontrollojë shtytjet e saj seksuale më shumë sesa mashkulli. Femra dëshiron të shohë trimërinë dhe guximin te mashkulli, ndërsa mashkulli dëshiron që të shohë hijeshinë dhe bukurinë te femra.

SYNIMI I LIGJIT TË KRIJIMIT

Disa njerëz insistojnë se dallimi ndërmjet burrave dhe grave në përbërjen e tyre fizike dhe psikike pasqyrohet në mënyrë të tillë sikur femrat të jenë të papërsosura, ndërsa meshkujt të jenë relativisht të përsosur. Kurdo që shqyrtohet ndryshimi i karakteristikave dhe i natyrës së lindur të grave dhe të burrave, një pjesë e njerëzve e interpretojnë këtë si mangësi të femrës dhe përsosmëri të mashkullit dhe si diçka që kërkon një sërë përfitimesh për mashkullin dhe një sërë privimesh për femrën, duke harruar se nuk është duke u shqyrtuar mangësia dhe përsosmëria. Skema e krijimit nuk ka synuar të krijojë njërin të përsosur dhe tjetrin të papërsosur. Situata është krejtësisht e kundërta. Indiferenca ndaj prirjeve natyrore dhe të bashkëlindura të femrës ka shkaktuar shkeljen e të drejtave të saj. Menstruacionet e saj mujore, papërshtatshmëria e saj gjatë shtatzënisë, vështirësitë e punës dhe rritjes së fëmijëve, të gjitha këto e vendosin femrën në një situatë ku ajo të jetë nën mbrojtjen e mashkullit, të ketë më pak përgjegjësi dhe më shumë të drejta. Kjo gjë nuk është e kufizuar vetëm për qeniet njerëzore: të gjitha kafshët që jetojnë në çifte sillen në këtë mënyrë. Në të gjitha këto lloje specimesh, mashkulli instinktivisht ngrihet për të mbrojtur partneren e tij femër. Megjithatë, këto dallime në asnjë mënyrë, nuk ndikojnë në çështjen nëse femra apo mashkulli është gjini superiore dhe nëse gjinia tjetër është më e ulët, inferiore apo e papërsosur. Ligji i krijimit i solli këto ndryshime në mënyrë që ta bëjë marrëdhënien e mashkullit dhe femrës brenda familjes më të fortë dhe themelin e unitetit të tyre më të sigurt. Ligji i krijimit i planifikoi këto dallime në mënyrë që të paracaktojë të drejtat dhe detyrat e grave dhe ato të burrave. Në fakt, dallimet ndërmjet burrave dhe grave nuk janë çështje e papërsosurisë apo e përsosurisë. Qëllimi i ligjit të krijimit është që këto dallime të jenë burim i një marrëdhënie më të mirë midis grave dhe burrave, të cilët pa dyshim janë krijuar për të jetuar së bashku.

KRYEVEPRA E KRIJIMIT

Mashkulli dhe femra janë të barabartë në të qenët e tyre njerëz, por ata janë qenie me dy lloje karakteristikash dhe dy lloje psikologjish të ndryshme nga njëri-tjetri. Ky ndryshim nuk është rezultat i faktorëve gjeografikë, historikë apo socialë, por është skicuar në vetë planin e krijimit dhe çdo hap që ndërmerret kundër natyrës dhe natyrshmërisë, detyrohet të përballet me pasoja të padëshirueshme. Ligji i krijimit e ka krijuar dhe ndërtuar mashkullin dhe femrën sipas një modeli të tillë që ata të lidhen dhe ta kërkojnë njëri-tjetrin. Secili prej tyre dëshiron mirëqenien dhe komoditetin e tjetrit dhe është i lumtur që të vetëpërmbahet dhe sakrifikojë për hir të tjetrit. Të dyja gjinitë janë bërë me dëshirën për të jetuar së bashku dhe, për ta bërë planin krejtësisht praktik, mes tyre janë vendosur dallime të veçanta fizike dhe mendore, në mënyrë që trupat dhe shpirtat e tyre të mund të bashkohen më mirë. Këto dallime janë burim i tërheqjes reciproke dhe ato janë dizajnuar në mënyrë të tillë që mashkulli dhe femra të ndiejnë dashuri për njëri-tjetrin dhe jo thjesht pasion. Lidhja e dashurisë e cila përbën bazën e unitetit të mashkullit dhe të femrës është më e madhe sesa pasioni. Kurani i shenjtë e përmend këtë me emrin “meveddeh” (dashuri) dhe “rahmet” (mëshirë). *“Dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”* (Er Rrum, 21).

Nëse kihet parasysh prirja e lindur natyrore e të dy gjinive dhe nëse mbahet në mendje barazia e tyre në të qenët e tyre qenie njerëzore dhe në të drejtat e përbashkëta të njerëzimit, atëherë femra do të gjendet në një pozitë shumë të favorshme. Femra dhe mashkulli janë dy yje në dy orbita të ndryshme. *“As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën e as nata nuk mund t’ia kalojë ditës; të gjitha lundrojnë në orbitat e veta.”* (Ja Sin, 40).

Ekziston një pajtim i plotë mes urdhrave të Kuranit dhe ligjeve të natyrës. Këta dy libra madhështorë të Zotit, njëri i përpiluar dhe tjetri i krijuar, përputhen me njëri-tjetrin. Kushti themelor për lumturinë e mashkullit dhe të femrës është që secili prej të dy gjinive të vazhdojë të lëvizë në orbitën e vet. Liria dhe barazia do të ishte në dobinë e tyre për sa kohë që asnjëri prej tyre nuk do të largohej nga orbita dhe drejtimi i tij apo i saj natyror.

- 1 Ashley Montagu, *The Natural Superiority of Women*, 5th Edition, (New York: AltaMira Press, July 1999).
- 2 Plato, *The Republic*, translated by Benjamin Jowett, (Digireads.com Publishing, 2008).
- 3 Aristotle, *Politics*, translated by Benjamin Jowett, (Batoche Books, Kitchener, 1999).
- 4 Murtaza Mutahhari, *The rights of women in Islam*, (Tehran, Iran: World Organization for Islamic Services, 1981), 104.
- 5 Will Durant, *The Pleasures of Philosophy: A Survey of Human Life and Destiny*, (New York: Simon and Schuster, 1953), 107-108.
- 6 Will Durant, *The Pleasures of Philosophy: A Survey of Human Life and Destiny*, (New York: Simon and Schuster, 1953), 119.
- 7 Murtaza Mutahhari, *The rights of women in Islam*, (Tehran, Iran: World Organization for Islamic Services, 1981), 104.

Imam El Merginani (530h-593h)

JETA DHE VEPRA E JURISTIT TË MIRËNJOHUR HANEFIT

Blerton Bahtiri

Libri i Imam Marginaniut r.a. është një nga librat e famshëm të fushës së fikhut të shkollës juridike hanefite. Është mësuar shumë, sidomos gjatë periudhës osmane. Madje kishte nga ata që e mësonin përmendsh.

EMRI, LINDJA DHE PREJARDHJA

Emri i plotë i Imam Merginaniut r.a., Enjërit prej dijetarëve të rëndësishëm të fikhut hanefi është Ebu'l Hasan Burhanuddin Ali bin Ebi Bekr bin Abdilxhelil el Ferginani el Merginani. Lidhur me vitin e lindjes, Imam Zirikliu thotë se ai ka lindur në vitin 530/1117. Ndërsa Imam Lekneviu në shënimin e tij thotë se ai ka lindur më 8 të muajit rexheb, të vitit 511. Por, data të cilën e ka potencuar Imam Lekneviu është më afër saktësisë. Sepse nëse shikojmë vdekjen e mësuesve të Imam Merginaniut r.a., shohim se mësuesit e tij kanë vdekur në vitin 537 (Imam Nesefiu) dhe në vitin 536 (Sadru'sh-Shehid).

Imam Merginani r.a. ka lindur në provincën Ferganë.¹ Fergana ishte një nga qendrat shkencore të asaj kohe. Nëse flasim për vendbanimin e tij, ka mendime të ndryshme. Disa thonë se ka lindur në fshatin Rishtan. Imam Lekneviu, në hyrje të librit të tij e përmend Imam Merginaniut r.a. duke potencuar se ai e ka prejardhjen nga Ebu Bekri r.a..

MËSUESIT E TIJ

Kur vështrojmë kohën e Imam Merginaniut r.a. dhe nivelin e dijetarëve në rajon, shohim se Imam Merginani r.a. i la pas dijetarët e tjerë dhe kuptojmë se ai ishte shumë përpara. Ai ishte një nga studiuesit kryesor të periudhës në fushën e shkencës dhe kulturës. Mori mësim nga shumë mësues, ku edhe arriti rezultate të theksuara. Prandaj, në vazhdim do të flasim shkurtimisht për mësuesit e Imam Merginaniut r.a..

Sadrushehid (v.539/1141) - Ai është një nga dijetarët kryesor të shkollës juridike hanefite. Ai njihet me pseudonimin "Sadru'sh-shehid" sepse ra dëshmor në betejën e Katvanit. Dihet se Sadrushehidi ishte veçanërisht superior në lëmin e fikhut. Madje, sipas shkrimeve, ai ka mbizotëruar gjithmonë në debate. Ka edhe shumë vepra, prej tyre: "Sherhu Edebi'l-Kadi", "Sherhu Kitab'i'n-Nafakat", e që janë disa nga veprat e tij kryesore.²

Ali el Isbixhabi (v.135/1140) - Mbiemri i këtij dijetari ndërlidhet me qytetin e tij. Ai ishte një gjykatës nga dijetarët e fikhut hanefi. Siç e dimë, Isbixhabi ka komentuar librat e Imam Muhamedit r.a..³

Kivamuddin Ahmed b. Abdirrashid el Buhari - Flitet se ai ishte një nga mësuesit e Imam Merginaniut. Nuk ka shumë njohuri për jetën e tij.⁴

Ebu Hafs Nexhmuddin en Nesafi (v. 537/1142) - Atij iu dhanë pseudonimet "Nexhmuddin" dhe "Myfti Eth-Thekalejn" për shkak të njohurive dhe fuqisë së tij të thellë.⁵

Osman b. Ali el Bikedî (Bajkandi) (v. 552/1157) - Ai është një nga nxënësit e Imam Serahsiut. Nuk ka shumë njohuri për jetën e tij.⁶

Ebu Hars Omer b. Ali ez Zemderamisi - Nuk ka shumë të dhëna për këtë dijetar.⁷

ZHVILLIMI I MENDIMEVE TË TIJ

Libri "El Hidaje" është komentimi i librit "Bidajetu'l-Mubtedi". Është një vepër që është mbështetur shumë në veprën "Xhamiu's-Sagir" të Imam Muhamed el Shejbanit dhe nga "Muhtasar el-Kuduri" i Imam Kudurit r.a..⁸

Libri i Imam Marginaniut r.a. është një nga librat e famshëm të fushës së fikhut të shkollës juridike hanefite. Është mësuar shumë, sidomos gjatë periudhës osmane. Madje kishte nga ata që e mësonin përmendsh. Në Azinë Qendrore, nga ana tjetër, ato jo vetëm që mësohej në medrese, por edhe mësohej përmendsh, dhe mësuesit nuk e lanë kurrë që ky libër t'u binte nga duart.⁹ Djali i Imam Marginanit r.a., Imam Imaduddini, shkroi një artikull për "Hidaje" dhe tha: "El-Hidaje është një libër që udhëzon ata që e kujtojnë atë dhe largon verbërinë. Pra, o i urtë, kapu dhe mbaje, mos e lësho kurrë. Kushdo që e arrin dhe e trajton atë, ka arritur ambiciet më të larta."¹⁰ Në literaturë, përmendet se Imam Merginani r.a. e ka shkruar "Hidajen" në një periudhë kohore prej trembëdhjetë vjetësh.¹¹

Historia e shkrimit të "Hidajes" tregohet nga vetë Imam Merginani r.a. si në vijim: Në vitet e tij të hershme, gjatë mësimit të fikhut, Imam Merginani r.a. mendoi se çfarë lloj libri do të shkruante për fikhun. Qëllimi i tij ishte të jepte informacion pa e lodhur lexuesin. Disa vite më vonë, ai pa Muhtasarin e Imam Kuduriut r.a. dhe tha: "Sa i bukur dhe sa konciz (muhtasar) është ky libër." Pas pak, ai pa që të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, u inkurajuan të mësonin përmendësh librin "Xhamiu's-Sagir" dhe vendosi t'i bashkonte të dyja. Pastaj si pikënisje shkroi librin "Bidajetu'l-Mubtedi". Pastaj e shkroi me emrin "Kifajetu'l-Muntehi", domethënë mjafton për ata që arrijnë në fund. Pasi Imam Merginani r.a. e mbaroi këtë libër, e pa se ishte shumë i gjatë dhe vendosi të shkruante një libër të shkurtër dhe të përmbledhur. Për shkak se libri është shumë i gjatë, ai mori një vendim të tillë për shkak të shqetësimit se studentët nuk do ta lexonin dhe iu drejtua një komenti tjetër të quajtur "El Hidaje". Në këtë, ai mori

transmetimet kryesore dhe ixhtihadet e shëndosha dhe iu shmang të zgjaturit duke lënë teprimet në çdo temë.¹²

NXËNËSIT E TIJ

Imam Merginani r.a. nuk kishte përparësi vetëm në fushën e fikhut. Ai gjithmonë ishte i pari si në fushën e fikhut, të logjikës apo të shkencave të tjera islame. Imam Merginani r.a. mësoi edhe shumë studentë që të bëheshin sikur ai. Ne do të përpiqemi t'i përmendim shkurtimisht këta studentë.

Shemsu'l Eimme el Kerderi (v. 642/1244) - Ai ishte një dijetar i njohur me fetvatë e tij, gjithashtu ishte njëri nga juristët kryesor të kohës së tij. Një nga veprat e tij më të rëndësishme është "Fetava'l-Kerderi".¹³

Zernugji - Ai njihet me pseudonimin Burhanu'l-Islam. Ai është gjithashtu i njohur për veprën e tij "Ta'limul muteal-lim" dhe "Tarika't-Teal-lum". Kjo vepër u mësohej vetëm nxënësve që qëndronin në pallat si tekst mësimor.¹⁴

Mahmud b. Husein el-Ustursheni (v. 632/1234) - Ai e mori mbiemrin Usturshen ose Ushrushen, ngaqë kishte lindur në rajonin Ushrushene. Ai e rregulloi librin "Multeka" të Imam Semerkandit sipas temave të tij.¹⁵

Nizamuddin Umer (v. 600/1203) - Pyetjet të cilat ndërlidheshin me fushën e jurisprudencës islame, fikhut, i bëheshin gjithmonë këtij dijetari në rajonin ku ai jetonte. Ekziston edhe një vepër e quajtur "Xhevahiru'l-Fikh" në lidhje me këtë.¹⁶

Ebu'l-Feth Zejnuddin Abdurrahman b Ebi Bekir Imaduddin (v. 670/1271) - Ai ka një vepër të quajtur "Fusulu'l-Ahkam fi Usuli'l-Ahkam", e cila u botua në vitin 1872 në Indi. Kjo vepër gjendet edhe me shkrim dore në bibliotekën e muzeut të Pallatit Topkapi.



LIBRAT E TIJ

1. “Bidajet el-Mubtedi” - Ai në këtë libër i mbledhi çështjet juridike islame që ishin theksuar në “Xhamiu’s-Sagir” të Imam Muhamedit dhe Muhtesar të “Imam Kudurit” r.a..

2. “El Hidaje” - Është koment i librit “Bidajetu’l-Mubtedi” dhe është një nga tekstet më të njohura dhe më të besuara të shkollës juridike hanefite. Gjatë shkrimit të kësaj veprë, Imam Merginani r.a. mori si shembull veprën e “Xhamiu’s-Sagir” të Imam Muhamedit r.a.. Dallimi është se në librin e Imam Muhamedit r.a. ka dyzet kapituj, ndërsa në “Hidaje” ka pesëdhjetë e gjashtë kapituj. Imam Merginani r.a. përdori fjalë të veçanta në librin e tij “El Hidaje”.

3. “Muhtarat (muhtar)u’n-Nevazil” - Pjesa e veprës mbi fikhun rreth adhurimit u botua nga Mahmut Muhammed İsmail si tezë masteri në Medine (Universiteti Islamik – Fakulteti i Sheriatit).

4. “Et-Texhnis ve’l Mezid fi’l Fetva” - Dihet se është libër voluminoz. Ky libër është ndër librat tipit të kohës.

5. “Kitab fi’l-Feraiz”

6. “Kitabu’l-Haxh” - Autori ka mbledhur përgjigjet e pyetjeve rreth haxhit në këtë libër.

7. “Kifajetu’l-Muntehi” - Autori hoqi dorë nga përfundimi i veprës së tij, sepse kjo vepër, të cilën e filloi si komentim i “Bidajetu’l-Mubtedi”, arriti një vëllim prej rreth tetëdhjetë sosh dhe nuk ishte shumë i shpërndarë, dhe shkroi një koment më të shkurtër për “El Hidaje”.

PERSONALITETI SHKENCOR

Dihet se Imam Merginani r.a. ishte një nga juristët e Transoksisë. Në këtë rajon, Imam Merginani r.a. kishte mundësinë të arrinte gjithçka. Siç dihet, Imam Merginani r.a. ishte një nga juristët më të respektuar të shkollës juridike hanefite të asaj periudhe. Ai ishte gjithashtu i njohur për devotshmërinë e tij.¹⁷ Nëse shikojmë librat tanë klasikë, vërejmë se librit të Merginanit i japin një vlerësim të lartë. Arsyeja për këtë është se ai ka marrë mësim nga shumë mësues. Imam Merginani r.a. shkroi shumë vepra me njohuritë e tij, ku më vonë shumë dijetarë të medhebit hanefi mësuan nga veprat e këtij imami.

Dijetarët e numëruan Imam Merginanin r.a. nga shtresa (tabaka) e pestë. Me fjalë të tjera, sahabët i numëronin si “preferencë”. Imam Lekneviu në librin e tij dhe një dijetar i quajtur “El Gassani”, i cili kontribuoi në këtë libër, e llogariti

Shumë burime
pajtohen se
Imam
Merginani r.a.,
ndërroi jetë
më 593/1197.
Imam
Lekneviu
potençoi se
Imam
Merginani r.a.
u varros në
Semerkand.

Imam Merginanin r.a. nga shtresa (tabaka) e dytë, përkatësisht shtresa e muxhtehidit, për shkak të studimeve të tij të suksesshme. Imam Merginani r.a. pati rastin të takohej me dijetarë të ndryshëm, sepse bëri shumë ekspedita.¹⁸

VDEKJA

Shumë burime pajtohen se Imam Merginani r.a., ndërroi jetë më 593/1197. Imam Lekneviu potençoi se Imam Merginani r.a. u varros në Semerkand. Imam Merginani r.a. donte t’i jepte fund armiqësisë midis ushtrisë së Xhengiz Khanit dhe popullit të Buharasë dhe ata më në fund vendosën të bënin paqe. Megjithatë, disa nga banorët e Buharasë e prishën këtë paqe duke kundërshtuar një pjesë të marrëveshjes së paqes. Meqenëse Xhengiz Khan ishte gjithashtu një vrasës, ai dogji shume shënime dhe masakroi shumë njerëz. Në burime përmendet se në atë luftë ra dëshmor edhe imam Merginani r.a. Varri i Imam Merginanit r.a. është në Semerkand. Sipas disa burimeve, thuhet se Imam Merginani r.a. është varrosur në vendin e quajtur “Muhammedijun” në varrezat Jakredize të Semerkandit.

1 Ferganë është qytet në Uzbekistanin e sotëm.

2 Ahmet Özel, ‘Sadrişşehid’, TDV İslam Ansiklopedisi, TDV Yayınları, İstanbul 2008, vëll. 35, fq. 425; Koca, ‘Merğînânî c. 29, s. 182.

3 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 348; Koca, ‘Merğînânî’ vëll. 29, fq. 182.

4 Koca, ‘Merğînânî’ vëll. 29, fq. 182; Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 348.

5 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 348; Koca, ‘Merğînânî’ vëll. 29, fq. 182.

6 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 348.

7 Mehmet Karataş, ‘Muhtesarla el-Hidaye’nin Konu ve Metot Bakımından Mukayesesi’, (Yüksek Lisans Tezi, Erciyes Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Kayseri 1995), fq. 16

8 Zaylabidin Acimamatov, ‘Ebu Hanife ve Fergana Vadisindeki Etkisi’, fq. 121.

9 Burahanüddin Ebu’l-Hasan Ali b. Ebu Bekir Merginani, *el-Hidaye*, Ahmet Meylani (çev.), Kahraman Yayınları, İstanbul 2015, vëll. 1, fq. 131.

10 Zaylabidin Acimamatov, ‘Ebu Hanife ve Fergana Vadisindeki Etkisi’, fq. 121.

11 Faruk Beşer, *Fıkhi Meseleler*, fq. 131.

12 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 349; Ahmet Özel, ‘Kerderi’, TDV Ansiklopedisi, TDV Yayınları, Ankara 2002, vëll. 25, fq. 276.

13 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 349; Ahmet Özel, ‘Kerderi’, TDV Ansiklopedisi, TDV Yayınları, Ankara 2002, vëll. 25, fq. 276.

14 Mehmet Faruk Bayraktar, ‘Zernûci’, TDV İslam Ansiklopedisi, TDV Yayınları, İstanbul 2013, vëll. 44, fq. 294-295; Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 349.

15 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 349.

16 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, s. 350.

17 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 345.

18 Köse, ‘Ferganalı Bir Hukukçu Merğînânî...’, fq. 346.

Përpyjekja për demokratizim të Turqisë nëpërmes teksteve shkollore në Perandorinë Osmane (2)

(PORTRETIZIMI I SHQIPTARËVE NË TEKSTET SHKOLLORE OSMANE)

Hasan Bello

Në tekstet e historisë gjatë periudhës së mëvonshme osmane shpaloseshin përpjekjet e bëra për demokratizimin e Perandorisë që nga koha e Tanzimatit; theksohej kontributi i “Osmanëve të Rinj” dhe i përfaqësuesve më të njohur të kësaj lëvizjeje, si: Fazëll Mustafa Pasha, Zija Pasha, Shinasiu, Namik Kemal-i, Ali Suavi-u etj.. Shpallja e Kushtetutës dhe mbledhja e parlamentit të parë osman në vitin 1876-1877 konsideroheshin si data të rëndësishme historike, ndërsa shfuqizimi i tyre si fatkeqësi. Një vend po aq të rëndësishëm zinin edhe përpjekjet e xhonturqve përballë regjimit despotik të Abdylhamidit II, aktiviteti i tyre politik brenda dhe jashtë vendit e sidomos Revolucioni i vitit 1908.¹



Në këtë periudhë, e cila përkon me lindjen dhe zhvillimin e nacionalizmit turk kemi një shtim të temave mbi rrënjët historike të këtij popullit. Koncepte të tilla nacionaliste si: “ekonomia kombëtare”, “letërsia kombëtare”, “edukata kombëtare” filluan të artikuloreshin haptazi e të zinin vend çdo ditë e më shumë në të gjitha tekstet e shkollave osmane. Në funksion të kultivimit të kësaj fryme, në tekste u vendosën copëza leximi letrar me anën e së cilave kultivohej ndjenja e sakrificës për atdheun, interesin kombëtar dhe dashuria për kombin.² Bindja ndaj sulltanit, tani kushtëzohej me faktin se ai duhej të ishte simpatizant i Kushtetutës dhe respektues i detyrimeve që buronin prej saj.

Në kuadër të politikës së osmanizimit, në tekstet shkollore propagandohej me të madhe se të gjithë ata që jetonin nën flamurin e perandorisë konsideroheshin si pjesë të kombit osman. Ky i fundit përbëhej nga turqit, arabët, shqiptarët, grekët, hebrenjtë, kurdët, bullgarët etj.. Anëtarët e këtij kombi quheshin osmanë dhe se gjuha e tyre zyrtare ishte osmanishtja. Prandaj, sipas tyre, të gjithë fëmijët ishin të detyruar ta mësonin këtë gjuhë.³

Një anë pozitive e kësaj politike ishte fakti se partia “Bashkim dhe Përparim”, e cila synonte konsolidimin e unitetit të brendshëm dhe rritjen e kohezionit social, e kundërshtonte njësoj si ndarjen e racave ashtu edhe diskriminimin fetar. Në tekste

Në kuadër të politikës së osmanizimit, në tekstet shkollore propagandohej me të madhe se të gjithë ata që jetonin nën flamurin e perandorisë konsideroheshin si pjesë të kombit osman. Ky i fundit përbëhej nga turqit, arabët, shqiptarët, grekët, hebrenjtë, kurdët, bullgarët etj..


propagandohej se pas shpalljes së Kushtetutës ndarjet ishin zhdukur dhe se të gjithë nënshtetasit osmanë, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike dhe fetare, ishin të barabartë. Myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë ishin të obliguar njësoj që të sakrifikonin për atdheun e tyre. Kombi osman konsiderohej si një komb me moral të lartë, brenda të cilit kishte pasur dhe kishte personalitete që duheshin marrë shembull, jo vetëm nga myslimanët, por edhe nga të krishterët. Osmanizmi nuk i përkiste vetëm myslimanëve. Çdo kush që jetonte nën hijen e flamurit perandorak dhe që i bindej ligjeve të shtetit, quhej ose mund të bëhej osman.⁴ Në tekste propagandohej vëllazërimi i të gjithë elementeve si vullnet politik. Për ta ilustruar këtë po citojmë një pjesëz leximi nga teksti i shkollave fillore “Detyrat qytetare” (“*Vezaif-i Medeniye*”), në të cilin përshkruhet një stërvitje e improvizuar ushtarake ku merrnin pjesë fëmijë me përbërje të ndryshme fetare, myslimanë dhe të krishterë, të cilëve komandanti u drejtohet me fjalët: “Tani nuk ka më ndarje dhe përçarje. Të gjithë jemi osmanë, të gjithë jemi bijtë e këtij atdheu, të gjithë jemi për përparimin e tij. Për t’i shërbyer atdheut që të gjithë do bëhemi

“Pabesia” e Evropës së krishterë dhe dimensionit panortodoks i Luftërave Ballkanike bëri që vëllazërimit midis elementeve të ndryshëm fetarë brenda perandorisë t’i jepej fund.

ushtarë. Artin ushtarak duhet ta mësojmë që tani, që në të ardhmen të mos hasim vështirësi e të bëhemi ushtarë të mirë. Ushtrisë osmane duhet t’ia zbardhim faqen edhe një kat më tepër. Hajdeni shokë, të vazhdojmë stërvitjen në emër të osmanizmit dhe atdheut!”⁵

Si ideologji, osmanizmi vazhdoi të propagandohej deri përfundim të Luftërave Ballkanike, rezultati tragjik i të cilave bëri që vendin e tij ta zinte nacionalizmi turk (turqizmi). Humbja e këtyre luftërave u shoqërua me humbjen territoreve evropiane të Perandorisë Osmane, duke shkaktuar një zhgënjim të madh të xhonturqit. Sipas tyre, Evropa nuk e kishte mbajtur fjalën e dhënë se sido që të ishte përfundimi i tyre nuk do të kishte ndryshime të hartës së shtetit osman. Kjo shkaktoi një skepticizëm të përgjithshëm tek elita drejtuese lidhur me perspektivën dhe unitetin që mund të sillte tani e tutje osmanizmi. Pas humbjes së pjesës më të madhe të Rumelisë, e vetmja shpresë për ta mbeti turqizmi.

Në qoftë se më parë osmanizmi e refuzonte ndarjen dhe mbivendosjen e racave, ideologjia e re tani filloi të ndërtohej mbi virtytet superiore të kombit turk. “Pabesia” e Evropës së krishterë dhe dimensionit panortodoks i



Luftërave Ballkanike bëri që vëllazërimin midis elementeve të ndryshëm fetarë brenda perandorisë t'i jepej fund. Në tekstet shkollore osmane tani filloi të mbizotëronte ligjërimi i luftës midis "kryqit" dhe "gjysmëhënës". Pothuajse në të gjitha librat u vendosën shkrime dhe vjersha të Ziya Gökalp-it (Zija Gokalpit)*,⁶ i cili i bënte thirrje rinisë osmane të kishite kujdes nga çdokush që s'ishte i kombësisë turke.⁷ E vetmja gjë e përbashkët dhe që kishte njëfarë ngjashmërie me osmanizmin e propaganduar më parë tani ishte fakti se nacionalizmi turk mbarte një lloj identiteti islamik.

Krahasuar me tekstet shkollore të periudhës së Abdylhamidit II, në të cilat superioriteti i qytetërimit evropian në fushën e shkencës dhe teknologjisë pranohej hapur, por që nga ana tjetër bëhej thirrje për një lloj selektiviteti që të mos kopjoheshin traditat dhe veshjet, në tekstet shkollore të pas Revolucionit Xhonturk, shoqërisë osmane i sugjerohej që Perëndimi të merrej si model pa rezerva.

SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT NË TEKSTET SHKOLLORE TË PERANDORISË OSMANE

Në tekstet shkollore osmane nuk mund flitej hapur mbi racat dhe kombet. Por, kishte raste kur në kuadër të trajtimit të aspekteve të veçanta me karakter gjeografik përshkruheshin edhe detaje me interes për kombin tonë. Kështu, në tekstin "Gjeografia osmane" ("Coğrafya-yı Osmani") në të cilin trajtoheshin karakteristikat e disa krahinave dhe popujve të perandorisë, si shembull i mikpritjes dhe bujarisë merrej populli shqiptar. Mungesën e bujtinave (haneve) në qytetet shqiptare, autori e shpjegonte me faktin se te ky popull kjo traditë zinte një vend të rëndësishëm. Sipas tij, çdokush që udhëtonte në Shqipëri dhe ngelte në mes të rrugës, qoftë ky mysliman ose i krishterë, nëse trokiste në derën e shqiptarit bëhej mik në shtëpinë e tij. Bujtësi ishte i detyruar që t'i siguronte ushqim për aq ditë sa ai do të qëndronte.⁸

Në tekstin e parë shkollor të historisë osmane "Përmbledhje e Historisë Osmane" ("Fezleke-i Tarih-i Osmani") që u shkrua nga Ahmet Vefik Pasha* në vitin 1869, në kapitullin e nëntë ku autori trajton periudhën e Mehmed Fatihut II, përshkruan shkurtimisht edhe ekspansionin e ushtrisë osmane në territoret shqiptare,⁹ qëndresën njëzetepesëvjeçare të Skënderbeut në malet e Shqipërisë¹⁰ dhe rrethimin e Shkodrës.¹¹

Një rëndësi më vete në këtë tekst ka edhe fakti, se në kapitullin e gjashtëmbëdhjetë ku autori trajton ndarjen e vjetër të Perandorisë Osmane në vilajete, Shqipëria

Tek elita drejtuese politike dhe intelektuale e Perandorisë Osmane, Shqipëria si koncept gjeografik dhe etno-linguistik ka qenë perceptuar qartë.

("Arnautluk-u") trajtohet si njësi administrative më vete, në përbërje të së cilës bënin pjesë sanxhaku i Prizrenit, Shkodrës, Dukagjinit, Ohrit, Elbasanit, Vlorës, Delvinës dhe Janinës.¹² Me përjashtim të Shkupit dhe Manastirit që bënin pjesë në një njësi tjetër administrative, këto sanxhaqe që autori i ka përfshirë nën emrin "Arnavutluk" ("Shqipëria") përputhen pak a shumë me arealin etno-linguistik shqiptar.

Studimi i trajtimit të historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve në tekstet shkollore osmane e sidomos, prania e këtyre dy koncepteve, gjeografik-Shqipëri ("Arnavutluk") dhe etnik-shqiptar ("Arnavutlar"), në hartat e atlasit historiko-gjeografik ndonëse deri tani e pa hulumtuar siç duhet na bën të konkludojmë se:

a) tek elita drejtuese politike dhe intelektuale e Perandorisë Osmane, Shqipëria si koncept gjeografik dhe etno-linguistik ka qenë perceptuar qartë;

b) trajtimi i historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve¹³ edhe pse si pjesë integrale të historisë së Perandorisë Osmane, nuk mund të mos ketë ndikuar te nxënësit shqiptarë, që studionin në shkollat osmane për të krijuar një përfytyrim objektiv që më vonë do të shndërrohet në vetëdije nacionale.

1 Ahmed Hilmi, *Resimli ve Haritalı Milli Küçük Osmanlı Tarihi*, Dersaadet: Kasbar Matbaası, 1330, s.134-140.

2 Halil Aytikin, *İttihad ve Terakki Dönemi Eğitim Yönetimi*, Ankara: Gazi Üniversitesi Eğitim Fakültesi Yayını, 1991.

3 Selim Kohen, *Malumat-ı Eftal*, İstanbul: A.Asadoryan ve Mahdumları Matbaası, 1328, s. 14.

4 Süleyman Şebahettin & Fuat Köprülü, *Mesrutiyette Terbiye-i Eftal*, İstanbul: Necm-i İstikbal Matbaas-ı, 1327, s. 98.

5 Ali Seyyidi, *Vezaif-i Medeniye*, İstanbul: Kaanat Matbaası, 1329, s. 34-35.

6 Ziya Gökalp (1876-1924) sociolog, teoricien dhe themelues i nacionalizmit bashkohor turk. Për disa vite me radhë ai shërbeu si ideolog zyrtar i partisë xhonturke "Bashkim dhe Përparim". Hilmi Ziya Ülken, *Türkiye'de Çağdaş Düşünce Tarihi*, İstanbul, 2001, s. 304.

7 Ahmet Cevat, *Resimli Osmanlı Lisanı*, İstanbul: Matbaa-yı Hayriye ve Şürekası, 1330, s. 12.

8 Ahmet Celal, *Coğrafya-yı Osmani*, İstanbul, 1311, s. 86-87.

* Ahmet Vefik Pasha (1813-1891) shkrimtar dhe burrë shteti osman. Në karrierën e tij të gjatë politike ai ka mbajtur disa poste të rëndësishme, si: kryeministër, kryetar parlamenti, ministër arsimit, ministër drejtësie etj.

9 Ahmet Vefik Paşa, *Fezleke-i Tarih-i Osmani*, (Yayına Hazırlayan: Şakir Babacan), İstanbul: Boğaziçi Yayınları, 2011, s. 101.

10 *Po aty*, s. 102.

11 *Po aty*, s. 104-105.

12 *Po aty*, s. 150.

13 Për shembull Skënderbeu dhe qëndresa e tij, Ali Pashë Tepelena, veprimtaria e të cilit trajtohet shkurtimisht si nxitës i popullsisë së Moresë në kryengritje për të përmbyshur qëllimet personale. *Po aty*, s. 282; 287.

KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 30 mars 2023 Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e rregullt, në të cilën përpos anëtarëve të Kuvendit mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Mbledhja u hap me disa ajete kuranore që u kënduan nga Shaban ef. Haxhi. Fillimisht u këndua një Fatiha për shpirtin e ish-sekretarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Jashar ef. Jashari, i cili ndërroi jetë disa ditë më parë. Në rend dite u shqyrtua dhe u miratua raporti për punën e Kryesisë së BI-së së Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022, raporti i komisionit financiar të Kuvendit të BIK-ut, u shqyrtua dhe u miratua pasqyra për të hyrat dhe të dalat e Kryesisë (llogarisë përfundimtare) për vitin 2022, si dhe të ndryshme. Mbledhjen e hapi kryetari i Kuvendit, dr. Ajni Sinani, i cili fillimisht iu shprehu mirëseardhje anëtarëve të Kuvendit, si dhe i falënderoi ata për punën dhe angazhimin e tyre, në veçanti në këtë muaj të bekuar Ramazan. Më pas, një fjalë rasti para të pranishmëve e mbajti kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Ai fillimisht uroi të pranishmit për muajin Ramazan dhe kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të që japin kontributin e tyre për avancimin dhe shtyrjen e proceseve përpara, duke lutur Zotin xh.sh., që të na shpërblejë për punën dhe angazhimin tonë për forcimin dhe përhapjen e mesazhit të Allahut te



xhemati ynë, ngase e kemi obligim mbi supet tona. Ai vlerësoi se dukshëm është shtuar vëllimi i punës në të gjitha institucionet e BIK-ut dhe po punohet me intensitetin më të madh të mundshëm. Një aktivitet shumë të mirë janë duke bërë mualimet në mësim-besim dhe puna e tyre ka reflektuar dukshëm në terren.

“Ne jemi përgjegjës për jetën fetare brenda dhe jashtë Kosove, aty ku kemi mërgatën tonë. Në kuadër të mundësive tona edhe gjatë vitit 2022 jemi munduar që me vetëmohim, maksimalisht të japim kontributin tonë në fuqizimin e institucionit tonë, duke filluar nga ngritja e kapaciteteve të kuadrit profesional përmes institucioneve tona fetaro-arsimore, gjegjësisht medreseve e Fakultetit të Studimeve Islame, pastaj ngritjes së infrastrukturës së BI-së, me theks të veçantë përmes zhvillimit të vakëfit, me qëllim të vetëm, që sa më

mirë të organizojmë jetën fetare në çdo cep të vendit tonë, dhe që ibadetet t'i kryejmë në ambiente sa më të mira e të pastra”- shtoi Myftiu Tërnavë. Ai po ashtu tha se ndjehet krenar me punën dhe angazhimin e anëtarëve të Kryesisë së BIK-ut, të cilët po japin një kontribut të jashtëzakonshëm në funksionimin e jetës fetare në vend dhe falënderojmë Zotin që sot BIK-u është Bashkësia Islame më stabile në rajon dhe kjo është një mirësi të cilën e kemi arritur me punë dhe angazhim. Ai më pas theksoi edhe projektet e shumta infrastrukturore, e sidomos vakëfet që janë duke u ngritur gjithandej Kosovës. “Në emër të Kryesisë së BIK-ut, i shprehu falënderime të gjithë bashkëpunëtorëve, nëpunësve e drejtuesve të institucioneve për punën e tyre të palodhshme, duke i inkurajuar që edhe më tej të vazhdojmë punën me zell dhe e me përkushtim.”



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E PDK-SË Z.MEMLI KRASNIQI

Më 27 mars 2023 Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, z. Memli Krasniqin. Myftiu Tërnavë e njohu kryetarin Krasniqi me ecurinë dhe zhvillimet e punëve të institucionit të BIK-ut, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion. Nga ana e tij, kryetari Krasniqi, fillimisht falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, e më pas e uroi atë dhe nëpërmes tij gjithë besimtarët islam për muajin e bekuar Ramazan, duke u uruar agjërimi të lehtë dhe të pranuar. Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe një sërë temash me rëndësi për qytetarët e vendit tonë.



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJET E RADHËS

Më 1 mars 2023, në prag të fillimit të muajit të bekuar Ramazan, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e saj të rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Mbledhja filloi me lutjet dhe me duatë për viktimat e tërmetit të fundit të Turqisë, për shpirtat e të cilëve u këndua nga një Fatiha. Pika kryesore e rendit të ditës për të cilën u diskutua gjatë kësaj mbledhje ishte parapërgatitja për muajin e bekuar Ramazan. Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi Zotin për të gjithë mirësitë e dhuruara, e më pas falënderoi edhe të gjithë anëtarët e Kryesisë për kontributin që janë duke



dhënë. Ai, nga anëtarët e Kryesisë, kërkoi që edhe më tutje të vazhdojnë punën e tyre në shërbim të besimtarëve tanë. Anëtarët e Kryesisë paraqitën mendimet dhe idetë e tyre lidhur me

aktivitetet që do të zhvillohen para dhe gjatë muajit Ramazan. Po ashtu, Kryesia e BI-së gjatë kësaj mbledhje shqyrtoi lëndë të ndryshme dhe mori vendime në bazë të kompetencave që i takojnë.

Me 20 mars Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e saj të rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Kjo mbledhje filloi me lutjet dhe këndimin e një Fatihaje për shpirtin e imamet të xhamisë "Haxhi Ejup" të Vushtrrisë, Hajrullah ef. Musës, i cili ndërroi jetë dhe u varros dje.

Në këtë mbledhje, Kryesia shqyrtoi dhe miratoi Raportin e Kryesisë për vitin 2022, shqyrtoi dhe miratoi Pasqyrën financiare për vitin 2022, shqyrtoi dhe miratoi llogaritë përfundimtare të këshillave të BI-së për vitin 2022, si dhe diskutoi për përgatitjet



e mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Gjatë kësaj mbledhje, po ashtu u shqyrtuan lëndë të ndryshme dhe u morën vendime në bazë të kompetencave që i takojnë kësaj Kryesie.

Myftiu Tërnavë falënderoi Zotin për të gjitha begatitë dhe mirësitë e Tij të

pakufishme, kurse më pas shprehu falënderime dhe konsideratë për punën dhe angazhimin e të gjithë anëtarët e Kryesisë. Ai, nga anëtarët e Kryesisë, kërkoi që edhe më tutje të vazhdojnë punën e tyre në shërbim të besimtarëve tanë.

MYFTIU TËRNAVA PRIT NË TAKIM Z. BERNARD ÇOBAJ, I NGARKUAR ME PUNË I AMBASADËS SË MALIT TË ZI NË KOSOVËS

Më 13 mars 2023, Myftiu Tërnavë, priti në takim z. Bernard Çobaj, i ngarkuar me punë i Ambasadës së Malit të Zi në Republikën e Kosovës. Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me funksionimin e institucionit të BIK-ut, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ai. Ai falënderoi z. Çobaj, dhe nëpërmes tij edhe shtetin e Malit të Zi për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme për shtetin e Kosovës.

Ai po ashtu çmoi edhe marrëdhëniet shumë të mira që kanë edhe Bashkësinë Islame të Malit të Zi. Nga ana e tij, z. Bernard Çobaj, falënderoi Myftiun për mikpritjen, dhe potencoi rolin tepër konstruktiv që ka luajtur BIK-u në promovimin e paqes, harmonisë dhe fqinjësisë së mirë, si dhe çmoi lart rolin e prijesve fetarë në edukimin shpirtëror të masës së gjerë.



MYFTIU TËRNAVA TAKOI ADMINISTRATËN E KËSHILLAVE TË BIK-UT



Më 16 mars 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, takoi administratën e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, kryetarët, kryeimamët, sekretarët dhe arkëtarët. Ai me këtë rast uroi të gjithë për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan, duke lutur Zotin që ta presim sa më mirë këtë muaj të bekuar të Kuranit dhe adhurimit e sakrificës. Në këtë takim, Myftiu Tërnavë vlerësoi punën, aktivitetin, kontributin dhe angazhimin që janë duke dhënë administrata e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke shprehur bindjen se bashkëpunimi, koordinimi dhe komunikimi në vijën zyrtare duhet shtohet edhe më në të mirë të avancimit të proceseve dhe në të

mirë të këshillave të BI-së. Ai po ashtu tha se duhet të tregojmë disiplinë edhe më të madhe në punën tonë, në veçanti raportet këshill-imam dhe anasjelltas. Raportet duhet të jenë shumë të mira dhe të gjithë imamët duhet të vizitohen dhe të ndiqet nga afër puna dhe veprimtaria e tyre, në mënyrë që efikasiteti dhe angazhimi të jetë edhe më i madh në të mirë të xhematit ku vepron. Myftiu Tërnavë më tutje shprehu falënderime për punën dhe aktivitetin e imamëve që po zhvillojnë në terren, duke lutur Zotin për mirëqenien dhe shëndetin e tyre. Ai në të njëjtën kohë kërkoi nga të gjithë administrata që gjatë kryerjes së detyrave të tyre, në raportin imam – Këshill – Kryesi, dhe anasjelltas, t'i

përmbahen vijës institucionale dhe hierarkike të BIK-ut, pastaj të ketë bashkëpunim ndërmjet imamëve, pra në nivel të duhur, si dhe të bëhet bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve fetare. Më pas, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, paraqiti platformën dhe planprogramin që është miratuar nga Kryesia dhe që do të implementohet gjatë muajit të bekuar Ramazan. Edhe drejtori i Veprimtarisë Botuese, Ramadan Shkodra, kërkoi nga administrata që edhe më të fuqizohet veprimtaria në mënyrë që literatura e botuar nga Kryesia e BIK-ut të jetë sa më afër lexuesit dhe besimtarëve tanë, sepse kjo do ta ruante frymën dhe doktrinën tonë institucionale.

U INAUGURUA PROGRAMI PËR ORGANIZIMIN E IFTAREVE DHE SHPËRNDARJEN E HURMAVE NË KOSOVË

Më 30 mars 2023 me pjesëmarrjen e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë dhe të ambasadorit të Arabisë Saudite në Tiranë, Feisal Hefzi, në Prishtinë, u inaugurua programi i kujdestarit të Dy Xhamive të Shenjta, mbretit Selman bin Abdulaziz al Saud për organizimin e iftareve dhe shpërndarjen e hurmave në Kosovë. Myftiu Tërnavë falënderoi ambasadorin Hefzi për pjesëmarrjen e tij në këtë inaugurim, e me këtë rast shprehu falënderime edhe për shtetin e Arabisë Saudite për ndihmat e vazhdueshme që i ka dhënë popullit të Kosovës para, gjatë dhe pas luftës. Myftiu Tërnavë shprehu gatishmërinë e institucionit të BIK-ut që të vazhdojë edhe më tej bashkëpunimi i mirë ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës së Arabisë Saudite. Nga ana e tij,



ambasadori Hefzi, shprehu falënderimet e tij për mikpritjen dhe për gatishmërinë e BIK-ut që të vazhdojë bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës Saudite. Ai çmoi lart kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame për promovimin e

vlerave qytetare dhe për harmoninë ndërfetare që ekziston në Kosovë. Në fund, si pjesë e këtij projekti, u shtrua edhe iftar i përbashkët për anëtarët e Kryesisë dhe anëtarët e Kuvendit të BIK-ut, në të cilën mori pjesë edhe ambasadori z. Faisal Hefzi.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI DISA XHAMI TË NDËRTUARA, PËRKATËSISHT TË RINDËRTUARA NGA SHTETI I KUVAJTIT

Më 4 mars 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi tri xhami të ndryshme në Kosovë, të cilat u ndërtuan, përkatësisht u rindërtuan nga shteti i Kuvajtit. Myftiu Tërnavë u shpreh tejet i kënaqur me ndërtimin/ rindërtimin e këtyre xhamive, për të cilat tha se do ta lehtësojnë kryerjen e ibadeteve fetare nga banorët e këtyre vendeve. Xhamitë e reja, të ndërtuara/ të rindërtuara janë xhamia e fshatit Henc, komuna e Fushë Kosovës, xhamia e rindërtuar në fshatin Kishnarekë të Drenasit dhe xhamia e fshatit Strellc i Poshtëm, komuna e Deçanit.



HAPET XHAMIA E RE NË DUMNICË TË POSHTME TË VUSHTRISË

Më 14 mars 2023, me këndimin e pjesëve nga Kurani dhe me tekbire është hapur xhamia e re në Dumnicë të Poshtme të Vushtrisë, në të cilën morën pjesë shumë banorë, liderë institucional dhe personalitete të ndryshme. Në hapje të kësaj xhamie mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili me këtë rast tha se ndërtimi i xhamive përveç se është i rëndësishëm për banorët dhe besimtarët



e kësaj ane, ka rëndësi të veçantë edhe te Krijuesi. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi dhe kryetari i KBI-së së këtij qyteti, Shemsi Rrahimi, uruan besimtarët për ndërtimin e kësaj xhamie edhe mundësitë që ofron ajo. Veç të tjerash, ata potencuan nevojën e ndërtimit të një xhamie të tillë me hapësirat përcjellëse që do të shfrytëzohen nga besimtarët. Kjo xhami përveç hapësirës për të kryer faljen e namazeve, ka hapësirë të mjaftueshme edhe për aktivitete të tjera, duke përfshirë edhe objektet përcjellëse të ndërtuara në tërësi nga BINI.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM Z. HALIL KASTRATI

Më 22 mars 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim drejtorin e shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, z. Halil Kastrati. Drejtori Kastrati uroi Myftiun Tërnavë dhe gjithë besimtarët për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan, duke lutur Zotin që të kemi agjërim të lehtë dhe të pranuar. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për bashkëpunim ndërmjet institucionit të Bashkësisë



Islame të Kosovës dhe shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.

NË FSHATIN FSHATI I RI TË VITISË U VU GURTHEMELI I XHAMISË SË RE

Më 10 mars 2023, Këshilli i Bashkësisë Islame të Vitisë organizoi ceremoninë e vënies së gurthemelit të xhamisë në fshatin Fshati i Ri. Në këtë ceremoni morën pjesë banorët e fshatit, imamët e Këshillit të BI-së së Vitisë, si dhe përfaqësuesit institucional të Komunës së Vitisë, në krye me zv.kryetarin e Komunës dhe me përfaqësuesin e Kuvendit Komunal. Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në këtë ceremoni mori pjesë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili uroi banorët e Fshatit të Ri për xhaminë e re, duke falënderuar



kështu donatorin, z. Ajet Doberjanca për sipër të gjithë ndërtimin e xhamisë me djemtë e tij, të cilët kanë marrë në vendlindjen e tyre.

NË SADOVINË TË JERLIVE TË VITISË U PËRURUA XHAMIA E RE

Më 10 mars 2023, nën organizimin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Vitisë, në një atmosferë festive me këndimin e tekbireve, në fshatin Sadovinë të Jerlive, u përurua xhamia e re. Ky manifestim, ashtu siç e do rendi, filloi me leximin e pjesëve nga Kurani fisnik. Në këtë manifestim morën pjesë besimtarë të shumtë të fshatit dhe prijësit e institucioneve komunale dhe fetare. Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në këtë ngjarje mori pjesë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili edhe



mbajti hytben e xhumasë. Ai në hytben në edukimin dhe kultivimin e vlerave e xhumasë ligjëroi rreth rolit të xhamive morale.

DELEGACIONI I BIRK-UT PJESËMARRËS I NJË SEMINARI DHE NJË KONFERENCE NË LONDËR “KOMUNITETI, SOLIDARITETI DHE E ARDHMJA E PËRBASHKËT NJERËZORE”

Më 12 mars 2023 Nën organizimin e RABITA-s dhe Këshillit Mysliman të Britanisë, në Londër u mbajt seminari i parë i liderëve myslimanë evropianë me temën “Komuniteti, solidariteti dhe e ardhmja e përbashkët njerëzore”. Në këtë seminar, Bashkësinë Islame të Kosovës e përfaqësuan dekan i Fakultetit të Studimeve Islame, dr. Islam Hasani, shefi i kabinetit të Myftiut, mr. Besim Mehmeti dhe kapelani i FSK-së, imami Agim Gashi. Ky seminar u mbajt për të avancuar të kuptuarit dhe të zbatuarit e Kartës së Mekës në të gjithë Evropën. Karta e Mekës është nënshkruar nga më shumë se 1200



dijetarë dhe studiues myslimanë nga më shumë se 139 vende të ndryshme të botës, pas konferencës ndërkombëtare të mbajtur në Meke, në maj të vitit 2019.

DELEGACIONI I BIK-UT VIZITOI MËRGATËN SHQIPTARE NË ZVICËR

Me 10 mars 2023, delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, i përbërë nga drejtori i Drejtorisë për Diasporë, Ekrem ef. Simnica dhe kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, u pritën në xhaminë “Qendra Islame Shqiptare” në Renens, Lozanë, nga kryetari i xhamisë z. Sami Zogaj, sekretari z. Orhan Musliu, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati. Para namazit të xhumasë ligjëroi Hetem ef. Sopjani, i cili përshëndeti të pranishmit dhe ligjëratën e tij kryesisht ia kushtoi parapërgatitjeve për muajin e bekuar Ramazan. Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në hytben e tij, përcolli urimet dhe përgëzimet e Myftiut Tërnavë për muajin Ramazan, duke lutur Allahun që të na i pranojë ibadetet dhe adhurimet që i kryejmë gjatë këtij muaji. Drejtori Simnica falënderoi të gjithë mërgimtarët tanë për kontributin e vazhdueshëm dhënë për vendlindjen në përgjithësi, e në veçanti për institucionin e BIK-ut.

Kurse më 14 mars Drejtori Simnica vizitoi Qendrën Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë. I shoqëruar nga kryetari i KBI në Prishtinë, Hetem ef. Sopjani, në të cilën u mirëpritën nga imami, njëherësh kryetari i kësaj Qendre, Fehim ef. Abazi. Më 12.03.2023, delegacioni qëndroi në mesin e besimtarëve shqiptarë duke ligjëruar dhe përcjellë mesazhe edhe



nga vendlindja, gjegjësisht nga BIK-u dhe kryetari i saj, Myftiut Naim ef. Tërnavë. Delegacioni fali namazin e akshamit dhe ligjëroi në qendrën “Shoqata dhe Qendra Kulturore Drita” në Moudon. Ndërsa namazin e jasisë e falën dhe ligjëruan para xhematit të

“Shoqatës Kulturore Myslimane të Payernit”. Delegacioni ynë falënderoi të gjithë besimtarët për mikpritjen e ngrohtë, në veçanti Emin ef. Mersimin dhe h. Mehdi Shahinin për angazhimin dhe organizimin e mrekullueshëm.

UNIONI STUDENTOR I FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME SHTROI IFTAR

Më 29 mars 2023 Unioni Studentor i Fakultetit të Studimeve Islame së bashku me profesorët shtruan iftar të përbashkët. Në këtë iftar mori pjesë edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë. Mysafirëve mirëseardhje iu dëshiroi dekani i Fakultetit të Studimeve Islame, dr. Islam Hasani, i cili i falënderoi studentët për iniciativën dhe realizimin këtij iftari dhe vlerësoi aktivitetet e tyre si shumë të vyer. Me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili tha se Fakulteti i Studimeve Islame si dhe Medreseja “Alauddin” në Prishtinë, e kanë dhënë provimin e tyre. Studentë



dhe medresistët e ujitën tokën e Kosovës me gjakun e tyre të njom për t'i dhënë kuptim jetës në Kosovë për të vazhduar ne me punën tonë të mëvonshme në

ngritjen e çdo gjëje që shkon në të mirë të mirë të vendit dhe fesë sonë. Ai duke vazhduar më tej ofroi mbështetjen e plotë për studentët ndaj çdo nisme.

DUA E HATMES NË XHAMINË “SULTAN MEHMET FATIH”

Me 18 mars Departamenti i Gruas pranë Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës, organizoi program dhe dua të hatmes në xhaminë “Sultan Mehmet Fatih”. Tetë nxënësë arritën me sukses leximin e tërësishëm të Kuranit para muajit të Ramazanit, me ç'rast edhe u organizua ky program. Para të pranishmëve mbajti një fjalë rasti mësuesja Kadrije Dragusha-Ademi e cila poashtu përgëzoi nxënëset për suksesin e arritur. Protagonistët e këtij organizimi mes emocioneve të shumta treguan eksperiencat e tyre gjatë mësimit. Në këtë organizim ishte e ftuar



edhe Florentina Tërmarkolli, përfaqësuesja e Departamentit të Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame.

Ajo për të pranishmet ligjëroi për vlerën e mësimit të Kuranit. Në këtë program poashtu u kënduan edhe ilahi.

DUA HATME DHE PROGRAM PËR NDER TË MUJIT TË RAMAZANIT

Me 18 mars për nder të ardhjes së muajit të Ramazanit, Këshilli i Bashkësisë Islame- Hani i Elezit ka organizuar program festiv dhe Dua të Hatmës në Shtëpinë e Kulturës. 43 nxënësë u certifikuan pasi me sukses kishin arritur të përfundonin leximin e tërësishëm të Kuranit. Mualimja Xhevrije Vila uroj dhe përgëzoi nxënëset për këtë arritje. Në këtë organizim u ligjërua rreth rëndësisë së mësimeve fetare nga udhëheqësja e Departamentit të Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Vaxhide Bunjaku. Programi u begatua me shumë pika artistike si ilahi, monolog e dramë të përgaditura nga nxënësit e



mësim-besimit. Për të ndjekur këtë program kishte interesim të madh të pjesëmarrësve e poashtu nga gratë e profileve të ndryshme si nga komuna e

Hanit të Elezit, pjestare të policisë, profesoresha, doktoresha e nga shoqëria civile.

XHAMIA E FSHATIT KISHNAREKË, 1840

Xhamia e fshatit Kishnarekë është ndër xhamitë më të vjetra në rajonin e Drenicës. Xhamia është ndërtuar në vitin 1840 me vetë kontributin e xhemit të fshatit Kishnarekë.

Sipas pohimeve të pleqve, nismëtar dhe ndër më merituarit për ndërtimin e xhamisë kanë qenë: AZEM Bajraktari (me nipat ADEMIN, REXHEPIN, ISUFIN), dhe Mulla Smajli. Thuhet se për këtë arsye edhe të lartpërmendurit janë të varrosur në oborrin e xhamisë (krejt kjo në shenjë nderimi dhe rrespekti që ju ka bërë fshati).

Rindërtimi i saj është bërë më 1982-84, po ashtu me vet kontributin e xhemit të dy fshatrave Kishnarekë dhe Nekoc.

Në rindërtimin e xhamisë kontribut të veçantë kanë dhënë, Mulla Musli Bajraktari (Kryetar i Këshillit në Drenas), Mulla Imeri Hoxha (Imami i asaj kohe), këshilltarët e xhamisë, si njëri ndër të palodhshmit ishte Sherif Selim Kastrati nga fshati Nekoci si dhe Tafil Nuhaj nga Kishnareka (ky i fundit ishte edhe muezin i xhamisë), si dhe bashkëfshatari që veponte në diasporën

e Zagrebit Ramadan Gara (i cili kishte grumbulluar fonde nga punëtorët tonë që punonin në Zagreb të Kroacisë).

Xhamia e Kishnarekës gjatë luftës së fundit, më 1998-1999, shërbeu si shtab i njësitit të UÇK-së i cili operonte në fshatin tonë. Po gjatë luftës Xhamia shërbeu edhe si vendstrehim dhe qëndrim për të zhvendosurit nga vatrat e luftës si dhe vend për tu ushqyer ushtarët e UÇK-së. Këtë mision xhamia e kreu deri në prill të vitit 1999 ku të gjithë u detyruam të largoheshim për shkak të ofensivës së forcave armike të indinjuara nga sulmet e NATOS që kishin filluar më 23.03.1999.

Me këtë rast xhamia ishte garantuar dhe demoluar rënd.

Pas luftës ishte shumë e nevojshme që xhamia të kthehej në normalitet dhe të kryheshin ritet fetare për banorët e kësaj ane, prandaj është merretuar në vitin 2000 me financimin e Komitetit të Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi.

Objekti i xhamisë së rindërtuar pas luftës nuk i plotësonte kushtet e optimale për kryerjen e riteve fetare, andaj që kërkesë e besimtarëve që

xhamia të ndërtohet nga e para me standardët të punueshme.

Kërkesa e besimtarëve me ndihmën e Zoti dhe angazhimit të myftiut u bë realitet dhe falë donatorit FADILAH AJSHA ABDULLAH AL RASHEED nga Kuvajti filloi ndërtimi i objektit të ri (në vend të objektit të mëparshëm) me datë 22.02.2022.

Me këtë rast falënderoi të gjithë ata që në çfarëdo mënyrë ndihmuan që të kemi sot objektin bash kohorë të xhamisë me të gjitha objekte përcjellëse. Në ndërtimin e kësaj xhamie përveç donatorit kryesorë nga Kuvajti, morën pjesë edhe disa bamirës të cilët investuan që kjo xhami të duket bukur. Me këtë rast në emër të imamit si dhe të xhemit të xhamisë së fshatit Kishnarekë ju falënderojmë të gjithëve e veçanërisht atyre që u bënë shkaktarë, kontribuan dhe ndihmuan në format më të ndryshme.

Kërkojmë nga All-llahu Fuqiplotë që të ua shtojë bereqetin, shëndetin dhe mbarësinë në familjet tuaja.

NJË HISTORIK I SHKURTËR

Imamët që kanë shërbyer në këtë xhami, janë:

- Azem Bajraktari ka kryer detyrën e imamit për një kohë të shkurtër. Iniciuesi i parë për ndërtimin e xhamisë.
- Mulla Muharremi ka shërbyer një kohë.
- Mulla Smajli nga fshati Kishnarekë ka shërbyer për disa vite me radhë.
- Një Hoxh nga Mushtishti ka shërbyer për disa vite.
- Mulla Sherif Bajraktari, imam nga fshati, Shërbeu një kohe bukur të gjatë (1910-1957).
- Mulla Imer Hoxha nga fshati Nekoc. Edhe ky ka shërbyer diku rreth 38 (1957-1992).
- Eset ef. Bajraktari nga fshati Kishnarekë është emëruar imam nga viti 1993.

Eset Bajraktari, Kishnarekë 10.02.2023



26 NXËNËS NGA LUBIZHDA E PRIZRENIT E BËNË HATME KUR'ANIN

Xhamia e Re në Lubizhdë, organizoi program festiv dhe ceremoni solemne me rastin e mbarimit të Hatmes, nga 26 nxënës. Imami i xhamisë, Amir Ademi falënderoi të pranishmit për prezencën e tyre, e në mënyrë të veçantë prindërit për interesimin dhe bashkëpunimin e tyre. Në emër të KBI-Prizren, të pranishmit i përshëndeti kryeimami Orhan Bislimaj, i cili në ligjëratën e tij të rastit e vlerësoi lartë angazhimin e imamit të fshatit, si dhe i përgëzoi prindërit për vetëdijen e tyre të lartë në



motivimin e fëmijëve. Fjalë përshëndetëse mbajti edhe kryetari i fshatit, Nehat Vehapi. Në fund, Këshilli

i BI-së iu shpërndau nxënësve nga një certifikatë për mbarimin e mektebit, si dhe nga një dhuratë modeste.

MERHUM: JASHAR EF. JASHARI (1941-2023)

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

Më 23 mars 2023, ndërroi jetë në moshën 82 vjeçare ish-sekretari i BIK-ut, Jashar ef. Jashari. Varrimi i rahmetliut bë, më 24 mars 2023, pas namazit të ikindisë, në varrezat e qytetit të Prishtinës. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë, shpreh ngushëllime për familjen e haxhi Jashar ef. Jasharit, bashkëpunëtorët dhe kolegët të cilët punuan me të. Haxhi Jashari të gjithë jetën e tij e kishte dedikuar në shërbim të fesë dhe atdheut. Ai për 42 vite ishte pjesë e BIK-ut dhe kontribuoi në udhëheqjen, ngritjen dhe zhvillimin dhe avancimin administratës së organeve të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Haxhiu i përket nxënësve të Medresesë së Ultës, respektivisht gjeneratës së dytë që e kreu me sukses.

Menjëherë pas medresesë më 1965, haxhiun e gjejmë në Bashkësinë Islame të Kosovës, fillimisht në detyrën e arkivistit e më vonë në detyrën e sekretarit, detyra të cilat i kreu me pedanteri, përkushtim e profesionalizëm deri në 2007. Përveç administratës së Kryesisë të cilën e udhëhoqi vet, ai kontriboi në ngritjen edhe të administratës së këshillave dhe të institucioneve tjera të BI-së. Një kontribut të çmuar haxhi Jashari ka dhënë edhe në përgatitjen e akteve normative të BI-së, dhe të institucioneve të saj, po ashtu edhe dha kontribut të veçantë në fillet e periodikut islam në gjuhën shqipe, konkretisht në numrat e parë të revistës “Edukata Islame” kur iu bashkua plejadës së prirë nga haxhi Sherif Ahmeti për t'i vënë themelet e periodikut islam të ne, si dhe në cilësinë e sekretarit të Kryesisë së BI-së ka



përfaqësuar me dinjitet Bashkësinë Islame në forume e institucionet nga më të ndryshmet ku ka qenë e nevojshme.”

Namazit të xhenazës i priu Mehmet ef. Gashi kurse duanë e bëri Nuhi ef. Ganiu.

Allahu e mëshiroftë ndërsa familjes ua dhëntë sabrin dhe durimin!

MERHUM: HAJRULLAH EF. MUSA (1983-2023)

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

Në varrezat e fshatit Maxhunaj, me praninë e shumë hoxhallarëve dhe xhematit të shumtë, pas namazit të ikindisë, u varros imami i xhamisë “Haxhi Ejup” të Vushtrrisë, Hajrullah ef. Musa, i cili ndërroi jetë në moshën 40 vjeçare.

Biografi e shkurtër

Lindi më 25.01.1983 në Dumnicë e Epërme të Vushtrrisë. Shkollimin fillor e kreu në fshat, ndërsa atë të mesëm në Medresenë “Alaudin”, për të vazhduar

më pas me fakultetin islamik në Tripoli të Libisë. Me t'u kthyer në vendlindjes, ai u angazhua si imam në xhaminë e fshatit Dumnicë e Poshtme, ndërsa më pas, në vitin 2018, kaloi imam në xhaminë “Haxhi Ejup” në qytet, detyrë kjo në të cilën e gjeti edhe vdekja. Ka qenë i njohur për korrektësinë në punë, raportet e mira me kolegët dhe mbi të gjitha përkushtimin për detyrën e imamit. E lexonte Kuranin bukur dhe rrjedhshëm. Ka qenë i martuar dhe baba i pesë fëmijëve.

Allahu e mëshiroftë ndërsa familjes ua dhëntë sabrin dhe durimin!




SI AGJËRONTE HAFIZ SABRI KOÇI GJATË KOHËS QË QËNDRONTE NË BURG?

Hafiz Sabriu hante vetëm darkën. Gjatë këtij muaji hante iftarin dhe deri iftarin tjetër nuk paraqitej më në mensë. Ashtu ka agjëruar 21 Ramazanë, me një kokërr qepe në xhep, me një domate apo me një gotë kauçuku, në të cilën zinte kos me qumështin që i jepnin kundër helmit. Ndodhte edhe që racioni i bukës mos te ishte standard 800 gramë.

Kjo, sepse gjyshi riparonte gjëra dhe në kuzhinë (merrej me instalime hidraulike), dhe aty vëren që tepsitë i lyenin me dhjamë derri, po e dinte se pa bukë nuk jetohej. Ndaj, me thikë, hiqte koren e poshtme të bukës, kështu që dhe ato 800 gramë zvogëloheshin edhe më shumë. Në mes të banjove, kishte lënë një kabinë bosh, në të cilën nuk kishte instaluar asgjë, e përdorte si magazinë. Aty shkonte në mëngjes për t'u falur.

E ka pasur të vështirë në fillim, por Zoti e ka qetësuar dhe më pas i ka përballuar të gjitha vështirësitë shumë rehat.





"Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë,
e Ai t'ia shtojë atij shumëfish atë?"

(El Bekare, 245)

Pejgamberi, a.s., e bëri obligim

ZEKAT (SADAKATUL) FITRIN

si pastrim për agjëruesin për fjalët e këqija, dhe ushqim
për të varfrit. Prandaj, kush e jep para namazit (të Bajramit),
ajo është sadaka e pranuar, e kush e jep pas namazit, konsiderohet
sadaka e rëndomtë!

**Bashkësia Islame
e Republikës së Kosovës**

ZEKATI DHE SADAKATUL FITRI 2023

PAGESAT MUND T'I BËNI

1. Në zyrat e këshillave të BIK-ut
2. Në secilën xhami të Kosovës
3. Në adresën bankare:
Bashkësia Islame e Kosovës
NLB-Prishtina
Account no. & IBAN:
XK05 1700200100103672
SWIFT Code (BIC): NLPRXKPR
4. dhe përmes platformës
Paypal.me/BIKFITRA



VLERAT NË TË CILAT MUND T'I BËNI PAGESAT

